

Sami

Frashëri

VEPORA

BIBLIOTEKA

8JH-82

F 86

LINDJA

Biblioteka RILINDJA

Redaktor

Nazmi Brahmani

814-82

F86

Sami Frashëri: VEPR A • I

BESA




RILINDJA
Redaksia e botimeve
Prishtinë
1978

MEMORIAL

1833





NJERZIJA

	Vjeç
✓ ZYBER: Bari nga Progonati	55—60
✓ WAHIDE: E shoqja e Zyberit	35—40
✓ MERUSHE: Vajza e këtyre	16—17
✓ REXHEP: I nip' i Zyberit	17—18
✓ SAIDE: Një vajzë fqinjë	16—17
DEMIR BE: Nga parësi e Tepelenës	50—60
TALHA: Kujdestari i Demir Beut	40—50
SELFO:)	20—22
XHAKO:)	19—21
SULÇE:)	25—30
(Trimat e Demir Beut)	
ARSLLAN:	30—35
RAPO:	18—20
EVRENOS:)	25—30
FETAH: Luftëtar nga Borshi, i at' i Selfos	45—50
SELMAN: Një luftëtar nga Borshi	30—35
DURI: Mëma e Fetahut	80—90
NJË KALORËS: Suvari.	

2019

00-00

01-01

02-02

03-03

04-04

05-05

06-06

07-07

08-08

09-09

10-10

11-11

12-12

13-13

14-14

15-15

16-16

17-17

18-18

19-19

20-20

PAMJ' E PARË

*Me të ngritur napën' e skenës duket një pyll, dhe
majat e malevet për së largu.*

*Merushja ka ndenjtur nënë hiet të një druri, e po
bën çorape; pranë saj ka një lëkurë me qumësht, një
trajstë dhe një kërabë.*

Përflim I.

MERUSHE, *vetëm me vethe.*

Edhe më s'u-duk; së ndenjuri vetëm, m'u-brengos
shpirti. Kur është i brengosur njeriu, sa i zgjatet ko-
ha! Një orë, sa një muaj i duket-... Nuk e di ç'më
qe kshu? Më parë që në mëngjes e gjer sa ngrysej
rinja fillja vetëm, dhe nuk donja të dinja fare; po
më vinte mirë, se qetësohesha kshu. Kur shpinja dhën-
të më no një kullotë të mirë, vetë rinja e gëzuar nënë
hiet të no një peme; nuk e dinja ç'ish brengë fare;
Bukuri e malit, oshëtim'i përenjet, ligjerim'i zogjet,
blegërim'i shqeravet më dëfrenin mëndjen, më zbativ-
nin shpirtin! S'kisha gjë në mënt, veç shqerat, dhëntë,
dhe tjetër s'mejtonja. Pa le, kur pille nonjë dele s'kish
më e lumtur se unë! Mbrëmanet, me të kthyer në shtë-
pi, po të shpinja nonjë qengj në prehër, atë ditë e

quanja të shënuar. Kur më sëmurej nonjë qengj, a kur ftonim njeri e donte të therte im' atë, unë hidhe-rohesha. Në kohërat të para gjith' e gëzuar, e qeshur isha; po tani, s'di se pse? dhëntë m'u xvertitnë, më duallë nga zemra, më s'dua t'i shoh. Gjithë mëndjen tek ai e kam! Kur e kam pranë e humbas fare; ç'bënj, ç'flas as unë s'e di! Kur s'e kam, vetëm atë mejtonj, tjtatër gjë s'më hyn në sy. Kohën e pres pa durim, ora si muaj më duket. Ah! Perëndi! ç'është kjo punë kësh-tu? Më parë dhe nga tim më e nga tim atë më tepër e donja, e kisha si vëlla; po tani... Ah! as Vethes sime s'kuxonj t'ja them! ... Kur i vdiq e ëma dhe i ati e lanë të vogël; im' më na rriti të dyve bashkë; im' atë me një sy na shikon, më të shumët e njerëzisë vëllezër na dinë; ashtu vërtet; si vëllezër jemi ritur, bashkë kemi ngrën' e kemi pirë, gjer më dje në një shtresë flinim. . . Ah! unë nga Rexhepi duhet ta pres shpresën... Po s'e bënj dot... Vdekja është më e mirë përpara ndarjes! ... Pa nesër a pasnesër në e zënçin Rexhepnë, ati n'i dhënçin nonjë tjetër, dhe mua në më vlofçin me nonjë tjetër... Ah! unë s'rronj pa të!

Zë sytë me dorë dhe mallëngjehet. Rexhepi duke vëshëllyer del nga anë e djathtë.

Përflim II.

MERUSHE, REXHEP.

REXHEP, nxiton drej Merushes.

Merushe!

MERUSHE, për njëherë ngrihet dhe fshin sytë.

Ah! Rexho! ti je? Ku mbete kaqë?

REXHEP.

Merushe! ç'bën? qanje kshu a?

MERUSHE.

Jo vëlla, pse do t' qanj? si mbeç vetëm më qetoj gjumi.

REXHEP, *me vethe.*

Vëlla? me sy të vëllazërisë më shikon! Po humbet shpresa!

MERUSHE.

Pse menove kaqë? ike më le vetëm. Sa brengosem kur mbetem kshu!

REXHEP.

Nuk kishim një dele barsë? ajo na polli, pandaaj menova kshu. Ta shohç qëngjin sa i bukuri!

MERUSHE, *me vethe.*

Ky si unë qëmoti: Gjithë dhëntë, shqerat mejton.

REXHEP.

Sot të shoh fort të mejtuar.

MERUSHE.

Unë?... jo! ç'do të mejtonj? (*Rëfeket si e qeshurë*).

REXHEP.

Eja të themi një këngë të të dalë dhe gjumi.

MERUSHE.

Mirë.

*Të dy ziren dorë për dorë, Rexhepi më parë, pas-
taj Merushja, dhe kshu me radhë zënë e këndojnë këtë
këngë:*)*

E përsërit Merushja.

KËNGA

*Nevej qytetar s'jemi,
Malësor emrin' e kemi.*

Merushja e përsërit.

*Kurë për mi krye tënë,
Urdhëronjës s'kemi vënë.*

E përsërit Merushja.

*Nevej jemi bij bariu
S'na tremn' as dëbor' as shiu.*

Prapë Merushja.

*Na lirinë dëshirojmë
Andaj nëpër male rojmë.*

*Puna jon' është vetiu.
Natyra si desh na shtiu.*

E përsërit Merushja.

*Na jetën me gas e shkojmë,
Dhe nënë robëri s'rojmë.*

*) Do të këndohet Labërisht.

E përsërit Merushja.

*Bari, lulet, dhënt' e dhitë,
Këtu i gjejmë stolitë.*

E përsërit Merushja.

*Të këcejmë të këndojmë
Zemëratë t'i gëzojmë.
Shpirtërat t'i lartësojmë.*

E përsërit Merushja.

*Fytyra jonë s'është' mbuluar,
Këmbë-xbathur jemi msuar.*

E përsërit Merushja.

*Na më sjemi të gënjyer,
Zëmrën s'e kemi të thyer.*

E përsërit Merushja.

*Turp o ju gra qytetarka!
Që ngarkohi në guriçka!
Me të kuq, e me të bardhë!
Gënjeni vethen më parë!*

E përsërit Merushja.

*Stolit' tona më të mira!
Tuajt fare të pështira!*

E përsërit Merushja.

*Na gjëndjen tën' s'e ndërojmë,
Si kur të na i farkojnë.*

E përsërit Merushja.

*Kasollën e kemi mirë,
Për pallas s'kemi dëshirë.*

E përsërit Merushja.

*Këtë çast, del Zyberi më të djathtë, dhe pa rëfyer
qendron e i dëgjon me gëzim.*

*E ku ka gjë më të mirë?
Kshu si rojmë na të lirë?*

E përsërit Merushja.

*Rofshin qofshin malësitë!
Zili paçin mbretëritë!*

E përsërit Merushja.

Përflim III.

ZYBER, REXHEP, MERUSHE.

ZYBER, *del për një herë dhe i pushton të dy.*

Bijt' e mi! Zoti u-faltë! sa bukur këndoni më jini
si dy engjëj zbriturë prej qielli! ... Ah! s'di qysh t'i lu-
tem Perëndisë për ju! (*Për një herë hidhërohet dhe
me vethe*) Ç'bënej të kish rojtur i mjeri Dajlan, t'i ari-
nte dhe ai kësaj dite, të shihte të birë si engjëll! pa
të gëzohej dhe ai si unë. I mjeri! bashkë me të shoqen
qe motmot e sipër rynë në dhet! dhe në kohë të shpir-
tit ma la të birë mi qafë! Ah! dhe unë duhet ta kem si
t'ime bijë; i gjori mbetur i varfër pa mëmë e pa atë!
(*Pshertin dhe fshin lotët e syvet*).

REXHEP.

Ç'bën kshu? O im' atë!

ZYBER, *me vethe.*

Atë më thotë mua! Sa gëzohem kur më thërret kshu! (*Duke hedhur dorën mbi qafë Rexhepit*). Jo gjë djalë!

MERUSHE.

Qan kshu? o im atë?

REXHEP.

Thuana ç'ke o atë.

ZYBER.

Ç'më shikoni mua bij! Unë jam plak njeri; sjell të shkuarit ndër mënt, mallëngjehem, u mejtonj ju qysh do t'u lë pas, andaj qanj; pleqtë kanë një tok mejtime, s'u qesh buza kurrë! vetëm fatbardhësi e djemtë i gëzon pleqtë! Ju gëzohi, bij, qeshni, këndon, që të gëzohem dhe unë pas jush!

MERUSHE.

Ti po qan, e ne qysh të qeshim?

ZYBER, *e heq më një anë Merushen, dhe me ngadalë.*

M'u kujtua e ëma dhe i ati i këtij të mjeri djalë, pa mëmë e pa atë! Merushe dashç Perëndinë dhe ti e vështro si vëlla.

MERUSHE, *pa dashur.*

Si vëlla!

ZYBER.

Ashtu o ime bijë, vëlla, edhe ai djali im është.

MERUSHE, *e vrenjtur me vethe.*

Ah! Nukë besonj... M'u pre shpresa!

ZYBER.

Ju dëfreni, gëzohi, pa unë... një këmbë në var një këmbë jashtë tani!

MERUSHE.

Mos thua kshu o im' atë!

REXHEP.

Dashtë Zoti do të rosh dhe shumë kohë!

ZYBER.

Dashtë Perëndija djalë gjer sa t'u martonj dhe juve... Vajzën t'ap më një vënt të mirë; dhe djalit t'i gjenj një nuse si dua vetë.

I lutëm Zotit gjer sa t'u shoh dhe fëmijën tuaj.

REXHEP, *me vethe.*

Mua të më martonjë! të më apë një tjetër! Ah! mos e dhëntë Perëndia!

MERUSHE, *me vethe.*

Të më apë një tjetër! (*Duke lutur të et*). Unë s'ndahem nga ju o atë! Mos më nxir nga shtëpia; s'munt t'i lë këta male!

ZYBER, *puth të bijën dhe duke qeshur.*

Dëgjomë mua bijë, shtëpi e vashës është e burit jo e të et; ti sot je, nesër s'je këtu. Zonjë e kësaj shtëpie do të bëhet nuse e Rexhepit.

MERUSHE, *i prishet fytyra dhe me vethe.*

Ah! o Zot; ç'më piku në zemër!

REXHEP, *me vethe.*

S'më duket mirë; më ngjan se dhe kjo...

ZYBER.

Më rofsh bijë, më gëzove tepër me këto fjalë; e kupëtova; nuk do të ndahesh nga njerëzija jote po mos ki keq; se do Perëndia e të gjenj një burë bari, dhe s'të largonj nga këta male! Thuamë tani, bari e do burin? a po ke sy në fustanet e në pallaskat të ergjën-ta të atyre njerëzvet të mefshtë?

MERUSHE, *e turëpëruar,*

Pse m'i thua këto fjalë, o im atë? Unë s'kam gjë në mëndje, vetëm nga ju s'dua të ndahem.

REXHEP, *me vethe.*

Edhe, kjo se ç'ka një gjë!

ZYBER.

Ti mos u mejto bijë, se unë dua të të kem gjithënjë ndër sy; prandaj të ap më një vënt të afërt që të vinj të të shoh për javë. Unë ua di zemrën e të rinjet.

MERUSHE, *me vethe.*

Ah! Në qoftë ashtu s'kam frikë!

REXHEP, *me vethe.*

Të dojë vallë... ah! s'më ngjan.

ZYBER.

Dëfreni bij; loni pse; mejtohi kshu? qëpari sa mirë lonit! Arç unë u prisha këngën, nga fjalët e' pleqet s'para u vjen mirë të rinjet; po e di unë; zini këngën ju, këndon, se dhe unë do vete të shoh bagëtinë pakë. (*Si ecën pakë kthehet.*). Rexhep, eja dhe ti djalë mer atë qëngjin e pjellë, e sill këtu. (*shkon.*)

REXHEP.

Mirë; vinj. (*Duke ikur*). Merushe, tani vinj unë.

Përflim IV.

MERUSHE, *vetëm në vedi.*

Prapë vetëm mbeta; që pari kur këndonim të dy sa qesh e gëzuarë; s'më shkonte gjë në mëndje fare. Isha si e dehur, s'qesh më vethe! Nganjëherë kur jemi të dy, të atilla fjalë flas, sa më vjen turp kur ri e i mejtonj! Kur jam me atë s'e urdhëronj dot vethen! Kur sa gjëra të liga janë, më vinë në mëndje; më zë një duf e më mbushet plot hidhërim zemëra! të ardh-të keq o Perëndi! ta dua kaqë, pa të mos mund t'i them as një fjalë? Ç'e madhe brengë! im atë të dye për djem na ka; Rexhepi mua më vështron si motër, po unë qysh guxuakam t'i them unë ty të dua „ty kërkonj të të mar”. Kur më pyeti im atë: cilin do të març? Qysh kuxonja unë t'i thosha: Rexhepnë, djalën, vëllanë! Unë jam mësuar që në vogjëli e i thëres vëlla Rexhepit; dhe ay mua motër më thotë. Tani motër e vëllaj, a bëhen dot burrë e grua! Ah! sa punë e

keqe! Fjalët që më tha që pari im atë më pinë si dy plumba me tel ndë zemër; „Rexhepit t'i napë një nuse” Mua të më gjenjë një burrë! Ah! kur më mejtohen këto, më bëhet zemëra thërime!...

Ze sytë me dorë dhe qan një copë here, pastaj më të marrë çorapen të punonjë, më anë të mëngjër dalin pesë gjahtorë; Selfua me katër shokë. Selfua, u ep zë shokëvet të ecin me gadale.

Përfllim V.

*MERUSHE, SELFO, XHAKO, RAPO, SULÇE,
ARSLLAN.*

RAPO, Selfosë.

E... Përse na solle këtu or vëlla? Nukë sheh ti? këtu kullosin bagëtija, s'më ngjan të ketë gjah!

SELFO, duke pëfyerë Merushen.

Më mirë se këtë gjah ku e gjejmë!

RAPO, Me të parë Merushen.

Ç'është ajo! për Zonë gjë e mirë!

SELFO.

Po çë e dittë juve, kot vinj këtu unë?

SULÇE.

Kur paska të këtillë gjah këtu ç'kërkojmë gjetkë!

ARSLLAN.

Sa e rënda! as sytë s'kthen të shohë!

SELFO.

Në më dëgjoni mua të këcejmë pakë që t'i ryjmë në sytë.

ARSLLAN.

Mirë thua

SULÇE.

Ejani.

XHAKO.

Në daçi, të mos këndojmë nga këngët të trimërisë; të gjejmë një këngë dashurie, pa tonat kur të nisemi për luftë i këndojmë.

SELFO.

E di unë se cilën do të mar po, qasuni juve.

Të gjithë lënë armët më një anë, dhe ziren dorë për dorë. Vallen e heq Selfua duke nisur këtë këngë.

KËNGA

*Ti je një lulez' e malit!
Tarnana tarnana;
Tarnana me ternene!...*

Të gjithë më një gojë e përsëritin.

MERUSHE, më të dëgjuar këngën kthen kryet.

Ah! prapë ay! ... Ç'më bie më qafë ky njeri mua!

SELFO, këndon.

*Të kam si syt' e ballit!
Tarnana ternene...*

Shokët më një gojë.

*Tarnana me ternene,
Në këtë mal vëtëm ti je!*

Shokët e përsërijnë.

*Merushja, krabën në dorë, lekurën me qumësht
mbi sup, dhe ikën më të djathtë. Përnjëherë prishet
pedhi i valles.*

RAPO.

Ç'e do, e prishmë; thamë si kur t'i rynim në sytë,
po e përzumë fare!

SELFO.

T'i lëmë të gjitha më një anë; unë këtë vajzë e
dua! i jam goditur!

RAPO.

Ç'thua? E njeh ti këtë? E ke parë tjetër herë?

SELFO.

Për të parë njëmijë herë e kam parë, po për të
njohur s'e njoh dot! Se kurdo që e shoh kshu ma
bën!

XHAKO.

S'ke turp or!

RAPO.

Hë! prandaj del gjithënjë për gjah! ti paske tja-tër mejtim e nevej s'e ditkemi! Nuk pyete e kujt është kjo vashë!

SELFO.

Është vajza e një bariu nga Progonati.

RAPO.

Thuaj ç'u lothke kot! Qysh mund të març një bijë bariu; s'e di ti se yt atë është nga të parët e Borshit.

SELFO.

Ç'do të jetë or vëlla; kur m'u përzje ylli! ...

XHAKO.

Po dhe ti të duash s'besonj të ta apin! e ku apin ata! ...

RAPO.

Ç'thua? ... të kërkonjë djalë i Fetah Borshit, një vajzë bariu nga Progonati pa të mos ja apin? ... ja apin dhe duke lutur, po për këtë s'bën ta marë.

XHAKO.

Nuk i di ti se ç'janë këta Progonatasit or vlla! Ata janë gjithë barinj aqë të rëndë mbahen sa përveç

barinjët më s'duan të dinë njeri. Pa le neve që s'na peshojnë fare sna kanë në atë numër!

SELFO.

S'janë gjë këto, vetëm vajza të dojë, pa kur të më dojë e bija, s'ka se çbën i ati! dhe madhëria ime s'më prish aqë punë. Po ç'të bënj, kam kaqë kohë që po e ndjek dhe s'më vështroi asnjëherë në sy! Shumë herë kuxova e i fola, po s'më'u përgjiq asnjëherë! herë-herë mer dhe një djalë pas, si më duket duhen shumë me të. Unë e pandehnje të vëllanë, po ai qënka i kushriri i saj! Në është që e ka synë tek ay, unë i mar shpirtin që me kohë atij! ...

RAPO.

Ç'thua kshu? pa mblidh mëndjen njëherë!

XHAKO.

Kur qënka i kushëriri po domosdo do ta dojë; vëllaj, kushëriri një janë. S'është një me ty ay.

SELFO.

Nuk' e di ç'bëri; një ditzaj i thashë plakës të dërgonte një grua për të kërkuar vajzën nga i ati; të shohim ç'i thanë!

ARSLLAN

Do perëndia e sosit! po neve gjithë kshu do të pimë? nuk vramë gjë, n'u ktheshim si erthmë, le shokët që do të na qeshin, po s'na mbetet sy te beu që i kërkojmë lejë për tjetër herë.

SULÇE.

Mirë thua; gjahu që dashka Selfua s'u goditka! pa të shohim të vrasim ca nga këta që dimë ne, të mos na vejë dhe mundimi kot.

RAPO.

Të vemi gjetkë.

SELFO.

Vemi, po në të kthyerë prapë këtej të shkojmë.

RAPO.

Mirë; bëhet.

SELFO.

Eni të shkojmë. *(Marin armët nër duar dhe shkojnë. Më të mëngjër duket Zyberi)*. Ja! Ky është i ati i vajzës.

RAPO.

Njihet nga syri ky që është nga barinjtë e Progonatit.

Shkojnë.

Përflim VI.

ZYBERI, vetëm.

ZYBER, duke vënë re gjurmat e atyre, me vethe.

Ç'farë njerës të mefshtë! pa punë, pa nonjë fitim! që të gjithë si arinj janë! shkojnë kohën e tyre kot. Kanë dalë e shëtitin sikur do të bëjnë nonjë punë të madhe! Përveç që u ngrënë prehjen e zogjët më s'bëjnë tjetër gjë! ç'të bëjnë; si hanë e pinë mirë e mirë, pi e pi u mërzitet shpirti, pa dhe ata më s'dinë se ku venë! Këta më ngjajnë si nga njerëzit e Demir Beut. Në kontakt*) të Demir Beut mund të ketë nja tridhjetë a dyzet lanxo të këtillë! Këta s'dinë? Që në mëngjës e gjer sa ngryset të fshinë armët, të rinë me palcore në dorë sikur do t'i marin kokën e armikut! dhe kur pi Demir Beu, të gjithë venë duart mi silahet dhe radhosen më këmbë, u duket sikur do të fluturojnë! Është nonjë punë dhe kjo? ... [Kshu është nisur kjo e shkreta jetë! njëri zë punën pa gdhirë dhe mezi fiton një copë bukë me djersët të ballit; një tjetër që është i lik për tërë njerëzinë, pa punuar, pa u munduar fare, pi e prehet dhe ha gjënë e dhetë njerëzve! ... Sikur të punonin që të gjithë sa do të ish mirë; nuk do t'i dihej as emëri varfërisë!]

Merushja del më të djathtë.

Përfllim VII.

ZYBER, MERUSHE.

ZYBER.

Qasmu bijë! ... ku ishe?

MERUSHE.

Këtu qeshë

*) Zapana i thonë Labërisht.

ZYBER.

Tani shkuan ca njerëzs nga Borshi këtej. . .

MERUSHE.

I pashë, ca gjahtorë. . .

ZYBER.

Ata të panë ty bijë?

MERUSHE.

Nuk e di; unë po bënja çorape këtu, kur ngrita sytë ç'të shoh? ca njerës kishin zënë vallen e po këcenin! Ata kurdoherë vijnë e më bien më qafë o im atë! Sa njerës pa mejtim! . . .

ZYBER, *me zemërim.*

Njerës të ndyrë! të mallëkuar! njerës pa nder; të heqin valle përpara vashës! . . . përpara teje bijë;

MERUSHE.

Jo, un' ika.

ZYBER.

Oh! më paç uratën bijë! mirë bëre, qas — m'u të të puth në ballë! (*Merushja i qaset, Zyberi e puth në ballë*). Dëgjomë bijë! jetë e njeriut dy ditë është; sot jemi nesër s'jemi; në këtë gjithësi, vetëm një nder është që s'humbet kurrë! . . . Nuk ka gjë si nderi! emëri i njeriut të nderçim s'i harohet; i kujtohet kurdoherë. Gjëja, bukuria, ergjëndi, floriri dhe shumë të tjera sa janë humbasin, veç nderi ron i patundur kudo të jetë! Njerinë nderi e bën njeri, pa njeriu pa nder është

turp të vëhet në radhë të njerëzisë; ay është më i poshtër dhe nga kafshëtë! bijë! sa të munç vështro të ruash nderë...

MERUSHE.

O im' atë!...

ZYBER, *i pret fjalën.*

E di mirë unë, që ti s'ke nevojë për të tilla fjalë; po s'ka gjë, m'u-kujtuan pa t'i thashë, m'i suallnë ndërment ata njerëzit e liq që shkuan këtej. A e di ti se ata njerës që kërcenin përpara teje kërkonin të të rrëmbenin zemrën tënde! Shumë herë kusari ryn në tufë për të vjedhur berra; po ka dhe ca kusarë që vinë e rëmbajnë zemrën! A e kupton bijë, nga të tillë kusarë më shumë të ruash vethen se dhëntë. Kurrë mos u vërë sy fustanevet, pallaskavet të ergjenta të këtyre njerëzve! .. Që pari nuk të thashë: cilën të pëlqesh do të ta ap? Në është se do të pëlqej nonjë njeri të tillë, ta dish mirë që s'të ap ne ay! s'dua të zë miqësi me të tillë njerës të mefshtë, e pa punë! Një punëtor do pëlqyerë bijë, një punëtor! një bari, a një bujk! e more vesh bijë?

MERUSHE.

Të thash gjë unë që m'i thua gjithë këto o im atë?

ZYBER.

Jo, vashëzë, të faltë Zoti të di unë ty, po dua t'i nëmëronj të gjitha që të të largonj nga gjërat e liga sa e kam në dorë. Me gjithë këto, unë të thashë që ti s'ke nevojë për fjalë të tilla; po s'ka gjë; unë dua të t'i them... (Si mejtohet pakë). Pa më thuaj tani, nuk do njeri?

MERUSHE.

Veç juve.

ZYBER.

Veç afërsisë s'ënë?

MERUSHE.

Veç afërsisë kë do të dua tjetër? ... He, dhe Saide-
në vajzën që kemi fqinje.

ZYBER.

Jo, nuk të pyes për vajzat, nga burrat?

MERUSHE.

Ne s'kemi nonjë mashkull t' afërt që t'a dua.

ZYBER.

Nuk do nonjë djalë fare?

MERUSHE.

Ç'farë pyetje kjo? *(me vethe)*. Më ruaj o Perëndi.

ZYBER.

Do, do, thuamë mos më paç, kë do? Në mos do
njëri bë-më be!

MERUSHE, *me vethe*.

Be... Ah! o Perëndi! ... *(Si kur gjeti gjë përnjë-
herë)*. Për kokët t'uaj s'dua njeri tjetër dhe vetëm ju-
ve dhe vëll...

ZYBER.

Hë; dhe tët vëlla Rexhepnë, ashtu si vëlla ta kesh. Sa më gëzove bijë! (*E puth të bijën dhe hiqet më një anë. Merushja rri e mejtuar. Zyberi me vethe*). Këta ndruhen t'i thonë vëlla njëri jatrë; me gith këtë dhe shumë duhen. Vallë kjo dashuri e vëllezërisë të jetë? a po mos është tjetër lloje... Do kupëtuarë kjo gjë...

Përnjë-herë duket Rexhepi me një qëngj në dorë. delja e ndjek pas.

Pë r f l i m VIII.

ZYBER, REXHEP, MERUSHE.

REXHEP, duke rrëfyer qëngjin.

Vështroj-e Merushe, sa i bukur është!

MERUSHE.

Oh! sa i bukuri! (*E mer në prehër, e fërkon dhe e puth.*)

ZYBER.

Rexhep; djalë! qëpari u-thashë cilin të doni do të ja u ap. (*Rexhepi përnjëherë hap sytë*). Tani t'ime bijë e pyes „cilën do” ajo më thotë „s'dua njeri!”

REXHEP, trumbullohet dhe me vethe.

Nuk dua njeri thotë! Ah! q'm'u pre shpresa!

ZYBER.

Pa më thuaj djalë, ti s'do njeri?

REXHEP, *me vethe.*

Ah! Perëndi! këtu duhet mejtim.

ZYBER.

Folë djalë! pse turpërohesh? pa shih unë si u pyes
çpënguar; unë ua di zemrën e të rinjet! S'jam nga ata
atër që të mos kujtonj djemt' e mij. Thuaj djalë, mos
më paç thua-më; kë do?

REXHEP.

Unë? (*Me vethe.*) Ah! ç't'i them?

ZYBER.

Nonjë vajzë nukë do?

REXHEP.

Vajzë! jo, jo; nukë dua.

MERUSHE, *me vethe.*

Ah! ...

ZYBER.

Fare, ë?

REXHEP.

Veç t'ime motër.

MERUSHE, *me vethe.*

Të motrën! Mua më do!

ZYBER.

Vetëm t'ët motër do ë? ... Më paç uratën djalë!
duaj-e t'ët motër; ta duash kur-do-herë.

REXHEP, *me vethe.*

Time motër!

MERUSHE, *me vethe.*

Të motërnë!

ZYBER, *hiqet më një anë dhe me vethe.*

E mora vesh, e mora! duhet fshehur më no një
vënt që t'i-kuptonj më mirë. T'i dëgjonj me veshët e
mi, në është vërtet se e duan njëri jatrin tjetër lloj,
duhen martuar; pse t'i hidhëronj? mirë them; vajza
i do dhënë Rexhepit. He! prandaj më thosh Merushja
„mos më nxir nga shtëpija” ajo paska tjetër mëndje!
Vërtet; kshu do të jetë pa të shohim një herë. (*me zë*)
Bij; unë do të unjem në pshat: lir-i-ni të kullosin dhe
pak bagëtija, pa i unjni poshtë.

Shkon

REXHEP.

Fort mirë atë.

*Merushja me bisht të syrit ruan tanë sa ikën pa i
qaset Rexhepit.*

Përflim IX.

MERUSHE, REXHEP, (pastaj) ZYBERI: Prapa një druri.

MERUSHE.

Rexhep, me të vërtetë më do mua?

REXHEP.

Merushe ah! (për një here mbleth vethen). Qysh s'të dua s'je ime motër?

MERUSHE.

Jot' motër?

REXHEP.

Pse, s'je ime motër?

MERUSHE.

Mirë po...

REXHEP.

Ah! Merushe thuaje ç'ke për të thënë! të lutëm shpejt, se s'ëuronj dot!

MERUSHE.

Jo gjë, vëlla, jo.

Zyberi duket në shesh të përflimit prapa një druri.

REXHEP.

Vëlla!... vëlla më thua mua?

MERUSHE.

S'je im vëlla?

REXHEP.

Jo.

MERUSHE.

E di; vërtet vëllezër nuk jemi po që në vogëli jemi ritur të dy bashkë, im'atë, im' më ty të kanë si djalë, dhe unë vëlla të kam.

REXHEP.

Vëlla? jo, jo!

MERUSHE.

Ah! Rexhep!

REXHEP.

Merushe! tani më bëre të flas; ja po të them...
(*me vethe*) Ah! s'kuxonj!

MERUSHE.

Fol, fol!

REXHEP.

Ja se ku të them: Mua s'më ke vëlla! unë jam i godituri yt!

MERUSHE.

Ah!

ZYBER. *prapa një druri, me vethe.*

Hë; mir' e keshe kupëtuar unë!

REXHEP.

Unë ty s'të dua si motër, të kam të dashur.

MERUSHE, *e rëmbyer.*

Ç'thua Rexhep, ku e ke mëndjen! mua më ke të dashur! tét' motër!

REXHEP.

Jo Merushe! t'i s'je ime motër. Ne s'jemi vëllezër; vëllezër janë ata që lindin nga një bark, ne s'jemi as nga një mëmë as nga një atë.

MERUSHE.

Ashtu; po ne s'jemi kushërinj?? pas zakonit të vëndit një është si vëllaj dhe kushëriri. Veç kësaj im' atë, im' më, të dyve me një sy na shikojnë, bij na kanë.

REXHEP.

S'janë gjë këto; s'na ndan dot njeri neve. Vetëm na ti trëmbem që s'më do mua, na...

MERUSHE, *e rëmbyer.*

Unë? unë s'të dua ty? ... Ah! Rexhep! ... Ah! Perën-

di!... Rexhepi! dhe unë ty... (me vethe) S'kuxonj t'i them!

REXHEP.

Merushe! dashq Perëndinë! Sose fjalën, sose! fol!

MERUSHE.

Rexhep! dhe unë ty të jam goditur, s'të dua si vëlla... tjetër lloji të dua! Ah! Perëndi! këto fjalë s'kuxonj t'i them! më duket sikur më dëgjojnë gurë e dru-rë! sikur do të përmbysset gjithësija! kam frikë! Ah! gjer dje flinim në prehrit të njëri jatrit, diheshim vëllezër... sot duhemi tjetër lloje! Ti i dashuri im, unë e dashura jote, ah! kjo është një punë e keqe! ky është një faj i madh, Rexhep!

REXHEP.

Ah, vërtet është, a po ëndër shoh! Merushja mua më do!... Merushe! vërtet më do mua? a të besonj?

MERUSHE.

Rexhep; unë ty të donje që me kohë dhe më tepër nga shpirti të donje... po si vëlla!

REXHEP.

Ah!

MERUSHE.

Shumë kohë kam që m'u-ndërua mëndja, përpara dashuria jote më qe prehje e shpirtit, po tani më dogji mushkërinë!... më ndezi gjaknë! më përvëloi zëmrën sa s'munt ta duronj! (e qafon Rexhepnë). Ah! Rexhep, ty të dua!... të dua, po jam e helmuar!

REXHEP.

Ah! Merushe! kur të të dua unë ty dhe ti të më duash mua, për se të helmohesh?

MERUSHE.

Ah, Rexhep! neve bota na dinë vëllezër, im'atë im' më kurdoherë më porositin të të dua si vëlla...

REXHEP, *ia pret fjalën.*

Dhe mua ashtu.

MERUSHE.

Im' mëmë, martesat e këtilla nuk i do! im'atë s'besonj t' apë lejë për martesje!

REXHEP, *i hidhëruar.*

Vërtet!

ZYBERI, *prapa drurit me vethe.*

Ah! bijt' e mi, më këputtë shpirtin! s'e duronj dot!

MERUSHE.

Ah! s'më ngjan ta shohim pemën e kësaj dashurie!
fundj' e kësaj hidhërim është! hidhërim!

Zë sytë dhe qan,

REXHEP, *e përqafton.*

Vërtet hidhërim! s'kam shpresë fare!

ZYBERI, *del përnjëherë në shesh.*

Përflim X.

MERUSHE, REXHEP, ZYBER.

ZYBER, *me të pushtuar të dy.*

Për se të helmohi bij! ç'të doni do t'u bëhet, juve do t'u martonj dhe unë këte donje! gëzohi bij gëzohi! (*ngre duart i lutet Perëndisë*) Oh! lavdi paç o i madhi Zot! Ja; djalit një nuse, dhe vajzës një burë si ma desh shpirti! bijë, s'donje, të mos dalç nga shtëpia? Ja; nuk do të dalç. Këta male nuk do t'i lesh! edhe paskëtaj si ke rojtur, do të rosh... veç kaqë gjë është, që përpara të thoshe ta duash si vëlla Rexhepnë; tani po të them ta duash si burë. Ja; që tani jini të vluarë.

MERUSHE, *e turpëruar.*

Po... im' më...

ZYBER.

Dhe ajo do të dojë; ja se ku u them pa dyshim.

REXHEP, *i puth dorën Zyberit.*

I dashuri atë!

ZYBER.

Djalë! (*Merushes*) Qas — m'u dhe ti bijë mos ri e turpëruarë. (*I ze të dy prej krahu dhe i jep dorë për dorë*). Ja! po u vlonj ne njëri jatri; Zoti e bekoftë këtë vlesë! bij, tani gjeni nganjë lule dhe çkëmbej-i-ni në njëri jatri.

REXHEP.

Lule?

ZYBER.

Mirë them djalë, lule; se çkëmbim' i malësorëvet, i barinjvet lulja është!... unazat, xhevret dhe shumë të tjera!... Janë për njerëzinë e qyteteve!... për neve lulja është, se dhe ju nga një lule jini.

REXHEP.

I dashuri atë! s'di qysh t'i lutemi Perëndisë për ju!

Të dy ia puthin dorën Zyberit, dhe ai i puth në ballë.

ZYBER.

Tani gjeni na një lule të shohim e kujt do të jetë më e bukur. *(Merushja me Rexhepnë venë të gjejnë nga një lule. Zyberi me vethe.)* Oh! o perëndi sa gas i madh! trëmbem mos më gjenjë gjë nga gëzimi! *(përnjëherë hidhërohet)* Ah!... Perëndi, Perëndi! sa s'të vjen keq! ç'bëhej të kish rojtur dhe i mjeri Dajlan, të merte dhe ay pjesë nga ky gas!... *(Merushja me Rexhepnë vinë me nga një lule ndër duar.)* Çkëmbej-i-ni tani lulet t'u shoh, bijt' e mi! Cila është më e bukur! *(duke vënë lulet.)* Si njëra-tjetra! edhe ato si ju... t'u-ap edhe unë nga një lule?

MERUSHE.

Vërtet o atë! nëm — na dhe ti nga një lule.

REXHEP.

Sa mirë bëhet!

ZYBER, i rëfen Merushen Rexhepit.

Ja; ty një lule! (*i rëfen Rexhepnë Merushes*) Ja dhe ty një lule! (*Rexhepi me Merushen sikur qeshin të turpëruar.*) Më të bukur se ju më s'ka lule o bij! kurdoherë barinj, barinj! të jini: mëmëdhenë ta doni. dashurin' e këtyre maleve ta mbani në zemër bashkë me dashurinë tuaj. Kur-do-herë t'urtë, të mëncim, të nderçim të bëhi. Vetëm këto kërkonj nga ju Zoti u-faltë!

REXHEP.

I dashuri atë! të paçim për jetë!

ZYBER, *duke ngritur duart.*

Të gjithë bashkë! tashti djalë, neve të dy të mbledhëm dhëntë, dhe Merushja të mbledhë shqerat, pa të vemi t'i apim sihariqin dhe sate éme.

REXHEP.

Fort mirë atë!

Vështron Merushen me gas dhe ikën pas Zyberit

Përflim XI.

MERUSHE, *pastaj SELFUA me shokët.*

MERUSHE, *vetëm.*

Edhe s'besonj; vërtet është? më duket si ëndër! Unë do të mar Rexhepnë, do të më soset dëshira! ... oh! lavdi paç o i madhi Zot! (*duke vështruar lulen që ka në dorë.*) Kjo lule sa e bukur! sa ngjyrë të mirë ka! sa mirë mban erë! (*Në këtë kohë duket Selfua me*

shokët; Selfua shkon përpara dhe vë vesh.) Vallë vetiu ta ketë këtë erë? a po e ka marrë nga dor' e ati! ... ah! kjo lule do të jetë për kujtim! ... Sikur të munt ta ruanj bashkë me jetën time këte lule! ... Kjo do të ma kujtonjë kur do — herë, këte ditë të bekuar! ...

SELFO.

Mos e beso!

MERUSHE, *kthehet me rëmbim, me të parë Selfon.*

Ah! prapë ay! ...

SELFO.

Ajo lule s'është gjë që ron, gjer të ngryset thahet ajo; humbet si dita! Kaqë të dish që dhe dashuri e të zot, bashkë me atë do t'i shuhet!

MERUSHE, *me rëmbim e zemëruarë.*

Ah! ç'më thotë! ...

SELFO, *nxjerr një unazë të florinjtë dhe ja xgjat.*

Na të të ap unë këte unazë ta kesh për mall tim, e të ronjë bashkë me jetën tënde; dhe kshu të mos na shuhet kur dashuria!

MERUSHE, *hiqet prapa me zëmrir.*

Me ç'trimëri kuxon e m'i thua këto!

SELFO.

Qysh kuxon ay që të dha lulen, ashtu kuxonj edhe unë. Me trimëri të dashurisë!

MERUSHE.

Gjer aty o zot; këto fjalët' e tua më thyejnë nderë!
Ç'më ditke ti mua? ay që më dha këte lule është' i vluari im, ështëë buri im!

SELFO.

I vluari yt? buri yt? ... Jo, jo! buri yt unë do të jem.

MERUSHE.

Ti? mos e dhëntë Perëndia! shumë e tepërove e zot! pa hiq! hiq se vjen e të gjen im' atë pa më s'shpëton dot nga thonjt' e tija!

Mer krabën, lëkurën dhe ikën shpejt e zemëruarë.

SELFO.

Unë "trëmbem nga yt' atë; vetëm nga ti kam frikë, nga ti! (*duke ndjekur*). Qëndro aty pakë! (*Merushja s'kthehet, por mer udhën'e saj.*) I viuar' i saj! bur' i saj! (*shokëvet*). A e dëgjuat — qënka zënë! do të marë një tjetër, padyshim ay djali që thashë unë është! ay i dha një lule dhe ja mbajti, unë t'i ap një unazë të florinjte e të mos ma mbanjë; të më kthenjë krahët! Qysh munt të ronj unë? Jo, jo! unë s'heqë dorë kurë nga ajo! si cilit do që ta dojë, shpirtin do t'i marrë! kufomën le t'i shohë! T'ikim! ...

PAMJ' E DYTË

Në Progonat një shesh. Për së largu duken malet të veshura në pem' e në drurë. Kasoll' e Zyberit më të djathtë, ca më tej një luath pshtjellë me gardh, më të mëngjër kasoll' e Saidesë; ca më tej një krua, në koritet të krojit vënë ca enë dhe rreth koritës ka ca gurë. Vahideja ka ndënjur mi një gur përpara derës dhe po tjer lesh.

Përflim I.

VAHIDEJA, vetëm duke tjerë lesh.

Vërtet; vajza e vogël është... edhe të gjashtëmbëdhjetat s'i ka mbushur; po dhe fati si i del kur-do-herë përpara. Nga një vënt i mirë ma kërkojnë, për djalin e Fetah Borshit. Djali e paskish parë vajzën dhe e pëlqeu... Im shoq s'e di ç'do të thotë? s'më ngjan të mos dojë dhe ay... pa të vinjë njëherë... *(i këputet peri)*. Ç'është kshu! pse më këputet kaqë peri?... s'e kam mëndjen më një vënt; me gjithë këte dhe shumë nxitonj, të mos nxitonj pa ç'të bënj? Sot tërë ditën më la pa punë gruaja që më kërkoi time bijë; nesër vajza kërkon lëmshe për në mal... E... ç'të bëjmë, pa tjerim dhe natën ca. S'di po s'e heqin për mirë kur këputet peri! dhe mua s'më duket shenjë e mbarë kjo. A! jo,

jo, s'e ap vazjën atje; s'sihni nuk' është mbarë p'an-
daj më këputet peri kshu! S'do dhënë... po dhe vënd'
i mirë. Pa të vinjë dhe im shoq një herë...

Saideja me çorape ndër dorë del prej kasolles.

Përflim II.

VAHIDE, SAIDE.

SAIDE.

Zonja Vahide; nuk erdhi Merushja?

VAHIDE.

S'erdhi bijë ç'e deshe?

SAIDE.

Jo gjë! po e desha.

VAHIDE.

A! dhe ti moj bijë; s'e lëshon nga goja fare Meru-
shen! ajo që posa vjen për ty pyet, dhe ti nje-zet herë
ditën pyet për të... sikur kini dhetë vjet pa pjekur!

SAIDE.

Ç'të bëjmë? shoqe jemi, e duam njëra jatrën, të
mos duhemi?...

VAHIDE.

Unë s'them të mos duhi, po dhe dashuria ka ra-
dhën e saj; kshu si juve tër ditën!...

SAIDE.

Po ç'të bëjmë?

VAHIDE.

Qysh ç'të bëni! të punoni bijë, punë kërkojmë nga juve! ju tani u-rrittë; do Perëndia për së shpejti u del fati dhe martohi; pa si të vini te burri gjithë punët ju do t'i shihni; fëmijën me duart tuaj do t'i vishni e t'i mbathni.

SAIDE.

A! Zonja Vahide; s'është e drejta të qahesh nga jote bijë; e mjera tër-ditën e shkon në mal; më një anë kullot bagëtinë, më një anë bën çorape, dhe këtu mbrëmje e mëngjes të ndih për çdo punë, tjetër ç'kërkon?

VAHIDE.

Mirë ajo; po ti?

SAIDE.

Qysh, s'punonj, më di mua? A, s'më paske kupë-tuar mirë. Në do urdhëro të ryjmë brënda, pa e sheh se ç'punë kam bërë. Sot e mbusha rodhan' e avëlmendit; veç asaj (*duke rrëfyer çorapen që ka në dorë*) dhe këte po e sos.

VAHIDE.

Më paç uratën bijë; puno vashë, puno, mos ju ndaj punës. Në marçi nonjë burë tjetër s'e di, po në qoftë bari, punë pret nga juve.

SAIDE.

Eh! kush sjell ndër mënd gjëra të atilla?

VAHIDE.

Mos më rrëfe mua ti! se dhe unë kam qënë njëherë si ju. Vajzat kur-do-herë burat, mejtojnë.

SAIDE.

A! dhe ti zonja Vahide!

VAHIDE.

Unë s'them se është e ligë, kshu është e drejta. Vajzat jetën' e tyre me burat do ta shkojnë; e lenë më një anë t' anë, t' ëmën, vëllezërit, shtëpin' e t'et; nganjëherë ndahen dhe nga mëmëdheu, e venë te buri. Si martohen nukë shkon tre a katër muaj, të gjitha i harojnë, gjithë dashurinë te buri e shtijen. Kshtu është thënë nga Perëndija.

SAIDE.

Për juve munt! ...

VAHIDE.

Jo vetëm për mua bijë, për tërë botën kshtu është. E... ç'dini ju që tani! Si të martohi, pa kuvëdojmë të dyja bashkë... Qysh kshu? Vajzat martesën e pandehin se është nonjë dëfrim për to! Jo bijë; s'është' ashtu, do të vijë një ditë që ta kupëtosh dhe ti martesën se sa është gjë e uruar; është bekimi i Zotit. (*Merushja duket me krabë në dorë.*) Ja! dhe Merusheja po të vjen, (*me vethe*) ma lëntë Perëndia; u-rit, u-bë grua, po si ta martonj si të bënj unë pa të?

Përflim III.

VAHIDE, SAIDE, MERUSHE.

SAIDE, *Merushes me nga dalë.*

E... qysh shkove sot në mal? të erdhi ay, të ra prapë më qafë?

MERUSHE.

Cili ay! He! erdhi po ja preva sot; s'besonj të më gaset dhe herë tjetër pas këtaj. Po... Ah! Saide! kam shumë gjëra për të thënë.

SAIDE.

Thuaj ç'ke!

MERUSHE.

Të vemi në krua pa të t'i numëronj të gjitha me radhë.

SAIDE.

Eja të vemi. *E zë pej dore dhe e heq.*

MERUSHE, *Saidësë në vesh.*

Prit pakë, prit.

VAHIDE, *me vethe.*

Vështro, vështro; Saideja që më thosh qëpari „neve nukë mejtojmë gjëra t' atilla”; po kjo e pështëllitur vesh më vesh ç'është?... Të pshetat e vajzavet, ç'do të jenë? Ja për martesë, ja për dashuri. Do Perëndia e s'e ka synë me njeri ime bijë. (*Këputet peri*). Prapë

u-këput i flamosuri! ka një djallëzi në këte punë, po
veç dhëntë Perëndia e u largoftë! pa tjetër ç'të them.

MERUSHE, *nxiton drej së ëmësë.*

Ç'bën mëmëzë? A! vetëm këta ke tjerë? ...

VAHIDE.

Keshe dhe tjetër punë sot bijë!

MERUSHE.

Mirë; po nesër ç'do të punonj unë në mal? pa vë-
shtro; ata që më dhe e sosa që në mëngjes.

Prapë i këputet peri Vahidesë.

VAHIDE.

Pse më këputet kaqë peri?

MERUSHE.

S'është lesh i mirë, prandaj.

SAIDE.

Le! unë s'punoj dot me lesh të lik sikur...

MERUSHE.

Dhe unë ashtu.

VAHIDE.

Mirë; bijë, po ku e gjejmë gjithnjë lesh' e mirë?
Neve në punofshim vetëm të mirët, pastaj të liktë
kush na i punon?

SAIDE.

Vërtet; edhe ajo është, po...

VAHIDE.

Edhe ky s'këputet se është lesh' i lik, po është nga rrëmbimi im; se dua t'ja arrinj sime bije për në mëngjes, nukë shihni sa nxitonj?

MERUSHE.

Pse lodhesh mëmëzë? mbrëma rrimë ca më shumë dhe e sosim bashkë.

VAHIDE.

Mirë; po yt vëlla ku është bijë?

MERUSHE, *me vethe*.

Im vëlla? Ah! kjo s'di gjë; po në mos dashtë...

VAHIDE.

Pse s'më përgjigjesh bijë? Rexhepi ç'u bë?

MERUSHE.

Tani vinë, se mjelin dhentë me t'im' atë.

SAIDE.

Ti nuk do të vesh për ujë, o Merushe?

VAHIDE.

He! paç uratën, mirë bëre që na i kujtove. (*Merushes*). Rëmbje dhe ti enët hiq i mbush bijë, se s'kemi as pikë.

MERUSHE.

Mirë mëmë.

SAIDE.

Të mar dhe unë enët pa të vinj. Merushe; piqemi në krua.

Merushja mer më të djathtë, dhe Saideja më të mëngjër, venë nëpër kasollet të marin enët; pastaj dalen dhe venë në krua; enët i vënë të mbushen dhe vetë pinë mi nga një gur e kuvëndojnë.

Përflim IV.

VAHIDE, *vetëm.*

Sikur e kanë për ujë; duan të kuvëndojnë me njëra jatrën, vallë ta disha për se kuvëndojnë? sikur të pshihem gjëkunt e t'i dëgjonj! Jo, jo! s'ma do shpirti; ç'më duhet mua t'u dëgjonj fjalët e tyre! kuvendi i dy vajzave çdo të jetë? gjithë për dashuri; ç'të duan le të kuvëndojnë; zëmër e të riut plot dashuri është; pema e të riut dashuria është. Të ritë e njeriut, nëse i shkon me dashuri, pa i vjen keq kur e kujton atë kohë. Dhe dashuria s'është gjë e ligë; vetëm sos, që të jetë me nder. (*Duke vështruar vajzat që rrinë në krua*). Vështro! sa me ëmbëlsirë kuvëndojnë! E... jetë e njeriut kjo kohë është... dhe unë kur qesh e re njëherë, kshu kisha një shoqe të dashur; i ndrittë shpirti atje ku ka renë! ku janë ato ditët e para që shkonim të dyja bashkë! e kisha shoqe, si për gas, dhe për helm! me të hapnim gjithë plagët e zëmërës; Kuvendonim gjithë fjalët e shpirtit! E... është për ta qarë atë kohë! po ëndrat ç'u bënë? ... Tani pse s'shoh nonjë ëndër fare! Ah! pleqëria është si nata, si thratim i dimërit! po të ri-

të është si mëngjezi, si lule e verës! Ah! ku është ajo kohë! (*Bijë ndë mejtim*).

Vashat rëmbejnë enët dhe kthehen nëpër kasollet.

Për një herë duket Zyberi.

Përflim V.

ZYBER.

Grua! ç'më ep diç të të them?

VAHIDE.

Për të mirë qoftë; ç'u bë?

ZYBER.

Do të të thëm një gjë të mirë; shumë të mirë! Sa do të gëzohesh!

VAHIDE.

E di se ç'do të më thuash o zot; ja nonjë dele ka pjell... ja se...

ZYBER.

Jo, jo; s'munt ta gjëç.

VAHIDE:

Edhe në mos qoftë kshu, prapë no një tjtatër e kë-tillë është. M' e mirë se ajo që di unë nuk' është a?

ZYBER.

Çë? ke dhe ti gjë për të thënë? munt të dish dhe ti atë që di unë... Të tha gjë vajza.

VAHIDE.

Ku e di vajza se ç'bënj unë. Kjo është një gjë shumë e mbarë për neve!

ZYBER.

Sado që të jetë; më e mbarë se imëja s'bëhet! A dëgjon ti? Kjo është një fatbardhësi për neve! Po pa marrë sihariqsin mos pandeh se ta them.

VAHIDE.

Për neve fatbardhësi? ç'munt të jetë? a mos ke gjetur no një qyp me florinj?

ZYBER.

Ç'thua dhe ti të paça mëndjen! fatbardhësi e njeriut vetëm me florinj është' e di ti a? si të qe kështu, gjithë të pasurit duhet të quheshin fatbardhë; po ne i shohim se ata janë më fatkeq se neve.

VAHIDE.

Lëmë se do ta them unë më parë.

ZYBER.

E he, thuaje të shohim.

Nxjer duhan nga qesja që ka lidhur më bres dhe mbush çibuknë, pastaj i vë eshkën dhe zë të pijë.

VAHIDE.

Mirë; po sihariqsin?

ZYBER.

Ç'kërkon ti?

VAHIDE.

Një mish të pjekur në hell.

ZYBER.

Mirë; në dashtë Merushja, sa i do ajo shqerat, ku le të theret no një!

VAHIDE.

Ti di; në daç bleje së jashtësmi.

ZYBER.

E, mirë; fol.

VAHIDE.

Na kërkojmë vajzën!

ZYBER.

Neve s'kemi no një vajzë për të dhënë; ajo u bë nuseja jonë.

VAHIDE.

Ç'thua kshu? unë s'e ditkam këtë gjë.

ZYBER.

Edhe unë këtë desha të të thoshe; po ti s'më le që, ç'të të bënj!

VAHIDE.

Thuaje shpejt qysh u bë?

ZYBER.

Jo; sose ti një herë, pa ta them unë.

VAHIDE.

E ja, ta thash; vajzën na e kërkojnë, po...

ZYBER, *i pret fjalën.*

Kush?

VAHIDE.

Nga një shtëpi e mirë në Borsh...

ZYBER, *me zemërim i pret fjalën.*

Në Borsh? Mos e dhëntë Zoti!

VAHIDE.

Pse?

ZYBER.

E... pa sosë të shohim.

VAHIDE.

Për Selfon, të birin e Fetah Borshit...

ZYBER.

Cilido le të jetë, poqë është nga Borshi...

VAHIDE.

Ç'kanë Borshasit o burë? të gjithë njerës të mirë,
trima janë.

ZYBER.

Ashtu vërtet; po ç'më duhet trimëri e atyre mua?
unë herën' e parë kërkonj prëhjen e vajzës pastaj
u-pyes trimërinë. A e di ti që këta Borshasit më s'të
kanë as punë, as no një mjeshtëri fare. Këta kurdohe-
rë rrinë me armë ndër duar; presin të hapet no një luf-
të pa të sulen. Kur të shohç nesër a pas-nesër hapet
no një luftë, pa ngrihet dhe dhëndri e vete të lëftonjë
mun n'anët e gjithësisë! pastaj ç'bën? e mjera vajzë
mbetet vetëm e heq mallnë e burit; pa në ju vraftë
dhe i shoqi, ahernaj nxihet; mbetet e ve për jetë! Pa
le, këta kanë zakon që s'e nxierin as jashtë. Qysh të
duken, të mira janë këto?

VAHIDE.

Ah! mirë thua këtë e ke të drejtë.

ZYBER.

Pa më pyet mua një herë për t' an' e Selfos! Ka
pes-mbë-dhet vjet që ka dalë jashtë shtëpisë dhe nuk
është ndjerë gjëkunt fare! i gjallë a i vdekur është
s'munt ta dijë njeri! e zeza e shoqja pas tri vjet që i
ikur buri hyri në dhetë, nga mall' i tija shkoi për jetë e
mjera!

VAHIDE.

Ashtu i qe thën'atij... po i biri është pranë Demir
Beut.

ZYBER.

E di; pas Demir Beut është; ri e shtrihet tërë ditën pa punë: ha bukën' e të tjerëvet që kanë fituar me djersët të ballit! Ke dëgjuar ti të jetë dhënë vajzë në Borsh nga pshati ynë? Ata neve na quajnë barinj, bujkër; s'na kanë në radhë të tyre, dhe neve ata i dimë se ç'të mërzitur janë pa nuk i quajmë për njerës! ... Vajzën t'ime ta ap ndë Borsh é... mos e dhëntë Perëndia...

VAHIDE.

Mirë, po ay e paskish parë vajzën dhe e pëlqeu.

ZYBER, *me zëmrim.*

E di të mallëkuarin; për dit' i hirohet vajzës në mal...

VAHIDE.

Ah! i pa udhi!

ZYBER.

Pa le; kuxon e heq dhe valle me shokët'e ti përpara saj! ... S'desh Perëndia të më nxirte atje, pa më shihte se ç'i bënj... E ndenje pa shpirt për dhe apo jo! ...

VAHIDE.

Ah! pastaj ç'i bëhej nder' i vajzës! Kam frikë se dhe vajza për té...

ZYBER.

Jo, vajza hiqet nga ay; s'do ta shonë kurë me sy! Ajo e ka synë gjëtkë.

VAHIDE, *me rëmbim.*

A! në kush?

ZYBER.

Ne i shoqi. Se ay i quhet bur' i saj tani.

VAHIDE.

Pa pyetur dhe mua... është punë që bëhet kjo? ...
pa më thuj cili është ay? ...

ZYBER.

Rexhepi.

VAHIDE, *për një herë e hump.*

Cili Rexhep?

ZYBER.

Rexhepi ynë, s'e di?

VAHIDE.

Ti më ngjan se prishe mëndjen o burë? Rexhepnë
e ka vëlla ajo.

ZYBER.

Jo! zonjë; gjer më dje e kish kushri, po paskëtaj
do ta ketë burë.

VAHIDE.

Kjo s'është punë që bëhet; unë s'dua!

ZYBER.

Në do t'i qash që të dy; këta aq' e duan njeri jatri, sa veç vdekja i ndan! t' ishe atje sot, pa t'i shihnje si ishin përqaftuarë të dy e qanin me ngashërim; trembëshin mos i largojmë ne nga martesja. Më këputnë shpirtin; pa s'm'u durua! Për një herë u-derdhç e i pushtova dhe u dhashë fjalë se do t'i martonj ne njëri jatri. Unë fjalën s'munt ta kthenj, pa ti si të duash bëj!

VAHIDE.

Kur qënka kshu, ç'mund të them unë? ... vetëm kam frikë që thonë se s'është mirë të bëhen punëra të tilla në mest t' afërisë, i ndritë shpirti s'ime nunële, kur vdiq la fjalë që të mos marim e të mos apim në mest t' afërisë.

ZYBER.

Tani kjo kshu le të bëhet; pa fjalën' e asaj e ruaj për tjetër herë.

VAHIDE.

Ta dish ti ç'qe ngaj' e kësaj fjalë që ka lënë ime nunële! ...

ZYBER.

E... ç'qe?

VAHIDE.

Të thash' a! s'është mirë! Perëndija na ruajtë, ajo kish marë djalën' e së emtësë! ... Motra e parë që u martua, u shuan gjashtë shpirt nga afëri e saj, e nga e buri! ... Gjashtë shpirt këta: ... prandaj kurdoherë

thosh: „s'është e mirë martesja në mes të afërisë!”
Kish frik' e mjera, pa e la këtë fjalë! se i kish ardhur
mi krye së zezës! sa do të bëjmë mirë sikur t'a mbaj-
më dhe neve!

ZYBER.

S'janë gjë ato që thua ti, unë s'besoj gjëra të atilla.
ç'ka ka këtu që të mos jetë mirë?

VAHIDE.

Kështu s'besoni gjë, ju burat! unë kam frikë, se
m'u këput dhe peri që tirnje, një tok herë sot!

ZYBER, duke qeshur.

Ha! ha! ha! daçi Perëndinë mos u vini vesh gjëra-
vet të tilla, që s'ja mer as mëndj' e njeriut! sa lark
është martesj' e vajzës me penë tënt?!

VAHIDE.

S'di qysh të të them mor burë; Martesja që është
bërë në mest të afërisë kurdoherë s'ka dalë e mbarë;
Vërtet; këta s'janë dhe aqë t'afërt, po janë ritur si
vëllezër të dy.

ZYBER.

Ç'të duhet ty? neve na i jep dhe feja.

VAHIDE.

Unë jam grua, s'm'i-mer mëndja këto; vetëm zako-
nin e vëndit vështonj unë.

ZYBER.

Pakë njerës ka që kanë marë kushërinjtë në vënt téné?

VAHIDE.

Shumë ka; po kush ka parë të mirë?

ZYBER.

Janë fjal' ato, s'i dëgjonj unë. Tani leri këto, vajzën t'ja apim Rexhepit, të mos i ndajmë se duhen shumë me njëri jatin; n'u bëftë kshu do të na mbetet dhe vajza brenda; që kjo është një gje fort e mbarë për neve; pa në mos u bëftë kshu, vajzën kemi për të nxjerë jashtë; dhe Rexhepit do t'i marim një nuse që s'e njohim dhe vetijat s'ja dimë fare; ahernaj kam frikë se nuk bëhet mirë për neve; pa n'u bëftë kshu si them unë, do të jemi fatbardhë kurdoherë.

VAHIDE.

Kjo është e drejtë, po nuk besonj të duhen kshu si thua; duhen po si vëllezër.

ZYBER.

Nuk mer vesh ti? unë të them i dëgjova me veshët e mi; këta duhen tjetër lloje, aqë sa qanin qëpari!

VAHIDE.

Të drejtën, s'pritnja të tillë nga imme bijë! sa dukej e urta...

ZYBER, *i pret fjalën.*

Qysh no një faj bëri, e pandeh ti a? ... Unë e kam

për gas këte punë; vetëm kam frikë mos doj' até Selfon si thua ti, pa st'rëmbem nga gjë tjetër. Tani t'i thres të dy, të të puthin dorën, dhe ti u — roji; nukë bën?

VAHIDE.

Ah! Merushen dhe Rexhepnë q'i pushtonje si motër e vëlla; tani t'i shoh bur' e grua!

ZYBER.

E... ç'u-bë? vajza si ish përpara, prapë jona do të jetë! dhe Rexhepi do të bëhet dhëndër, që prapë djali yt quhet.

VAHIDE.

S'di qysh të them? ... sepse s'ma do zemëra këtë punë.

ZYBER.

A! dhe ti! leri këto (*Përnjëherë Rexhepi duket dhe Merushja del prej kasollës*). Ja; po vijnë.

Përflim VI.

ZYBER, VAHIDE, REXHEP, MERUSHE.

ZYBER.

Ejani bij, ejani! (*i ze të dy pej dore dhe i sjell përpara së shoqes*) puthini dorën mëmës, se do t'u u — ronjë.

Rexhepi me Merushen i qasen Vahidesë.

VAHIDE, *me vethe.*

Ah! o Perëndi! ç'është kjo trazimë që ndjenj në zemërë!

Rexhepi me Merushen e vështojnë në sy të mejtuar.

ZYBER, *me zemërim.*

Vahide! pse ngrive kshu? pa vështo: po i helmon t'ët bij!

Vahideja i puthë të dy dhe kthehet më anë tjetër e fshin lottë.

Mblidh vethen Vahide! ç'është kshu! Yh! yh! turp që je grua malësori! do të martosh t'ët bijë dhe qan e...

VAHIDE.

A! dhe ti! ja s'qanj.

MERUSHE, *i qaset së ëmësë.*

Mëmëzë.

E ëma puth të bijën.

ZYBER.

A e di ti grua? këto dit kemi dasmë!

VAHIDE.

Kush na nxiton kaqë?

ZYBER.

Këta tani u vluan, s'munt të rinë të pa martuar më një shtëpi.

VAHIDE.

Rexhepnë e dërgojmë në shtëpit të s'emtësë.

ZYBER.

Jo, jo, s'e-nxjer djalën nga shtëpia unë; që nesër s'ka; do zënë dasma.

VAHIDE.

Që nesër?

ZYBER.

Ashtu po; unë sot mbrëmanet nisem për në Tepe-
lenë; vete i mar të gjitha ç'na duhen, dhe ti vështo pu-
nët e këtushme. Epu ze miqet, ftoji të gjithë!

VAHIDE.

Mirë; po pse të shkosh natën? nesër në mëngjes
nisesh; s'bën?

ZYBER.

Jo; se nesër duhet të jem këtu unë. Mbremë vete
me hënëzë, dhe nesër më drekë kthenem.

VAHIDE.

E... mirë; po a e di se ç'duhen marrë?

ZYBER.

Ku do t'i di unë? këto janë punë të gravet, juve i
dini; vemi brënda m'i thuaj një-nga-një të gjitha ç'du-
hen marrë.

VAHIDE.

Mirë, të vemi.

Të dy ryjnë në kasollet.

PAMJ' E TRETË

Tepelenë në kontakt të Demir Beut një sallë; —përpara sallës një derë. Më të mëngjër një minder. Ca pushkë, kobure, palla dhe armë të tjera varur nëpër perona. — Selfua dhe shtatë a tetë shokët e tij kanë ndënjur përdhe e po i fshijnë armët. Një thëllënxë ndëkulvi është varur më një anë.

Përflim I.

SELFO, XHAKO, RAPO, SULÇE, ARSLLAN,
EVRENOS.

SULÇE, *ngre pushkën përtpjetë, dhe duke vështuar.*

Ha! bre Xhezair! ... një zet vjet u bënë që e kish sjellë i ndjeri im' atë nga Garp Tarabullusi.

ARSLLAN.

Qysh! ka bërë në Tarabullus yt' atë?

SULÇE.

Po; bëri ca kohë në Tarabullus; si erdhi s'andejmi vajti Tunë në luftë të Ruisisë; atje ra dëshmimëtar!

EVRENOS.

Vërtet; në Tarabullus; vanë tok me t'im atë. I mjeri atë, atje më mbet! ..

ARSLLAN.

Zoti e ndjeftë! vdekjen përpara e kemi! të gjithë do të vdesim! Po; vdekja që ngjan për nder të mëmëdheut është më e mirë se të gjitha! të drejtën; unë i kam zili fatit të atërvet t'anë! kockat e ati t'ëndit në shkretëtira të Tarabullusit! Të ati t'imit në për male të Qyrdistanit! (duke rrëfyer Sulçen) dhe kockat e t'et këti mb' anë lumit Tunës i kanë mbetur! sa mirë! kur është gjallë njeriu i shërben mëmëdheut, dhe si vdes kockat e tij në kufit të mëmëdheut i mbeten! — sikur do të jetë mburonjës — për jetë! ...

SELFO, *i hidhëruar.*

Vërtet; ju jini fatbardhë, se: e dini që atërit t'uaj dhanë shpirt për nder të mëmëdheut, e dini se kockat e tyre u kanë mbetur në kufit të mëmëdheut, dhe kësh-tu e kini fjetur mëndjen, u ka gjetur prehje shpirti! po unë...?

SULÇE.

Vërtet; dhe yt* atë bashkë me t'anët kish vatur në Tarabullus. I ndjeri Fetah! ...

SELFO, *i çuditur.*

I ndjyeri?

SULÇE.

Qysh; nukë mbet atje a! ...

SELFO.

Edhe më s'dihet; në Tarabullus mbet a?... më t'jater vënt vajti a?... më t'ardhur në det' u mbyt a?... ron, a i vdekur është, më s'e di njeri! Në është se vdiq për nder të mëmëdheut; a se i erdhi nga Perëndia s'ka gjë... Po në e ka vrarë no një armik, nga kush ta kërkonj gjaknë?...

ARSLLAN.

Mos ndill të këtilla! Yt atë është gjallë, do Zoti e kthehet për së shpejti!

SELFO.

Këte s'ma mer mëndja; po do Zoti e ka vdekur me nder!...

ARSLLAN.

Ah!

SELFO.

Njëzet vjet u bënë që ka dalë; të jetë gjallë pa të mos sjellë ndër mënt lottë e së ëmësë tetë-dhet vjeçe?...

XHAKO.

Munt që të ketë no një gjë, pa s'vjen më shtëpi!

SELFO.

Vetëm një gjë munt të jetë; në është martuar gjëkunt...

ARSLLAN, *me forcë i pret fjalën.*

A! Jo, jo; unë e njoh mirë t'ët atë. Ay është burë,
njeri i nderçim pa shok në jetë! Ay s'e bën kurë këte
që thua ti!

SELFO.

Po; ka vdekur!

ARSLLAN.

Në është i vdekur, Zoti e ndjeftë! në është i gjallë,
do Perëndia e vjen për së shpejti! tjatër ç'të themi.

*Të gjithë qetohen. Ca lënë armët, ca vendosin ko-
buret nëpër sulahe.*

RAPO.

Oh! m'u-këput krahu së fshiri këtë të flamosur
pushkë! edhe më s'i dolli xgjura! S'paçë parë të tillë
pushkë të praptë!... katër a pesë vjet m'u-bënë që e
përdor, nuk' e mbanj mënt të kem shtënë mirë no një
herë; përveç se një herë tek e trazonje m'u xbras, pa
hoça dy muaj plot, nga këmba!

XHAKO.

Kur është ashtu, qysh i ve besë or vëlla? sos; mjaft
e fshive.

Talhaj epet mbë derë.

Përflim II.

Të parët dhe TALHAJ

ARSLLAN.

Eja or Zot; të shohim ç'na ke?

TALHA.

S'ka gjë, ju ç'bëni shokë?

XHAKO.

Ja dhe ne po meremi me armët; ç'të bëjmë?

TALHA.

Ah! Burat si juve duhej të ndodheshin në Mal të Zi tani; po...

RAPO.

Për Zon e vërtetë të kemi lejë nga Beu, që tani nisemi! ç'thua ti Selfo?

SELFO, *me vethe.*

Nuk' e apin! qënka zënë! do ta marrë tjatri!... Ah unë ta unj vethen gjer më një vajzë bariu, pa dhe ate të mos munt ta mar! ?...

TALHA.

Selfo! ç'e ke këte mejtim, or djalë?

SELFO.

As më lerë; ashtu dashç Perëndinë.

EVRENOS.

Qëpari u-bë fjalë për të anë, pa...

RAPO.

Ha! S'është nga ajo. Arsllan! e sjell ndër mënt të djeshmen?

ARSLLAN, *Selfos.*

Hë, vërtetë! ... dije sikur i kishe dërguar njeri t'et; ç'përgjigje more?

SELFO.

As më lini daçi Perëndinë! Juve kërkoni të qesëndisni me mua!

ARSLLAN.

Jo more; me të vërtetë të thotë; fol mos u bëj foshnjë.

TALHA.

Ç'është? Ç'u be?

EVRENOS.

Këta kanë një gjë, po...

SELFO.

Ç'përgjigje do të mar, nuk e apin! E paskan vluar gjetskë!

EVRENOS.

A, u muar vesh.

TALHA, *i habitur.*

Ç'thoni?

ARSLLAN.

S'e di ti a?...

TALHA.

Ç'u bë?

ARSLLAN.

Selfua i është goditur një vajzë' bariu!

EVRENOS.

Yh! për një vajzë bariu!

TALHA.

E?...

ARSLLAN.

Dërgoj një grua ja u-kërkoi, po nuk ja dhanë, se e paskan vluar gjetkë.

TALHA.

Kjo ish e ditur! vajzën e zënë qysh mund ta apin?

EVRENOS.

Një vashë bariu e? ... ç'thua Rapo! vallë ç'farë gjë të jetë?

RAPO.

Për Zonë, shumë e bukur! e pashë me syt' e minj!

EVRENOS.

He! qënka mb' udhë puna!

TALHA.

Vallë cili të jet' i vluar' i saj?

SELFO.

Dhe ay një djalë bariu, është kushërir' i saj.

TALHA.

S'është no një pun' e madhe për ta ndarë nga ai?

ARSLLAN.

Vallë, bën t'i themi Beut ta thëresë t'anë, e t'i thotë për Selfon.

TALHA.

Të doje Beu bëhet, po...

SELFO.

Jo, jo! S'dua t'i rynjë me vesh të Beut kjo punë!
se s'vete dot ta mar vetë un'a?

ARSLLAN.

Pa thënë Beut?

TALHA.

Jo! pa diturë Beu, është punë që s'bëhet! po të dojë Beu e bint menjëherë barinë.

ARSLLAN.

Thuaji një herë Beut or Talha!

TALHA.

Fort mirë, i them; po duhet pritur koha, se mos e dhëntë Perëndia e gjenj n' orë të liga, pa s'di as unë se ku të vete...

ARSLLAN.

Ajo është puna jote.

XHAKO.

Selfo, i at' i vajzës, s'është ai bariu plak që na rëfeve dje?

SELFO.

Ay, dora vet' është!

XHAKO.

Unë sot e pashë në trek ate, tek rynte më një dyqan për të marë njera jatrën.

TALHA.

Duket i bëhet gati dasmës.

SELFO, *pushkën në dorë dhe ngrihet për një herë.*

Kur qenka kshu, pse s'më thoni?

ARSLLAN, *e zë Selfon.*

Ri, mos u bëj foshnjë! Tani del Beu dhe i thotë

Talhaj. Do Zoti e soset sa është dhe bariu këtu. T'u-bë e jotja, mos e xgjat tani de!

SULÇE.

Vdiqme uriye o Talha; edhe më s'na u-bë buka?

TALHA.

Është shpejt or vëlla; *(nxjer orën e shikon)* ku je ti? ora tre s'ka vatur.

RAPO, *ngrihet më këmbë me rëmbim.*

Vjen Beu!

Të gjithë ngrihen më këmbë, dhe me rëmbim varin armët. Demir Beu ryn brënda.

Përflim III.

Të parët, DEMIR BEU, pastaj një kalorës)*

DEMIR BEU, *me të ryrë në derët.*

Ç'bëni djem! *(nxjer këpucët dhe ri në mindër)*
Talha! Një kalorës është jashtë; pa e shih pse ka ardhur, dhe kall-e brënda. *(Talhaj del).* Ee...? si ja shputë dije; vratë gjë?

SULÇE.

Vetëm ca shpesa vramë, Bej.

*) Suvári i Mbretërisë.

DEMIR BEU.

Unë mbrëmë do vete për thëlënxa; dy njerës më duhen. Kush të dojë le të jetë gati. (*Kalorësi bashkë me Talhanë ryn në derët; ngre dorën përshëndosh Bejnë.*) Mirë se erdhe! Qysh je djalë

KALORËSI.

Të puth dorën Bej!

DEMIR BEU.

Ngaha na vjen kshu?

KALORËSI.

Nga Janina vinj, Bej; vete në Berat për t'i dhënë një letër Zotërisë suaj shkova këtej.

Nxjer një letër nga kuleta dhe ia jep.

DEMIR BEU.

Letër? pa ta shohim vallë, nga kush e kemi! (*E mer letrën e hap dhe vë re emërin në funt*). Ha! m'a dërgon im bir nga Mali i Zi. (*si e këndon*) Ku është Selfua?

SELFO.

Ç'urdhërove Bej.

DEMIR BEU.

Sihariqin se vjen yt'atë!

SELFO, fort i gëzuar.

Vjen im'atë! (*Vete i bije ndër këmbë Demir Beut*).
Ah! s'di qysh t'i lutem Perëndisë për Zotërinë t'uaj.
(*Demir Beu i bije krahëvet.*) Të lutem, nëm leje Bej,
të vetë t'i ap sihariqsin dhe s'ëmësë! E gjora plakë
do të priset menç nga gëzimi. . . Më ndje Bej; ku qen-
ka?

DEMIR BEU.

Dëgjo të ta këndonj letrën ç'më shkruan im bir.
(*zë e këndon*). „Me Fetah aganë nga Borshi, u poqçë
këtu, tani e kam pranë, këto ditë do ta dërgonj aty”.

SELFO.

Ah! ç'fat është ky! Perëndia më të faltë Bej; të pa-
cim sa malet.

DERIM BEU.

He, mos ri, çap i thuaj së ëmës; të gëzohet e mje-
ra plakë.

SELFO.

Oh, ç'gëzim! sa gas i madh! (*derdhet drejt Beut
dhe i puth dorën*). Lejën Bej. . .

DEMIR BEU.

Udh' e-mbarë; shiko të vijsh shpejt.

SELFO, duke ikur me vethe.

Mirë; po. . . gjer sa të vete e të vinj unë bariu e
marton të bijën. Herën' e parë do mejtuar kjo. (*i qa-
set Talhajt*) Talha! e harove fjalën që më dhe?

TALHA.

Jo, jo; mos ke frikë ti, se nuk haronj unë; çap pa si të vish të shohim...

SELFO.

Ç'thua ti? bariu sot a nesër e marton të bijën.

TALHA.

Ku t'a di unë; kur qënka kshu që tani... pa del e prit jashtë pak.

DEMIR BEU, *Kalorësit.*

Mos ri më këmbë djalë; çap tej në të ndarët u-çlodh. Talha, nxiri kafe shpejt; i nxir dhe bukë se mos e ka marë uria. (*Kalorësi ngre dorën e falet Beut dhe dalin jashtë me Talhanë*). Sa u gëzova që na vjen Fetahu! Ç'thotë Selfua, a u gëzua?

ARSLLAN.

Ata këtu janë ritur Bej; djemt' e Zotërisë suaj janë.

DEMIR BEU.

E di Perëndia, si djem i kam.

ARSLLAN.

Perëndia të shtoftë jetën Bej.

Ryn Talhaj.

DEMIR BEU.

Ç'është Talha? shkoj Selfua?

TALHA.

Kërkon të të lutet dhe për një gjë Zotërisë sate, po s'kuxon të ta thotë vetë; më vuri mua po dhe unë s'kuxonj Bej!

DEMIR BEU.

Ha! ha! ha! ç'farë gjë qënka kjo?

TALHA.

Për Zotërinë t'uaj s'është gjë fare; po për atë është fort e madhe, Bej.

DEMIR BEU.

E... folë të shom.

TALHA.

Qëpari Selfon e gëzove shumë Bej, u-lint përsëri në jetë! po ka një hidhërim në zëmër, që ja mbulon të gjitha! Vërtet; sot atën e gjeti, po nxjer një gjë tjetër nga duart q'e do me shumë se t'anë.

DEMIR BEU.

Ç'kërkon të thuash? nuk të kuptohet!

TALHA.

Selfua kërkon të marrë një vajzë bariu nga Progonati Bej.

DEMIR BEU.

E? ...

TALHA.

Dërgoi njeri e kërkoj nga i ati...

DEMIR BEU.

S'bëri mirë; i ati i tij sot është në radhët tjetër! U shuan vajzat e shokëvet të tij, që të unjet gjer më një vajzë bariu?

TALHA.

Atë vajzë e desh shumë, Bej; aqë sa kur i kujtohet s'i mban dot lottë.

DEMIR BEU.

E... ay di, le t'a marrë; no një punë e madhe qënka dhe kjo a?

TALHA.

Nukë e jep bariu Bej; e ka vluar gjetkë në i kushë-riri i saj! ep urdhër t'i bëhet një gjë Bej, se është hidhëruar shumë i varfëri; sa dhe ardhj' e t' et s'i ryn në sy.

DEMIR BEU.

E... ç't' bëjmë?

TALHA.

Ç'të urdhëronç Zotërote e nuk bënet Bej! në dor' e ke, ep urdhër të vinjë bariu dhe foli për të bijën t'ia apë Selfos; çdo të jetë; një cop bari është ay; s'ta bën më dysh fjalën e Zotërisë sate.

DEMIR BEU.

Mirë; le të vejë një në Progonat t'a thëresë barinë.

XHAKO.

Bariu është këtu, Bej; sot e pashë në pazar.

DEMIR BEU.

Kur qënka këtu hiq e thire të vinjë.

XHAKO.

Mi krye sipër Bej.

Del.

DEMIR BEU.

Talha! pa më thire Selfon.

TALHA.

T'a thres Bej.

Del. Pastaj ryjnë me Selfon.

DEMIR BEU.

Selfo.

SELFO.

Lepe.

DEMIR BEU.

Vërtet dashke një vajzë bariu ti? (*Selfua i turpëruar unj kokën dhe s'përgjigjet*). Pse s'përgjigjesh?

SELFO.

Lepe.

DEMIR BEU.

Pa vështoj; unë dërgova të më thëresin bariun; do t'i flas të t'a apë ty të bijën.

SELFO, *me rëmbim.*

Ah!

DEMIR BEU.

Po sa pa thënë ati, dua të të flas ty të heqësh dorë nga kjo dashuri.

SELFO, *me rëmbim.*

Ah! (*me vethe*) Të heq dorë?

DEMIR BEU.

Fëmija e juaj është nga të parët e Borshit, s'është e udhës për ty të marrësh një vajzë bariu; nesër a pas nesër vjen dhe yt atë, pa s'i vjen mirë nga këto që bën ti! dhe mua më vent të të yt eti më ke. Pa shih sa i dua njerëzit që janë ritur me shtëpit t'enë, ... e di Pe-rëndia s'i ndanj nga djemt' e minj fare.

ASLLAN.

Të paçim sa malet; oxhaku la e më ka Bej!

DEMIR BEU.

Rapo! mbushma ate çibuknë (*Rapua del*). Kështu djalë. Po ti them unë bariut ta jep të bijën; kjo s'është nonjë punë e rëndë; po në artht' yt' atë, ta dish që do të mbetet si i zemëruarë nga unë.

SELFO.

Ç'të bënj Bej? ...

DEMIR BEU.

Do hequr dorë nga ajo vajzë; ja se ku të them: Ti hiq dorë nga ajo, pa unë të gjenj një shoqen tende me të mirë dhe të vlonj; po hiq dorë nga ajo. (*Rapua me një dorë çibukn' e gjatë, dhe me tjetrën mban një tavë të verdhë të vogël; Hyn brenda dhe ja ep Beut në dorë çibuknë, tavën e vë në simsit dhe hiqet prapa*). Ashtu bëj, djalë më paç uratën, ashtu. Ti Rapo nxito ari e këthe Xhakon të mos i thresë bariut; me s'duhet të vijë.

Selfua nxjer shaminë nga silaja pshin sytë dhe del jashtë i hidhëruar.

RAPO.

Ja; shkova Bej.

Tek vete të dalë, Arslani i bën me sy të qëndrojnë dhe t'i qaset Demir Beut.

ARSLLAN.

Të puthë dor' e këmbë Bej. Ep urdhër t'i bëhet gjë të mjerit, se duke qarë i helmuar dollari! çdo të jetë! pse të marë ky një vajzë bariu dhe do të bjerë nga nderi fëmija e tij?

DEMIR BEU.

Duke qarë dollari a? ... (*Rapos*) Pa m'a thirë (*Rapua del*) Yh! i marosuri! (*Selfua me Rapon hujnë*) po qan e? ... të lumtë! Shqiptar! Lap, burrë Kurveleshi do të jesh, pa të qash për një vajzë! ... Pse te mos

bësh ku di ti se çka në botë; s'i ke parë ti plumbat që shkojnë si re mi kryet të njeriut! unë s'bëra mirë; ty duej të të kishe dërguar bashkë me t'im bir në Mal të Zi; pa të shihje një herë se ç'është trimëria! Po ç'të bëj tani; s'e mblodha dot më parë.

SELFO.

Bej! unë frikanac, njeri i poshtërmë, nuk jam! Vërtet, në shumë luftra s'jam ndodhurë; po natyra ma rëfen se trimërinë e kam vetiu! as plumbit s'i trembëm! as nga gjë tjetër s'kam frikë! krahët kurë s'i kthenj! vetëm dashuri e zemrës më poshtë! s'e duronj dot.

Arsllanit i vjen mirë nga fjalët e Selfos dhe e vështron me sy të mirë.

DEMIR BEU.

A! jo! jo! asaj s'i thonë trimëri! për të munduar armiknë, nuk duhet vetëm dëshirë e zemrës; po, duan hedhur prapa krahve të gjitha. Gjumë, prehje, të grënë, të pirë, të gjitha duan lënë. Atë, mëmë, afërsi, miqësi, dashuri, të gjitha duan haruarë; vetëm dëshira e të mundurit do ruajtur. Ja; kësaj i thonë trimëri! një njeri si ti, që s'duron dot dashurinë e një vajze bariu, ku munt ta lërë më një anë gjallërinë e tij!

SELFO.

Bej! unë gjallërinë s'e dua; po, dashurinë e zemrës s'e shuanj dot! sa t'i fal dashurinë gjalljes; i fal gjalljen dashurisë.

Me zemërim nxjer koburen dhe hidhet jashtë.

DEMIR BEU, me rëmbim.

Arsllan!

ARSLLAN, *me zemërim e ze Selfon.*

Djal' i marë!

I mer koburen, Selfua mbetet i turpëruar.

DEMIR BEU.

Or ç'bën kshu ti? u çmënde a?...

ARSLLAN, *me gadalë, Selfos.*

S'ke turp; përpara Beut të bësh kshu? bëre një faj të madh, shko i bjer ndër këmbë Beut të të falnjë faj-në.

SELFO.

Mirë, po...

ARSLLAN.

Mos ki keq ti; se dërgoj ta thëres barinë. Do të bëhet e jotja.

SELFO.

Ah! a të besonj?

ARSLLAN.

Pa dyshim.

Selfua vete i bije ndër këmbë Beut.

DEMIR BEU, *duke qeshur.*

Kaq' e dashke vajzën e bariut ti or a?... Mos ki keq, se unë i flas bariut të ta apë ty të bijën. Ja se ku t'ap fjalë; flij-e mëndjen tan!

(Për një herë ryjnë Xhakua me Zyberë brënda. Zyberi me një dorë përshëndosh Bejnë, dhe në dorët tjetër ka ca shami të kuqe, një palë këpucë dhe ca gjëra të tjera që kish blerë).

Përflim IV.

Të parët, dhe ZYBERI.

DEMIR BEU.

O! mir se erdhe. Qysh je?

ZYBERI.

Mirë jam, ti si je?

DEMIR BEU.

Dhentë qysh i keni sivjet?

ZYBER.

Desh Perëndia mirë janë.

DEMIR BEU.

Unë ty të thira për një punë.

ZYBER.

Gjer më sot s'e di të kem ardhur tjetër herë në këte konak, s'ja u kam pirë kafënë; këto ditë martonj t'ime bijë, pa arçë në pazar të mar njëra jatrën për dasmë *(i rëfen ato që ka në dorë)* tek prinje vjeftën' e ca plaçkave, erdhi një njeri e më tha: „të kërkon Demir Beu”; Demir Beu s'ka no një punë me mua, po me

qenë se është i par' i vendit, duhet vatur thashë, dhe u
ngridë e arçë... Ti je Demir Beu?

DEMIR BEU, *me qesëndi.*

Si urdhëron, unë jam. Ke gjë tjetër për të pyetur?

ZYBER.

S'kam gjë për të pyetur unë; ty të pres çdo të më
thuash?

DEMIR BEU.

Dua të bënj një krushqi me ty.

ZYBERI *i mahnitur.*

Krushqi? ... Ti, me mua? çdo të thotë kjo? Ti je
një Beu i vëndit. Unë një copë bariu i dhënet... dhe

DEMIR BEU, *i pret fjalnë.*

Ç'ka të bënjë? unë e mora vesh; ti qënke njeri i
mirë.

ZYBER.

Mirë, po...

DEMIR BEU, *i pret fjalën dhe i rëfen Selfon.*

E sheh këte? është i biri i Fetah Borshit. E kam
si djalë; këtu është ritar...

ZYBER, *duke veshtuar Selfon me sy të lik, pret
fjalën e Demir Beut.*

He! e kam parë; kurdoherë vjen për gjah nëpër malet t'anë. Dhe të lutem tepër t'i flaç, së një ditëzaj gjesh më shënoj një qen të dhet-vjeçë!

DEMIR BEU.

Mirë, mirë; edhe një herë s'e bën po si të thashë një krushqi dua të bëjmë.

ZYBERI *i pret fjalën.*

Qysh mund të bëhet krushqija Bej? Unë s'kam as vajzë, as djalë për të martuar.

DEMIR BEU.

Mos gënje, më thanë mua; paske një vajzë ti.

ZYBER.

Të thash Bej, s'kam vajzë për të martuarë.

DEMIR BEU.

Qysh s'ke? ç'kërkon të thuash? dije ta panë t'ët bijë.

ZYBER.

Vërtet! gjer më dje e kishe; po sot s'e kam, se dje e vlova; dhe sot a nesër do ta martonj, *(i rëfen ato që ka në dorë)* P'andaj arçë.

DEMIR BEU.

Vajzën nuk do ta apçë atje ku e ke zënë, do ta marë Selfua t'ët bijë.

ZYBER, *shumë i zemëruar.*

Kjo ç' farë fjalë?

DEMIR BEU.

Selfua e desh t'ët bijë, dhe kërkon ta marrë.

ZYBER.

Ime bijë nuk'e do Selfon, do të vluarin e saj.

DEMIR BEU.

Pa u-mejto pakë, Selfua është i bir' i Fetah Borshit.

ZYBER.

Kush të dojë le të jetë, ç'më duhet mua!

DEMIR BEU.

Fëmij' e Fetahut është e ndjerë në Borsh, dhe ky është ritur pranë meje; e kam si djalë; dhe vetë, e fal-të Zoti, është burë... A e sheh! jote bijë s'është në radhët të Selfos, po ç't'i bësh.

ZYBER, *me qesëndi.*

Ashtu është a! ... edhe un' ate them. Nuk' është në radhë të Selfos; s'munt ta marrë; sos!

DEMIR BEU.

Selfua aq' e ka dashur t'ët bijë, sa as nder' e fëmijes së tij mejton, as fjalët e mija m'i dëgjon. Si do që të jetë t'ët bijë kërkon të marrë; p'andaj të thira: me urdhërit të Perëndisë vajzën do t'ja apç Selfosë.

ZYBER.

Unë të thashë Bej; sa herë të të them. Vajzën e vlova. tjetër bijë s'kam për të martuar: kaqë sos.

DEMIR BEU.

E muarmë vesh tëndën; tani dëgjona dhe neve ç'themi! vajzën nuk do ta apç gjetkë; edhe në e ke vluar ndaje: do t'ja apç Selfos. Kaqë të them.

ZYBER, *me zemërim.*

Më ndje Bej! më ke për të thënë gjë? pse më thirë mua s'ish e drejta të më thërinje; dhe unë s'jam aqë fatkeq sa të vinj në këmbët t'ënde...

DEMIR BEU.

Do t'ja apç të them!

ZYBER.

Nuk do t'a jap të them! Të lutem këte fjalë mos ma thuaj tjetër herë; se me thyhet nderi; gjithkush nder' e ka për vethe!

DEMIR BEU.

As më thuaj, të gjithë Progonatasit kshu si ti, kë treshë, njerës që s'njohin radhën e tyre janë? ju s'njihni më të math? pa u-mejto një herë! Cili je ti? një copë bariu i dhënet!...

ZYBER.

Sot për sot s'kemi nonjë ndryshim midis tenë!

DEMIR BEU, *me zemërim.*

S'kam ndryshim? dale pa e sheh ndryshimnë ti!
unë t'et bijë...

ZYBER, *me zëmërim.*

S'ke të drejtë të zënc gojë vajzën t'ime! Pa vështo këtu, Bej! Bej! ju pallate kini, vënt të shumë kini, langonj kini, njerës kini, armë t'ërgjenta, të florinjta kini. Madhëri kini, ç'do gjë kini! ... po neve; një kasole, ca dhën dhe një nder kemi. Juve në mos u vjen keq, eja ni; kasollet t'i gremisni, dhëntë t'i merni! njeri nukë nxjer ze; po mos pandehni se na merni dhe nderë! jo, jo! ne vdesim dhe nderë s'e prishim! ne vetëm për nder, për nder e ruajme shpirtin!

ARSLLAN, *i qaset Zyberit.*

Ore! e kapërxeve ti! ... Ku jemi këtu?

DEMIR BEU.

Ç'vjeftë ka një njeri si ty bre? Tani ap urdhër ty të mbyll në katua; dhe t'et bijë dërgonj e e sjell me pahir, dhe soset imja. Ç'munt të bësh ti?

ZYBER.

Këto një herë i bënje; pa tani s'i bën dot! shkoi ajo kohë që di ti! sot gjithkush është i lirë, s'kemi ndryshim fare në mest t'ënë e di ti a po ja?

DEMIR BEU, *fort i zemëruar.*

Pa shihni një herë! ka ndënjur e më rrëfen lirinë, ndryshim' e njerëzisë! ... e kujt pa mua; s'e di se tani i bënj varë! pa ma zini.

Ca nga njerëzit mundohen ta zënë.

ZYBER, *heq presën dhe mpron vethen.*

Kujt ja mban, lé të qaset! . . .

DEMIR BEU, *ngrihet më këmbë.*

Lir-e-ni, lir-e-ni! Selfo! Xhako! Rapo! Sulçe! Evrenos! ju hiqni në Progonat rrëmbej-e-ni vajzën dhe e shpini në Borsh, në shtëpitë të Selfos.

Rëmbejnë armët, dhe ikin me rëmbim.

ZYBER.

Zotërinj! n'u ka ardhur vdekja, çapni!

DEMIR BEU.

Arsllan, Talha! juve mbyll-e-ni në katua këte!

ZYBER, *me presë në dorë.*

Mos u qasni u them, mos u qasni!

Me presë në dorë, del jashtë derës: dhe ata i bijen pas me nxitim.

DEMIR BEU, *duke ndjekur.*

Zir-e-ni mos e lini! . . .

Del jashtë

PAMJ' E KATËRTË

Ato të pamjes së dytë.

Përflim I.

MEJRUSHE, SAIDE.

MERUSHE, del nga kasollja dhe me vethe.

Oh! sa jam fatbardhë! ... S'di qysh t'ja çpërblenjt'im' eti?... Ç'donjë m'u-be! dëshira m'u-sos... edhe dy ditë mbenë...

SAIDE, del nga kasollja, duke qeshur i qaset Merushes.

A! këtu qënke ti Merushe? unë vinja të të uronje! ta dish sa jam gëzuar!

MERUSHE, e zë për dore Saidenë.

Të paça motër.

SAIDE.

Veç nga një gjë kam keq...

MERUSHE, *duke qeshur.*

He! e kupëtova... po mos ki keq motra ime; se vjen një ditë, pa dhe unë kshu dotë gëzohem për ty!

SAIDE.

Jo, s'është për ate; kush sjell ndër mënt t' atilla?

MERUSHE.

Po përse ke keq?

SAIDE.

Se do të mbetem vetëm, p'andaj.

MERUSHE.

Unë s'vete gjëkund që; prapë këtu jam.

SAIDE.

E di që këtu do të jesh, po më s'je për mua.

MERUSHE.

Pse? ... *(me vethe)* He! më ka zili.

SAIDE.

Se dashuria që gjendet midis dy vajzave, ndryshohet, po të martohen.

MERUSHE.

He! thuaj se paskëtaj s'më ke për të dashur!

SAIDE.

Unë? jo; po ti mos nukë duash të piqesh me mua.

MERUSHE.

Ah! Saide! sot gjithë të mbytura i ke fjalët! ... Ç' kërkon të thuash?

SAIDE.

Kështu është zakon' i nusevet, motër. A u martuan një herë? ... mos prit t'i kujtojnë shoqet e para!

MERUSHE.

Pret nga mua, të tillë gjë? ...

SAIDE.

Ja; do të shohim.

MERUSHE.

Do Perëndia, dhe ti martohesh për së shpejti!

SAIDE.

Jo, jo! se ahernaj ndahemi fare!

MERUSHE.

Pse? ... edhe ty yt' atë të marton këtu... sikur dhe ti...

SAIDE, *i pret fjalën.*

Ah! motra ime! Ti; t'i lutesh një mijë herë Perëndi-së që ke një atë si ëngjell; pa vështu, me të marë vesh

dashurinë t'ënde me Rexhepnë, s'u-la në brengë; për një herë do t'u-martonjë. o im' atë, mos e dhëntë Perëndia, sikur të më kupëtojë që dua no një...

Vahideja del nga shtëpia. Merushja me Saiden zihen dorë për dorë dhe hiqen më një anë e kuvendojnë.

Përflim II.

Të parat, dhe VAHIDEJA.

VAHIDE, *nuk i sheh vashat; po me vethe.*

Çdo gjë në këtë jetë me të mësuar qënka... kur më tha im shoq, se: „Merushen t'ja apim Rexhepit” për një herë m'u-erë sytë, dhe m' erdhi një e dridhur në trup!... Kjo lesë m'u-duk fort e ftohtë. S'ma desh shpirti fare!... po sot nga e djeshmja, kam shumë ndryshim; u-mësova dhe unë; djemet u hipi dashuria; t'i ndash, i mer më qafë... vetëm që, nga no një prapësi kam frikë! do Perëndia e s'ka no një prapësi në këte punë!...

SAIDE, *i qaset Vahidesë.*

Zonja Vahide; ç'mejtohesh kshu?

VAHIDE.

A! këtu qënke ti?

SAIDE.

Si urdhëron; kuvendojmë me Merushen. *(ngadalë)*
Zonja Vahide, të shoh fort të mejtuar! ti që marton t'et bijë, duhet të gëzohesh.

VAHIDE.

Unë e gëzuar jam bijë! ... do Perëndia për së shpejti kshu gëzohet dhe jot' ëmë.

SAIDE, *kuqet dhe e turpëruar.*

A! ... Zonja Vahide? ... ju gjithë... *(vete drej Merushesë, pastaj kthehet përnjëherë dhe ndron zënë)*
Hë? zonja Vahide, vërtet s'është kshu? Vajzat po të martohen s'e bëjnë vethen të kuvëndojnë me shoqet e para?

VAHIDE.

Jo se s'e bëjnë vethen bijë; po, një grua e martuar, qysh munt të bënë kuvënt me një vajzë? ... dëshir' e vashavet është tjetër... e nusevet tjetër! Merushja, gjer më dje, gjithë qëllimet e saj ty t'i thosh! dhe ti tëndet asaj j'a nëmëronje; po pas këtaj Merushja do ketë të tjera dëshira, dhe tëndet s'munt t'i dëgjonjë. Ti, prapë gjen një shoqen tënde, dhe kuvëndoni.

SAIDE.

Ah! zonja Vahide! Ti gjithë po më nget mua! ... fajn' e kam unë që të pyes; pa...

I qaset Merushes dhe zënë kuvëndin.

VAHIDE, *vështon përpjetë, dhe me vethe.*

A! shkoj koha! buri, buri, edhe s'u-duk... Mirë që ja kishe bërë gati që me parë pajën e s'ime bijë! Tani vetëm të dasmës na duhen. Një bijë të vetëm kemi! dasma do t'i bëhet e madhe! gjithë afëria, miqtë, të vinë! të hanë, të pinë! të dëfrenjë! *(si mejtohet pakë)* Ç'ri unë? edhe, më nuk zura gjë me dorë. Kur do t'i shoh gjithë këto punë! *(duke vajtur në shtëpi)* Saide bijë!

SAIDE.

Ç'është vallë, prapë?

VAHIDE.

Eja më ndih pakë bijë; se kam shumë punëra!

SAIDE.

Si të mos ndih më dasmët të Merushes; pa për ç'kohë jam?

VAHIDE, *përpara derës së shtëpisë; Merushes.*

Eja dhe ti bijë! na mbush pak ujë, se s'kemi as pikë.

Merushja ri e papërgjigjur.

SAIDE.

Qysh! bën të shërbënjë vajza në dasmët të saja? ...

VAHIDE.

Jo, bijë; ujët vetëm për dasmë duhet a? ...

SAIDE.

He! Vërtet; ujët s'është vetëm për dasmë... Eja Merushe! eja! ...

Të trija ryjnë brënda në kasollet. Merushja del për një here, vete për ujë me dy enë nër duar.

Përflim III.

MERUSHE, (pasdaj) SELFO, me shokët (pasdaj)
SAIDE, ZYBER.

MERUSHE, me vethe në krua.

Im' atë me s'u-duk; dhe Rexhepi vajti vetëm sot në mal; i mjeri djalë! Kush e di sa i është brengosur shpirti! ... kur do të ngriset të vijë!

Ka ndenjtur me një gur pranë kroit dhe mejtohet. Seljua me shokët e ti, dalin për një herë t'armatosur.

SELFO, shokëvet.

Ja; ajo e tëra, dhe fillja vetëm! ... Ah! sa u-bë mirë! Juve qëndroni!

Seljua vete drej Merushes, dhe të tjerët me armë nër duar, rinë pas.

MERUSHE, ngre kryet dhe me të parë Seljon.

Ah! prap' ay! ... Ah! Perëndi! (me një rëmbim të math ngrihet më këmbë). Ah! më kish thënë që do t'i mar shpirtin Rexhepit! ... Ah! n'e ka gjetur në mal e ka vrarë! Ah! (Duke nxitur drej Seljos). Të lutem! folë, folë! thuamë: e vrave Rexhepnë? u godit Rexhepi?

SELFO, duke zënë prej krahu Merushen.

Shiko këtu; ty të them! dhe një herë emrin e Rexhepit të mos e març në gojë! harroje atë! me mua do të vish!

MERUSHE, me zë të dridhur.

Ah!(thërret) Saide! Saide!

SELFO, *i zë gojën.*

Mos thirr!

Qasen shokët e Selfos.

SAIDE, *duke dalë nga dera.*

E... ç'jini ju? ç'bëni kshu?... lireni! lireni! vajzën!...

Ngre gurë dhe u bije. Për një herë duket Zyberi krye jashtë, me kobure në dore. Me të parë këte ngjarje shpejt zhvesh sharkën e hedh përdhe, nxiton dreq Selfos, për të shpëtuar të bijën. Selfua heq koburen mi Zyberë; Zyberi goditet mi krahuar dhe bije mbërdhe. Merushes i bije zali në krahuarit të Selfos. Sai-deja thërret sa munt. Selfua e heth më krahë Merushen dhe shkojnë bashkë me shokët. Zyberi ngre kokën dhe xbras koburen; po i vete kot plumbi! Vahideja; del më derë bën një ulërimë dhe nxiton dreq Zyberit.

Përflim IV.

VAHIDE, SAIDE, ZYBER, *shtritur përdhe.*

SAIDE.

Vahide! ... ku je?

VAHIDE.

Ah! o Perëndi! ç'është kjo e keqe që na gjet!

SAIDE.

E rrëmbyen Merushen! shkuan! ... pesë shpirt!

VAHIDE, më s'i vë re fjalët e Saidesë, po i qaset Zyberit.

Burri im! Zyber! ç'të gjeti? kush të ra? ku je goditur?

ZYBER, *ngre kokën dhe e ze prej dore Vahidenë*
Më një zë të pakë.

Vahide! Vahide! ... unë u godiç! po vdes!

VAHIDE.

Ah! t'ardhtë keq o Perëndi!

ZYBER.

T'ime bijë më shpëto, t'ime bijë!

VAHIDE, *me një rrëmbim të math si e çmendur*
vështon rreth e rrotull.

Vajza, Vajza, ku është' ime bijë?

E mahnitur e vështon në sy Saidenë.

SAIDE.

E rrëmbyen dhe shkuan! pesë shpirt! i kish rënë
zali në krahor të njërit!

VAHIDE, *e helmuar kyç duart.*

Ah! ime bijë! ... burri im! Qyqja unë!

ZYBER.

Vahide; dëgjo! Ay qëni Seifua që na kish kërkuar vajzën, erdhi e rrëmbeu Merushen, dhe mua më vrau!

VAHIDE.

Të lutem rrëfemë ku je goditur?

ZYBER.

Në krahror... mun në te! Ti mos më vështo mua, ...s'kam shpëtim unë... T'ime bijë shpëto... T'ime bijë... se në mbetë vajza në duar t'atyre! në ate jetë nga ti e kërkonj; do të të varem me të dy duart! ... Lere më nj'anë kufomën t'ime! Sa të munç vajzën të shpëtoç, Rexhepit t'ja apç, mos bëj ndryshe! ... Vajzën më shpëto, vajzën! ... Vahide!... Perëndi! ...

Heq nja dy herë dhe var kokën pa shpirt.

VAHIDE.

Ah! shkoi! ... i mbylli sytë! ... Ah! Buri im! ... Kërcurja unë!

Zë sytë me dorë dhe qan një cop herë, pastaj ngre kryet dhe ze e vajton:

Vajtim;

*Shpirti im o bur'i vlerë!
Trim për mi trimat'e ndjerë!
Pa shpirt përdhe më je nderë!
M'u nxi jeta m'u-bë sterë!
Ty të shtun'e të godinë!
Edhe vajzën më s'e prinë!
E rrëmbyen edhe shkuan!
Nga syt'e mi ma larguan!*

*Mos më pandeh se do të qanj!
Gjaknë për sipër s'e mbanj!
Ja pa qarë do të qesh!
Ja po si ti do të vdes!
Ja vajzën do ta shpëtonj!
Ja po si ti do të shkonj! ...
Ah! o buri im!*

Qan.

SAIDEJA, vajton kështu:

Vajtim.

*Im' atë për jetë po fle!
Dy të varfër mi dhe po le!
Ti nesër do t'i martonje!
Gjithë miqtë t'i gëzonje!
Na le prapa e po shkon!
Jetenë po e harron!
Ah! o Atë!*

VAHIDE, fshin sytë dhe me kuxim të math.

Saide! pa lërë, lërë vajinë! se s'është ajo kohë! vajzën na e rrëmbyen, të nxitojmë t'ja u marim nga duart! m'u-lye vatra me gjak! dhe unë pa shkuar kohë, me gjak do t'ja u-çpërblenj! ... do ta kërkonj gjakn' e t'im shoqi! do t'ja sjell në vënt fjalën' e fundjes së shpirtit! *(duke zënë nga krahët kujomën e Zyberit)*
Saide! zëre ta ngrëmë!

SAIDE, qaset ta zërë.

Ah! Vahide! më dridhen duart! nuk' e zë dot! ...

VAHIDE.

Zëre të them! s'je vajzë shqipëtari?

Saideja e zë nga këmbët dhe e ngrënë të dyja, e shpien brënda në kasollet, Saideja atë çast del jashtë derës.

Përflim V.

SAIDE, *vetëm.*

Ah! i ziu Zyber! të mjerën Merushe! e muar e shkuan! s'ma mer mëndja të shpëtonjë nga duart' e atyre! pesë shpirt si arinj! vallë kusarë t'ishin, a ç'të qenë? Ah! e mjera Merushe! e zeza si e vdekur ish nderrë në krahor të njërit! ... vallë vdiq! apo... ah! ç'qe kjo e keqe! ...

Vahideja ngjeshur një silahe, dy kobure dhe jataganë në bres! Ripn' e pushkës shkuar mi krah. Pallaskat me fishekë ngjeshur mrapa! me një fytyrë trimërije del nga dera e kasollës.

Përflim VI.

VAHIDE, SAIDE.

VAHIDE.

Burën ma vranë! vajzën ma rëmbyen! këtu janë dy punëra për të parë; gjaku i t'im shoqi! shpëtim i vajzës, nga dor' e armikut! këto punë kush do t'i shohë? unë njëri s'kam, dhe Rexhepi, i vogël është... Jo, jo; ky shërbim është imi! këto do t'i bënj me duart e mi-ja! ... Mirë them; kufomën e burit e mbyll brënda dhe unë shkonj. (*Kyç derën e shtëpisë*). Në munça ta mar gjakn' e t'im shoqi, vinj bashkë me vajzën e me Re-

xhepnë, dhe e mbulojmë me këng' e me valle! dhe zinë e burit, dhe dasmën e vajzës, për një herë i bën! ... Jo; po në mos qofsha e zonja; me mirë vdes dhe unë shpëtonj! Përpara se të jem kshu faq' e zezë, vdekja është një mij' herë më e mirë! një grua që s'mer dot gjakn' e burit, një grua; që le dritën e syrit në duart t'armikut; a munt të ronjë në këte jetë? Jo, jo; një mij-herë jo! një grua shqipëtari s'ron dot kshu! punën t'ime do ta shoh vetë!

Niset t'ikën!

SAIDE, *i bije prapa.*

Vahide! ç'bën kshu? ku vete?

VAHIDE.

Ç'bënj? punën t'ime! ku vete? të mar gjakn' e burit; të shpëtonj t'ime bijë!

SAIDE.

Ti; një grua! ... Jau del dot pesë burave? si arinj!

VAHIDE.

Gjallëri e këtillë s'më ryn në sy! Le të më vrasin dhe mua të shpëtonj!

SAIDE.

Ç'bën kshu Vahide! është mëkat i madh, pse të vdeç kot!

VAHIDE.

Kot!

SAIDE.

Ashtu po; munt të derdhç gjak nga ata ti? Munt ta shpëtosh Merushen nga duart e atvres ti?

VAHIDE.

Vërtet; ata pesë, unë një! ata bura unë grua! po! ata janë mundonjës, un' e munduar! ata pa të drejtë, unë me të drejtë! Perëndija; kur-do-herë të munduarvet u ndih... Saide! Ti jepi zë Rexhepit! Ja vetë çap, ja njeri i dërgo; rëfeja ç'na gjeti!

SAIDE.

Unë tani shkonj vetë.

Nziton.

VAHIDE, *veshton drejt kasolles dhe me vethe.*

Ah! ... o buri im! Dije më dolle si dragua nga shtëpia! sot je nderë pa shpirt mbërdhe! gëzohu! o shpirt i burit tim, gëzohu! se gjaknë do ta mar me duart e mi-ja. (*duke lutur*). Perëndi! Ky shërbim është i bekuar! punën e kam fort të rëndë! ndihmë o Zot i vërtetë!

Shkon.

PAMJ' E PESTË

Një pyll. Për së largu duken majat e malevet. Me të djathtë një udhë, në anë të mëngjër të sheshit të përflimit duket një shkëmb' i vogël; Vahideja e armatosur del nga ana e mëngjër.

Përflim I.

VAHIDE, *vetëm me vethe.*

Si ariva dot! shkuan në Borsh, në shtëpi të Fetahut. Atje do vatur. Mirë them; të shpëtonj një herë vajzën pastaj t'i-derdhem ati që më vrau burën. (*Niset t' ikinj' pastaj për një herë qëndron duke vështuar përpyetë*). Shpejt është; të vete që tani nuk bën dot gjë; ri këtu një copë herë sa të zërë të ngrysurit pa të vete; ashtu më mirë. (*Pushkën e pështet, dhe vete ri ngjat shkëpit*). Më së fundi; ç'trëmbeshe, më erdhi në krye. Un' e dinja pa thashë; si kjo punë s'është' e mbarë, po ç'ti bënja? S'e binda dot të ndjerin! edhe tani vajzën s'ja epnja Rexhepit, po i ndritë shpirti dhe në kohët të vdekjes; fjal' e fundit kjo i qe: „vajzën t'ja apç Rexhepit, të mos bësh ndryshe!” Jo, jo! fjal' e një buri që vdes me nder, është fort e nderçöme; duhet sjellë në vënt! N'e-shpëtofsha t'ime bijë, Rexhepit do t'ja ap... Ah! këte dasmë do ta bënim bashkë me Zy-

berë! Ah! i ziu burë sa me gëzim e kish marë këte dasmë! me sa dashuri e prittë! ... Ah! Perëndi! Perëndi! vure këmbë për të mos qeshur kurë buza jonë! që po sa zë njeriu sikur të gëzohet pakë, për një herë i ep një rebesh mi krye sa s'di dhe ay se ku vete! ... Gjithë shpresën te kjo vajzë, dhe te Rexhepi e kishim! Sa erdhi koha t'u shihnim fatbardhësin' e tyre; sikur s'qenë mjaft, përmi të gjitha na gjeti dhe kjo! Humba burën që shkova një jetë me te! Ah! jetë-shkurtëri Zyber! (*Qan*). Le gjithë e gjithë; po në mos e shpëtofsa dhe vajzën! Ah! sot ime bijë gjëndet në një rezik të madh! ... Në mos e shpëtofsa ate dhe unë do të vdes, dhe Rexhepi pas vdekjes sanë s'ron dot! Ah! i mallëkuari! na e mbylli derën! na prishi për jetë! edhe n'e shpëtofsa vajzën, ata prapë nuk do të na lënë ne preheje! e ku munt t'u qëndrojmë kundër atyre ne? po; sa të flerë në gjitë të armikut, vdekja është njëmijë herë më e mirë për t'ime bijë! unë ta shpëtonj një herë vajzën nga duartë e atyre; t'i mar dhe gjaknë e burit, pa vdekja është urdhër i Perëndisë! kush do të mbetet pa vdekur në këtë jetë! ... Vetëm sos, që me nder të vdesim! ... (*vështon kohën*) Ah! ka dhe shumë të ngryset... I ndjyeri Zyber! dje më këte kohë kishim ndënuar e kuvendonim punën e dasmës! po sot, ku je! ...

(Si qanë një copë herë, fshin sytë dhe i qep mbër-dhe e mejtuar. Fetahu me pushkë më krahe unjet nga mali).

Përflim II.

FETAH, VAHIDE, prapa shkëmbit.

FETAH, si unjet së sipërmi nga mali, pushkën e lëshon përdhe; dhe vetë rri e çlodhet.

[Ah! lavdi paç, o Perëndi! sot i arrita mëmëdheut! njëzet vjet mërguar nga shtëpia, e nga gjithë njerëzia!

Mëmëdhe, i ndërçimi mëmëdhe! pas një—zet vjet të pashë edhe një herë! Sa më kish marë malli! një—zet vjet! sa kohë e gjatë; një jetë njeriu! Shumë herë mëmëdhe-në e shihnje në ëndër! më dukej sikur qeshë këtu; pa kur xgjoheshe më mbulonte hidhërimi! Fundja; prapë mëmëdheu më mblodhi! (*si mejtohet pakë*). Mos jetë ëndër? ... Jo, jo; kjo është e vërtetë... tani në mëmëdhe jam! pas këtaj s'i jam për të ndarë mëmëdheut! Edhe kockat në mëmëdhe të më mbeten! ... Qysh kshu njeriu ndahet nga afëria, nga njerëzia, nga vëndi që është lindur dhe mërgohet lark; po zemëra s'ndahet kurë! zemëra është lidhur te mëmëdheu! Vërtet, dhe këto një-zet vjet fare jashtë mëmëdheut nuk i shkova, se ku — do që u ndothç' mëmëdhe e quanje! Dhe Tarabullusnë dhe Tunën, mëmëdhe e quajta! Të mos ish ashtu, nuk derthnim gjak për ta! më gjith këte njeriu, për vëndin q'është lindur, për ato viset e bekuara që ka shkuar kohën e djalërisë, mban tjetër dashuri në zëmër! Njeriu dhe për gur' e për drurët' e mëmëdheut drithtëron... në mëmëdhe ka tjetër bukuri. Er' e mëmëdheut është tjetër lloje! Njeriut edhe një drudhez' e mëmëdheut ja sjell nër mënt ato loderat e miturisë! i—kujton dëfrimet e para! kujtim' i atyre ditëvet të shkuara, t'asaj kohës' së rrallë, ai gëzon shpirtin e njeriut! (*duke vështruar reth' e roturllë*) Sa vënd' i bukur! Ç'shij' e mirë! qe një-zet vjet e tëhu s'është ndruar fare; ata drurë, ato pemë, ato fletë! Ah! një-zet vjet! ... në një—zet vjet e sipër vajçë në Tarabullus; atje ca kohë më nj' anë forcën' e vapës, m' anë tjetër hoq-më mundimn' e luftës! po me qënë q' ate vënt e shtruam, s'na duken mundimet fare! S'andejmi erth-më në Mal-të-Zi; atje me të nisur lufta na dhanë ca plaga; sa zumë t'i mundnim, ngjau pun' e Tunës; dhe përnjëherë ju sulmë asaj; desh Zoti dhe atje dualmë faqe bardhë. Prap' u-kthyem në Mal-të-Zi. Desha të ri-nje sa të merte funt puna; po, më një anë malli i mëmëdheut, më nj' anë tjetër shtrëngim' i Beut më solli prapë këtu. Fundja; e pashë dhe një herë mëmëdhenë! (*si veshton një copë herë i mahnitur*) Ah! ky vënt! ...

një-zet vjet më parë, atë ditë që nisëshe për në Tarabullus, në këte vënt, kishin dalë e tër' afërija; gjithë miqtë për të përcjellë; këtu dëfryem, poç-më dhe ca mishra! (*i gëzuar*) këtu në këte vënt! Ah! më duket sikur kam qënë sot! një-zet vjet kanë shkuar, një-zet vjet! ... Ah! ky vënt, ai vënt është; po koha s'është ajo; është ndryshuar shumë; ahernaj qeshë fare i ri! njëzët e pesë bura u nismë nga pshati; po, s'më ngjan të jenë kthyer më shumë se pesë shpirt! Cili mbet në Tarabullus, cili në Mal-të-Zi, cili në Tunë! ... Ahernaj këtu kishe fjetur një copë herë; dhe djalën ma kish zënë gjumi në prehër! ... Ah! i dashuri djalë... kur shkova pesë vjeç e lashë! ... Ah! edhe për pakë e do t'i puth sytë djalit! ... Ah! trëmbem mos më gjenjë gjë nga gëzimi! ... po e gjora mëmë! kush e di sa e ka marë malli! ... gjallë e kam më thanë, po, ... s'e di; kur shkova dhe t'ime shoqe gjallë e lashë; po pas tri vjet më thanë se vdiq e zeza grua! (*fshin sytë*) sa jam fatziu! ... sa i mjerë; pa mëmë e pa atë u rrit! (*për një herë gëzohet*) Oh! tani është bërë një-zet e katër vjeç; ahernaj qe i vogël; këtu e kish zënë gjumi në prehrit t'im! ... Ah! sikur të fle një copë-herë të kujtonj ate kohë; pa, pasdaj ngrihem e vete në pshat, t'i mar dorën' e s'i mëje, t'i puth syt' e djalit! mirë them: të mar një gjumë, një copë-herë...

Pushkën e pshet me një dru, jataganë dhe koburet i vë nën kokë dhe xgjatet ngjat drurit.

VAHIDE, nuk e she Fetahnë me vethe.

Ah! kjo ditë sa e gjatë! s'ka të ngrysur; s'më durohet! Sa të eret, pa të vete të shpetonj t'ime bijë... e gjora vashë! kush e di se më ç'të keqe gjëndet! Po i ziu Rexhep! kur të dëgjonjë, çdo të bënëj vallë! Munt që ngrihet dhe ay e vjen; djalë është, kush e di, këcen përnjëherë në zjar dhe shkon pa të thënë! Ah! nga ti presim ndihmë, o Perëndi! ...

Qan dhe heth vethen në mejtim, Selmani me pushkë në krahë unjet nga mali

Përflim III.

SELMAN, FETAH, ndë gjumë. VAHIDE, prapa shkëmbit.

SELMAN, dal-nga-dale, vete drej mi kokët të Fetahut, dhe me vethe.

Ay! ... i teri vetë! ... Filli vetëm dhe në gjumë! sa mirë; e kërkonja ndë qiell, e gjeta mbërdhe! (nxjer koburen) Tani sa është në gjumë, t'ja sos punën! (si mejtohet pakë, me rëmbim të math e ngul koburen në silahe) Jo, jo; s'është kshu burëria! duhet xgjuar! ... po si ta xgjonj, sa ta vras unë më vret ai mua! ... qysh të bënj? s'do humur kjo kohë! (si mejtohet pakë) he! i lak armët.

Nxjer kupën' e ujit nga trajsta dhe mer ujë nga burimi që ka pranë. Me parë i lak pushkën, pasdaj koburet e Fetahut. I mer dhe jataganë ja psheh prapa një druri. Psheh dhe koburën e tij; pasdaj nxjer jataganë, dhe i pshet majën në krahë të Fetahut. Fetahu për një here xgjohet dhe ngrihet për gjysmë; shtije dorën në koburet dhe e vështon i mahnitur në sy Selmanë.

Përflim IV.

SELMAN, FETAH, VAHIDE, prapa shkëmbit.

SELMAN.

Pa më vështo mirë në, sy, a më njeh mua?

FETAH, *për gjumësh.*

Ty?

SELMAN.

Si urdhëron; me, harove a?

FETAH, *e njeh.*

He! Ti je o Selman?

SELMAN.

Si urdhëron; unë miku yt!

FETAH.

Po; vëndës jemi.

SELMAN.

Vetëm vëndës dhe miq jemi a?...

FETAH.

Ajo është puna jote, po për mua, bëmë ç'bëmë jashtë, duhet t'i harrojmë; tani erthmë në mëmëdhe, për mall të mëmëdheut duhet të pajtohemi.

SELMAN.

Ha! ha! ha! ç'gjëra të mëson frika ty!

FETAH, *rrëmbyen pushkën dhe ngrihet më këmbë.*

Mua më thua frikanac? nga ty të trembem unë? ... unë s'e bënje vethen as të ziheshe me ty; po ç'të bënje, më re shumë më qafë...

SELMAN.

Shumë fjalë s'dëgjonj unë! trimëria këtu duket! ...
Ja se ku është sheshi! rrëmbe armët të shohim?

FETAH.

Unë s'dua të bëjmë një ligësi pa shkelur mirë në
mëmëdhe, po, sikur lidhur t'i kem duart, nga ty s'trem-
bem kurrë!

SELMAN.

Sot një nga mëmat, do ta shohë kufomën e të birt,
po të shohim kujt ju sosnë!

FETAH, *ngreh pushkën.*

Urdhëro?

SELMAN.

Pa vështoj; ti veç pushkën, ke dhe dy kobure, unë
vetëm me jatagan do të mbrohëm!

FETAH.

Kur qënka kshu, s'i përdor këto; dhe unë kam ja-
tagan. (*zë e kërkon*) A! ku e kam jataganë? ... këtu
që! ti e ke marrë!

SELMAN.

Ha! ha! ha! më s'është dëgjuar i tillë trim, t'ia
vjedhin armët nga brezi! ...

FETAH, *me zemërim.*

Njeri i lik! ... Ti e ke marrë!

VAHIDE, *prapa shkëmbit dëgjon zënë e Fetahut dhe përgjon pshehtazi.*

Ah! ç'janë këta?

Rri e qetë dhe vë vesh e dëgjon.

SELMAN.

Unë s'e bënj atë; po kur t'i paskan vjedhur armët; ja unë po të le mbrohu me armët e tjera.

FETAH.

Tani domosdo, ashtu do të bënj; he të shohim!

SELMAN.

Pa i vështu armët një herë.

FETAH.

Hë dhe këtyre u ke bërë gjë a? *(vështon pushkën)*
A! këtë e paske lagur! pa dale! *(vështon koburet)* Ah!
dhe këto ashtu! *(me zëmërim të madh)* Njeri i lik!
Qen i pabesë!

SELMAN.

Në do të shpëtosh nga duart e mija! kërkomë ndjesë, bjermë nër këmbë, pa të të fal; në mos, pa dy, tani ta mora shpirtin!

FETAH.

Në këmbët e tua të bije? Nga ty të kërkonj ndjesë!... mos e dhëntë Perëndia!... Jatagani yt, s'më ç'pon dot mua; edhe në më çpoftë ç'e dua gjalljen përpara nderit!... Unë s'jam aq i lig, sa t'i lak armët e armikut

në gjumë për të shpëtuar jetën t'ime! ... Ti për të rënë nër këmbë, m'i bëre gjithë këto a? ... Jo, Zot! s'e ke mirë; unë s'jam nga ata që puthin këmbën tënde; po hiqe të shohim, hiqe! unë me krahë do të mbrohem! Hë të shohim.

Vahideja, nga një e çar' e shkëmbit kthen pushkën drej Selmanit. Selmani heq jataganë mi Fetahnë. Fetahu tek dredhet t'ja zërë me dorë, Vahideja e x'bras pushkën; Selmani për një herë bije mbërdhe pa shpirt. Fetahu i mahnitur vështon rreth e rrotull; tek i qaset shkëmbit kur sheh Vahidenë. Vahideja e ka lënë pushkën si ç'e kish kthyer dhe ka rënë në mejtim të thellë.

Përflim V.

FETAH, VAHIDE.

FETAH, me të parë Vahidenë, me rëmbim të math.

Ah! ti cila je? Engjëll! a, e-bukur' e dheut je? nga dolle? Pej qielli xbritel!

VAHIDE, ngre kryet dhe vështon në sy Fetahnë.

Unë? mua më thua?

FETAH.

Si udhëron; ty! ty që ma shpëtove jetën t'ime! I pa-besi! si më gjeti në gjumë, armët m'i lagu, jataganë ma pshehu! Pastaj më thosh t'i binje ndër këmbë! T'i kërkonje ndjesë! sa t'i falëshe një të ligu, ju derthçë vdekjes me nder mi krye... sot, sot që do t'i puthnje dorën e memëzës dëshëruar, sytë e djalit dashur që kam një-zet vjet që u heq mallë; sot që mezi pashë më-mëdhenë! trathëtori! njeriu i poshtërmë! kërkonte të

më vritte pa të thënë! Ti je ëngjëll! ke xërritur peç qie-
lli për të shpëtuar jetën t'ime!

VAHIDE.

Jo! Unë jam një grua e varfër!

FETAH, *i xgjat dorën.*

Kur është kshu, nëm dorën; në këte jetë dhe në
tjetrët, ti je motra ime. (*Vahideja ngrihet më këmbë
dhe ja ep dorën.*) Ah! kjo dorë! ... djalit i fali një atë
dhe mëmës i dhuroj një djalë! ... Qysh ta çpërblen
unë këte të mirën tende?

VAHIDE, *me zëmërim e heq dorën.*

Jo! ... unë as për dhuratë e bëra, as për çpërblim;
as ty të njoh, as ate; ty as të ndiha as të shpëtova; ty
të shpëtoj burëria jote, dhe ate vrau pabesi e tij. Unë
pashë trimërinë t'ënde dhe pabesinë e atij, pa kuxova
e bëra; mos e diç se desha të të shpëtonja ty. Pandaj,
as çpërblim pres, as dhuratë kërkonj!

FETAH, *me vethe.*

Në një grua, kaqë trimëri! kaqë shpirtmadhësi! ...
(*me zë*) Ah! kjo madhësija e jote më vrau fare mua!
Unë dua të të gëzonj, të të bënj një të mirë ty! ... Në
mos ke burë, në mos ke djalë bëhu-mu motra ime.

VAHIDE, *hidhërohet.*

Ah! im shoq! ... im bir! ...

FETAH.

Nukë ke! e?

VAHIDE, duke qarë.

Ah! ta dish ti! burën sot ma vranë! ... dhe vajzen ma rëmbyen; u-bë rob në dorë t'armikut! ...

FETAH.

Kur është kshu, dhe unë ty, në mos qoftë sa yti, le të jetë ca m'i vogël, po do të të gëzonj.

VAHIDE.

Çë?

FETAH.

~~Do të të mar gjaknë e burit, do të të shpëtonj t'ët bijë!~~

VAHIDE.

Ah! Jo, jo! kjo është një bar' e madhe s'ja le njeriu; kjo pun' është imja, do ta shoh vetë!

FETAH.

Ti? një grua! ... Jo, ty s'të them dot grua! ... përpara teje një mijë bura, s'janë gje fare! ... Po, vetëm këte shërbim do të ma falç mua! pa marë dorën' e s'imjëje, pa puthur sytë e djalit, pa parë mirë mëmë-dhenë, do të shoh këte punën t'ënde! si t'i mar gjakn' e tit shoqi, të shpëtonj dhe t'ët bijë e të ta... Jo ty, t'im biri do t'ja ap! s'është mirë? Jot bijë të më bëhet nuse e djalit, ti të jesh motra ime, kshu të rojme gjithë tok, nuk bën?

VAHIDE.

Ah! jo! ... Vajzën e kam të vluar në i dashur' i saj,

dhe fjalën e burit kshu e kam; se dhe vrasja e ati për këtë gjë u bë! gjaksori i burit më parë na i kërkoi vajzën; si pa që neve s'ja dhamë, pa erdhi, burën ma vrau, dhe vajzën ma rëmbeu!

FETAH.

Njeri i-lik!

VAHIDE.

Dhe kur dha shpirtin buri, fjala e fundit kjo i qe: „Pa shpëtuar t'ime bijë, pa bërë dasmën, pa marë gjakn' e tij të mos e vë në dhe!” Ah! në munça t'i bënj këto, nuk e qanj fare burën; me këng' e me valle, do ta mbulonj!... Mirë them, për një të vrarë q'i çpërblehet gjaku nuk derdhet lott!

FETAH.

Ah! ti mos ki keq!... se gjakn' e burit do të ta mar! vajzën do ta shpëtoj! kur qënka e zënë, e të jet' motër e djalit, dhe ti je motra ime; të gjithë një fëmijë të quhemi; më një shtëpi të rimë! Ti nga ç'pshat je?

VAHIDE.

Unë jam një grua bariu nga Progonati.

FETAH.

Ca me mir a? herë rimë në shtëpit t'ënë, herë vemi në Progonat!... Oh, sa do të jemi fatbardhë!... sa jetë të mirë do të shkojmë!... unë kam një mëmë tet-dhet-vjeçe; ajo do të jetë mëmë e të gjithëve, ti motra ime, vajza motra e djalit; dhe i dashuri i vajzës dhëndri ynë!... Po, të lutëm tepër falmë ta shoh unë këte punën e-nderçme.

VAHIDE, duke xgjatur dorën.

Ah! vëllai im! ... në këte jetë dhe në tjetërt të pa-
ga për vëlla, s'di qysh t'ja bënj kësaj shpirtmadhësisë
sate? ...

FETAH, duke zënë dorën e Vahidesë.

M'u njohç motër në këte jetë dhe n' atë! (Nxjer
enamne*) nga këllëfi që ka varur më qafë, e zë me do-
rë të mëngjër, dhe dorën e djathtë e vë mi të.) Bën-
je për mi këtë librë të shënjtëruar, dhe të ap Besë se
sicili do që të jetë gjaksor i burit, do ta gjenj dhe do
ta vras! edhe t'et bijë do ta shpëtonj nga duart e tij
e do të ta sjell ty! gjithë ç'është do ta kemi të bashktë;
një fëmijë do të quhemi! ... Prapë për mi këtë librë
bënj be! dhe ap Besë se këtë shërbimin' e shënjtëruar
unë do ta sôs! (Më në funt duke vënë dhe një herë
dorën mi librët). Unë do ta mar gjakn' e t'it shoqi!
Unë do ta shpëtonj t'et bijë! tani thuamë burën kush
ta vrau? vajzën kush ta rëmbëu? ... nga ç'vënt është?

VAHIDE.

Nga Borshi është.

FETAH, me vethe.

Nga Borshi! ... Ah! pshatar! ... (me zë) Emri?

VAHIDE.

Selfo e çuakshin. (Fetahu me rëmbim hap sytë) i
bir' i Fetahut.

FETAH, pa dashur.

Ah!

*) Libr' i shënjtëruar.

VAHIDE.

A! ç'pate? ... Të njohur e ke?

FETAH, duke mbajtur vethene

Jo!

VAHIDE.

Jo! se ç'pate ti! si më duket e njeh!

FETAH.

Me t'anë njiheshim, në është ay! ... (*Hiqet me një anë i rëmbyer me vethe*). Ah! im bir! ... djali im e! ... (*Vahideja ze e mbush pushkën*) Ah! një djalë që ritet i mjerë pa mëmë e pa atë ç'bënet? ... po... (*idhërohet*) Falm, o! Perëndi! ah! qysh të bënj! bëra be! dhashë besë që do ta vras! (*me zë të dridhur*) djalën! ... unë! Unë ta vras t'im bir? ... djalën që kam një-zet vjet pa parë! ... djalën që kam një-zet vjet që po i heq mallë! ... Ah! kur ta puth nga të dy sytë, kur do të më gëzohet shpirti; ti bije ta vras! cili atë ka shtën mi djalën' e tij? ... cilit atë i kuxon dora të vrasë të birë? ... në tërë botën unë mund të jem i pari që do ta bënj një gje të këfillë kaqë të tmeruar! ... A! Jo, jo! unë s'mund të mar mallkimin' e tërë njerëzisë mi vete, sa të qëndronjë jeta! ... unë s'kuxonj dot ta shoh me sy këte tmer! ... në bëfsha vetëm një gjë munt të bënj; ja djalën shtërngonj ta lerë vajzën, ja se këte gruan mundohem e bind t'ja lërë djalit të bijën; tja-tër s'ka se ç'bënj! ... (*si ecën dhe mendohet pakë*) po unë bëra be për mbi këte libër të shenjtëruar, se gjak-sorin e burit do t'ja vras! dhashë Besën? ... Jo, jo! ky është një tmer m'i math! s'e bënj dot s'më vjen doresh! përpara shpirt-madhsisë kësaj gruaje të bënj një gje të tillë! ... Jo, jo! s'e-prish benë! duhet qëndruar si burë në Besët që dhashë! djalën? (*i hidhëruar*) Ah! Perë-

ndi! ç'e keqe qysh të bënj? ... zdi më ç'anë ta zë? ...
(i drithtëruar) Ja djalit t'ia ngul thikën! ja se të prish
benë, të këthenj Besën! ... (me kuxim të math) Ah!
ç'them unë? dhe nga trimëri e kësaj gruaje s'turpëro-
hem? ... Të këthenj Besën? ... Jo, jo! do të mbanj be-
në! do të qëndroj në Besë!

Vete drej Vahidesë.

VAHIDE.

Shumë mejtohesh! të shoh në një rëmbim të math!
s'ka gje; në ndruhesh? ...

Pak nga pak ze të ngryset.

FETAH.

Jo, mos u-tremb ti? mbaj zemrën! unë u-ndothçë
më një-qint luftra dhe s'më gjeti gjë! ... Me t'im më,
me t'im bir pastaj piqem, po eja ti! ... (udhës me vet-
he) Im' më? ... Ah! Ah! sa eret, aqë më shtohet tmeri
në zemër! ... Këta male më duken sikur janë kuçedra
e më sulen të më hanë! ... më vjen sikur do të më
marin shpirtin! ...

Shkojnë më të djathtë.



PAMJ' E GJASHTË

Borsh në shtëpit të Fetahut, një e-ndarë! më të mëngjër një minder, më të djathtë dy dritare, përpara një derë. Duri ka ndenjor më një çip të minderit, nër duar ka një palë tespihe të gjata dhe po i heq duke mejtuar. Pranë ka një shklop të bardhë, përdhe një palë heqëla. Në mur janë varur ca armë.

Përflim I.

DURI, vetëm.

DURI, me vethe duke hequr tespihet.

Perëndi!... Perëndi!... Perëndi... o im Zot!.. Ti je i zot' i të gjithëve!... Ti je ndihmës i të mjerëve! Fal-më! ta shoh dhe një herë me sy djalën! Ah! djali im! vallë ku të kam? nje-zet vjet u bënë, më le të mjerë ve-tëm dhe ike!... vall', e harove mëmën e mjerë? nuk' e mejton se të kam mbajtur nëntë muaj në bark... me sa mundime të kam ritur?... ah! një-zet vjet u bënë! një-zet vjet... në këte të ndarë q' ahernaj kur më puthi dorën dhe iku! Mëmë „lutje Perëndisë të dalim faqe-bar dhë” më tha. „Do të lutem të kthehi me nder për së shpejti biro” i thashë... Që kur shkoi e këtej, as kartë mora, as nonjë fjalë kam dëgjuar për të! (*nxjer sha-*

min e zezë dhe pshin lottë) Ah! t'ish gjallë do te kish ardhur gjer tani! Ah! e mjera, kërcurja unë! ... Mbec vetëm! ... një-zet vjet kam së qari mbrem' e mëngjes m'u veshnë sytë! ... Të kishe edhe t'im nip kur-do-herë pranë, më hiqej ky duf pakë. Po dhe ai më një muaj një herë dhe mezi vjen! një ditzaj erdhi më tha se dashka një vajzë bariu; ajo s'është për të, po ç't'i bësh, nuk ja prisha. Dërgova Salihanë e kërkoi vajzën; po kur s'është thënë nga Perëndia, nuk' e dhanë! ... vetëm kam frikë mos hidhërohet shumë nga kjo Selfua! dërgova ta thëres, të shohim. Po më s'dihet që; munt të vinjë dhe pas një muaj! po të më kish shkuar dhe ky në Mal-të-Zi... se dhe ay desh të vinte! mirë bëra që s'e lashë, pastaj ç'bënja unë?... Ah! këto të shkreta lufta! ... më s'rreshtin kurrë! ... Ah! kjo mënyr' e luftës vaftë në funt të dheut! mos ju dëgjoftë emri gjëkunt! Kjo e shkretët! sa mëma, e sa atër i le pa djem; sa bij pa atër, sa gr'a pa bura, sa motra pa vëllezër ka lënë! sa bij të mëmëdheut e të atërvet, sa bura të gravet, kanë vatur e më s'janë kthyer nga lufta! Që të gjithë vriten pa të thënë.

Pshin sytë. Selfua me ngadale ryn brënda

Përflim II.

DURI, SELFO.

DURI, me të parë Selfon qëzohet dhe lot pakë nga vëndi.

Oh! ardhe djalë! (hap krahët) qas-m'u të të push-tonj biro! ... (Selfua vete i puth dorën Durisë, dhe ajo e pushton dhe e puth) Të paça djalë, më rofsh biro! sa bëre mirë që erdhe! po qysh u bë kaqë shpejt? ..

SELFO, *i gëzuar ia pret fjalën.*

Memë! ... arç të të gëzonj me një fjalë...

DURI, *me rëmbim.*

Ah! për djalën, për Fetahnë ke dëgjuar gjë?

SELFO, *i hedh duart më qafë Durisë.*

Si urdhëron mëmëzë, im' atë!

DURI, *me një gëzim të math dhe me rëmbim.*

Vjen më thua? ... Vërtet? më vjen diali? ... Oh! oh! Perëndi, zë-më djalë.. të ngrihem! ... oh! lavdi paç o! madhi Zot! ... (*Selfua e zë pej krahu dhe ajo mer shkopnë në dorë dhe ngrihet me gadalë*). Vjen diali? ... oh! Selfo! vështo; m'u-forcuan gjunjët! ... M'u-hapnë sytë... Lësho-më Selfo, lësho-më! (*Selfua ja le krahnë, Durija duke mbajtur në shkop, ze të ecënj.*) Pa vështo, zura t'ecënj! ... oh! ç'fatbardhësi është kjo! ... Ah! ndjenj një trazimë në zemër! ... Ah! kam frikë! ... pak ujë djalë! ... ujë! (*Selfua mer ujë dhe ja sjell; Durija pshtetet në mur dhe e pi*) ze-më djalë, ze-më! ... Të mbledh vethenë pak! ... Ah! pse më reh kshu zemëra? ...

Selfua e zë pej krahu dhe ajo unjet në minder.

SELFO, *i qetuar e vështon në sy një copherë, pa i qaset.*

Qysh ke qënë? mëmëzë!

DURI.

Mirë jam djalë, mirë... s'kam gjë... kur më vjen djali? ku është tani? ...

SELFO.

Djali i Beut dërgoi një letër; im atë atje qënka,
„këto ditë do të kthehet në Shqipëri shkruan”!

DURI.

E? ... kur vjen?

SELFO.

Këto dit.

DURI.

Këto dit? ... Ah! djalë! me mirë të mos më paski-
she thënë se më the! mua këto dit do të më duken si
muaj!

SELFO.

Duro dhe ca dit mëmëzë! ke kaqë vjet që po pret
e...

DURI, *heq trespiket.*

Mirë djalë, mirë... Perëndi! ... Perëndi! ... Perën-
di! ...

SELFO, *i hedh dorën më qafë Durisë dhe sikur e
mer me të mirë.*

Sa të gëzova me këto fjalë mëmë!

DURI, *heq trespiket.*

Shumë bir, shumë! rofsh e qofsh djalë!

SELFO.

Po dhe unë dua një gjë prej teje.

DURI.

Thuaj djalë! ç'kërkon?

SELFO.

Po të mos më thuash se jo.

DURI.

Ti e di djalë që s'ta prish unë! thuamë! ç'është?

SELFO.

Unë bëra një foshnjëri.

DURI.

Hë! foshnjëri? Ti!

SELFO, *i turpëruar.*

Si urdhëron mëmëzë! një foshnjëri... po të lutem falma.

DURI.

Thuaje, thuaje të shohim... në është gjë që falet...

SELFO.

E di a... S'është ajo vajzë e bariut që të kishe thënë se e dua?

DURI.

E? ...

SELFO.

Atë vajzë vamë e rrëmbyem me urdhërit të Beut.

DURI, *me një rëmbim të math.*

E rëmbyet?... Ti! ti të rëmbesh vajzë!... Ah! Ja; tani do të më bjerë pika!

SELFO.

Tani ç'ish për të bërë u-be; po, lemë ta sjell në shtëpi.

DURI.

Qysh the?!... në shtëpi?... Të rëmbesh vajz' e të ma sjellç këtu e?... jo, jo djalë! sa të jam gjall vetë, s'ryn e atillë gjë në shtëpit t'ënë!... Ty, si të dy sytë të kam, po për të bërë fjalën t'ënde s'munt t'i prish nder' e shtëpisë që e ka patur të një mijë vjete!... tani shko! cpejt ja shpjerë t'et vajzën!

SELFO, *me vethe.*

T'et? S'e di që...

DURI.

S'munt të bëhet!... unë s'jap lejë për këte gjë! një-zet vjet u bënë që ka ikur djali, edhe kur qe këtu ish i vogël! Vetë, un' e kam kthyer shtëpinë! Tri-dhet' e tetë vjet ka që më ka vdekur i ndjyeri burë! Q' aher' e tëhu kam që po e ruanj nder' e kësaj shtëpie! edhe gjer sa të më vinjë djali, unë do t'ja ruanj. Si të vinj' yt' atë, ay di... Në dashtë le të të lerë... hiq dorë, mos flliq nder' e pleqet... pa marë vesh njeri, sa ka-që-herë ktheja t'et të bijën!... ku të kërkosh e s'gjendet nuse për ty?!...

SELFO, *nxjer koburen.*

Unë s'munt të heq dorë nga ajo! Ja do të më lesh, ja se vethen t'ime... *(e ngreh koburen.)*

DURI, *me një rëmbim të math ngrihet i zë dorën.*

Ah! djal' i pa dëgjuar! ... edhe këte do të ma shohin sytë?

SELFO.

E dua! ... s'e lë dot! ... Ç'të bënj?

DURI, *e helmuar.*

Lark mej-e, pa ç'të duash bëj! ... Unë një plak' e përgjunjur jam!... Ç'munt të të benj? Ti je një-zet e pesë vjeç burë tani! edhe nder' i shtëpisë i yti është! ... Ti di, ç'të duash bëj! ... vetëm syt' e mij të mos m'i shohin!

Mer tespiket dhe duke mbajtur në shkop del.

SELFO.

Ku vete mëmë?? mos ikë, se do të sjell nusen të të puthnjë dorën! ...

DURI, *duke dalë nga dera.*

Unë s'njoh t'atilla! ... s'dua të zirem ngoje për të lik në botë! ... Ja; unë po hiqem në të ndarët t'ime; u-mejto mirë, se ti do t'i përgjigjesh t'yt eti.

Shkon.

SELFO, *me vethe.*

Ah! nga ime më, s'e besonja këte gjë! ... s'e pan-deha të me delte kshu! ... tani qysh të bënj! ...

Atë çast ryjnë shokët e Selfos nga dera bashkë me Merushen. Merushja s'shtë më vethe.

Përflim III.

SELFO, XHAKO, RAPO, EVRENOS, MERUSHE.

SULÇE, RAPO, e lenë mi minder Merushen dhe të dy për një goje.

Ç'bëre Selfo?

SELFO.

Ah! nukë do... s'është punë që bëhet! ... Ja; u-hoq në të ndarët të saj. Ç'të duash bëj; unë të mos e di; syt' e mij të mos më shohin! thotë!

SULÇE.

Pa t'i vete unë se mos e bint!

Del.

SELFO, të tjerëvet.

Dilni ju vëllezër! kijini gati armët, se më s'dihet se ç'na ngjan!... për pakë vinj dhe unë të dëfrejmë!

Veç Selfos dhe Merushes të gjithë dalin. Sulçeja rym.

Përflim IV.

SELFO, SULÇE, MERUSHE.

SULÇE, duke ryrë nga dera.

E ka mbyllur së brendëshmi derën; nuk do ta hapnjë! ... „Ç' të doni bëni, mua s'më shihni gjer sa të më vinjë djali!" thotë... E vuri në ajo, çdo t'i bësh? le të rijë!

SELFO.

Ajo di de... (*duke qasur Merushes*) Do gjë për të ngrënë vajzë?

Merusheja ka mbyllur sytë me duar, dhe është pshtetur më një jastek e qan.

SELFO.

Tani kësaj vetëm prehje i duhet. Ta lëmë vetëm të mbledhë vethenë pakë... Ejani të dalim të dëfretimë me shokët!

E zë prej krahu Selfon dhe dalin të dy. Derën e kyçin së jashtëmi.

Përflim V.

MERUSHE, vetëm.

MERUSHE, ngrihet; si sheh mirë që s'ka njeri.

Ah! ku jam kshu! ... o Perëndi! .. në burg! ... në shtëpit t'ati që më vrau atën e dashur? ... Ah! qysh të shpëtonj? ... Ah! kujt i vinte ndër mënt kjo? ... sot, nesër, pritnim të na sosej dëshira... Ah! Rexhep! ... Rexhep! vallë e di ti? ... vallë shpëtoi im atë? ... Ah!

s'më ngjan!... plumb' i shkretë mun në krahror e mori!... Për një herë u gremis!... Ah! s'besonj... unë t'em'atë e humba për jetë!... mua im' atë m'u-vra!... Ah! i nderçimi atë!... Ti je nderë pa shpirt, e unë s'të jam pranë të të qanj!... Rashë në dorët të gjakësit!... Ah!... atë!... im atë vdes, e unë të ronj më!... Nga Rexhepi u ndash për jetë!... e unë duhet të ronj?... *(dëgjohet një zë pushke)*. Munt që kanë ardhur të më shpëtojnë mua!... Ah!... Perëndi!... po në ka ardhur Rexhepi... po n'e-vrafshin dhe ate... Ah! veç atij, kush do të më shpëtonjë mua?... Ay është djalë edhe në ardhhtë e vrasin!... Ah! ç'është kjo zi? ç'është kjo e keqe!... ç'është ky hidhërim!... *(Duke qarë bije mi min-der; dalë-nga-dalë ze të ngriset. Së jashtëmi vjen zër' i këngëvet; më pastaj dëgjohet kërcëllima e pushkëvet)*. Ah! prapë krisi!... kujtom o! Perëndi!... *(i qaset dritares dhe vë vesh)* këngë këndojnë!... Ah! unë qysh t'i duroj gjithë-këto?... të ndahem nga Rexhepi, pa të ri në duar t' armikut mbytur me gjak të t'im eti!... Të dëgjonj me veshtë e mi këngët e vallet që bëhen për gjëmët të t'im eti!... Ta vështonj me sy gjaknë e t'im eti që rjedh nga duartë e armikut!... Ah! unë kaqë e poshtërmja, kaqë faze-zeza jam?... Jo, jo! ja ikënj këtej, ja se vdes!... *(nxiton drej derës e shtyn me forcë ta hapnjë; me të kupëtuat q'është e kyçur)* Ah! derën e kanë kyçur!... dhe mua më mbyllnë këtu!... Më së fundi edhe kjo e keqe na erdhi më krye!... *(i qaset dritares)* këtej të hidhem!... *(nxjer kryet jashtë e vështon përposh)* Ah! është shumë' e lartë!... po s'ka gjë; edhe n'u vrafsha ca me mirë!... *(sulet të hidhet)* Po në mos vdekça... si të më thyhet no një këmb' a në një dorë qysh munt të ronj... *(duke ardhur gjer në mest të të ndarës)* Ah! me ç'anë t'ikënj?... Ç'të bënjë?... *(tek vështon rreth e rotull i zë syri armët që janë varur)* He! ca me mirë!... *(mer koburen e vështon)* plot qenka! *(e ngreh dhe e kthen drej krahrorit)* këtej s'kam shpëtim! sa të ronj në kurt kshu, vdekja është një mij' herë më e mirë!... Ah! po vritem Rexhep! po vdes mëmë... do të vete në i imi atë... *(heq*

këmbëzën e kobures) Rexhep! (koburja s'ndes. Një njeri së jashtëmi mundohet me forcë të hapnjë derën. Merushja prapë e ngreh koburen) Ah! dhe ti kërkon të më mundosh? ... (e kthen prapë në krahor) Ah! Rexhep! pa parë ty dhe një herë, po vete zhur! po vdes Rexhep! ...

Tek thoshte këto fjalë, Selfua përnjëherë hap derën; me të ryrë brënda e rëmben koburen nga dora e Merushes.

Përflim VI.

MERUSHE, SELFO.

SELFO, me të rëmbyer koburen nga dor' e Merushes.

E çmëndur! ... Ç'kërkonje të bënje? ... vethenë t'ëndel! ... s'të vjen keq, pa bërë nuse kërkon ta ndesh pa shpirt mbërdhe atë shtatn' e bukur? ...

Merusheja e turpëruar dhe fort e helmuar pshtetet pas murit. Selfua e vë në vënt koburen.

MERUSHE, me vethe.

Ah! Perëndia na paska vënë krusmën nevej... sikur të mos kish ardhur dhe pakë ky! ...

SELFO, duke qasur Merushes.

Vallë ç'pe këtu vajzë, që hidhërohesh kaq, sa kuxon të vraç dhe vethenë?! ... Mua si kusar, e si armik mos më vështoj! ... unë as armik, as kusari yt nukë jam! ... unë të dua, të dua ty! (Merushja trembet) nga dashuri e tepër të rëmbeva! Ti s'je robj im, je e dashura ime, je nusja ime! ! unë jam buri yt!

Kërkon ta zërë prej dore.

MERUSHE, duke hequr vethen; me zemërim e me rëmbim.

Ti? ... gjaksor' i t'im eti! ...

SELFO.

Jo! t'et'atë s'e vrava unë; ate e vrau madhëri e tija!

MERUSHE.

Ah! s'qe sa — do ç'bëre, po dhe fajné kërkon t'ja hedhç t'im eti!

SELFO.

Ç'na duhen ato; ti tani do të bëhesh gruaja ime!

MERUSHE.

Mos e dhëntë Perëndia!

SELFO.

Unë të kam në dorë... kjo natë s'u ngjan atyre ditëvet që piqeshim në mal! ... ahernaj ti s'më vësh-tonje fare në sy! s'e bënje vethen as një fjalë të më flisnje! po sot je në dorët t'ime! ...

MERUSHE.

Vërtet; në dorët t'ënde jam! munt edhe të më vraç? po mos pandeh se të jepem ty!

SELFO.

Jo! unë ty s'të vras! po, po të mos më jepesh, të

lidh duar e këmbë dhe të mbyll më një katua! gjer sa të vdeç s'të nxjer s'andejmi.

MERUSHE.

Qysh e di ti? në dorët t'ënde do të më lënë mua?

SELFO.

Jo... po do të të marin!... Ti me atë mëndje vete a? sikur gjithë njerëzi e Progonatit të mblidhen, prapë s'të shpëtojnë dot nga duart e mija ty!... kam pesë-mbë-dhet trima të armatosur që i vinë reth e rotull oborit tër natën! edhe një mizë s'munt të rynjë së jashtëmi!... në do të mirën t'ënde, hiq dorë nga kjo mëndje!... pa tjetër lloje s'ke shpëtim til!...

MERUSHE, *e hidhëruar me vethe.*

S'bën!... vërtet s'bën! këtij sa t'ia priç, aqë me shumë nxehet... sikur ta gënjenj sa të shkojnë ca ditë, pa Perëndia është' e madhe!... kush e di se ç'bëhet.

SELFO.

E? ... ç'do të bësh?

MERUSHE, *rëfeket si butë.*

Po unë edhe të dua... sot s'bën... se sot është dita q'u-vra im'atë... Këte brëmje do të qanj t'im atë... si të shkojnë ca ditë munt...

SELFO, *i gëzuar.*

Pastaj do të duash é? ... *(me vethe)* Oh! mezi u — bint!...

MERUSHE.

Ç'të bënj? ... më ke në dorë! ...

SELFO.

Jo, mos thuaj! thuamë një herë mua që „ty të dua”.

MERUSHE, *e tmeruar me vethe.*

Ah! Jo! ... këte fjalë edhe me të gënjeshtër s'më vete gjuha ta them! ... Gjaksorit t'im eti „ty të dua” t'i them? ... mos e dhëntë Perëndia!

SELFO, *duke e zënë prej dore.*

Fol, thuamë një herë „ty të dua” pa ç'të duash bë — më! se e tërë bota e inja do të më bëhet! ...

MERUSHE, *e heq dorën dhe vete drej minderit.*

Të lutem! sot ler-më në punët t'ime! se është dit' e vajit t'im eti! ...

Ri për mi minder, ze syt' me dorë dhe qan.

SELFO.

Mirë; po mua nuk do të më përzësh së këtejmi; dhe unë këtu mi minder do të bije.

MERUSHE, *ngre kryet dhe me vethe.*

Të bjerë dhe ai këtu? ... po... (më zë) Ti di.

SELFO, *duke qasur Merushes.*

Ta dinje ti se sa të dua, munt që s'i bënje gjithë

këto! *(si qetohet pakë)* M'erdhi gjumi... të pshtet pakë kokën në gjut t'ënt!... Ah! sa fatbardhi jam, që më zuri gjumi në gjut t'ënt!

Merushja s'i përgjigjet, qan pa reshtur. Selfua vë kokën mi gjut të Merushes dhe zgjatet.

MERUSHE, *me vethe.*

Ah! o Perëndi! ç'është kjo e keqe kshu? gjaksori i t'im eti, një që më ka ndarë për jetë nga Rexhepi, të flierë në gjut t'im!... Ç'është ky tmer kaq i madh!... *(duke vështuar kokën e Selfos)* Qimet e kokës më duken si gjarpën! më vjen sikur do të më hanë! M'u nxi ky vënt, këto dy orë që kam këtu m'u duknë si dy vjet! ah! o shpirt i t'im eti! vallë më sheh mua?... vallë e sheh gjakësorë si ka rënë në gjut të sate bije?... *(duke vështuar me tmer fytyrën e Selfos)* Gjaksor' i t'im eti!... *(me re e vështon në sy dhe me ngadalë)* Ah! fjeti! e zuri gjumi të mallkuarin! Ah! Perëndi!... *(zgjat dorën mer një jastëk dhe me nga dalë i ngre kokën e Selfos i vë jastëknë nën të heq gjun' e saj dhe ngrihet më këmbë, duke vështuar me re Selfos).* Gjaksor' i t'im eti!... *(hiqet praptazi)* Ah! kjo kohë s'do humbur; tani t'ja çpërblenj gjakn' e t'im eti! *(duke marë koburen).* Vërtet, pastaj dhe unë më s'kam shpëtim; po, si do që të bëhet nga dora e këtij shpëtonj; dhe gjakn' e t'im eti e kam të marrë!... Mirë them; sa të mbetem në dorë të këtij, vdekja është një mijë-herë më e mirë!... *(e ngreh koburen dhe duke vajtur pranë Selfos)* S'do humbur kohë! *(vete t'i bjerë, püstaj hiqet prapa)* Ah! s'kuxonj dot!... Ah! Perëndi!... sa të dobëta i ke lindur gratë!... edhe një njeriu që më ka vrarë t'im atë, një njeriu që ma ka rëmbyerë dëshirën e zemrës, e ma ka nxirë jetën, të mos munt t'i bije?... Në mos, t'ja kthenj vethes s'ime, dhe shpëtonj nga gjithë këto të këqia!

Tek e kthen koburen drej krahorrit të saj, duket

*Rexhepi në dritaret; Merushja me të parë Rexhepnë i
bije koburja mberdhe dhe nxiton drej dritares.*

Përflim VII.

MERUSHE, REXHEP, SELFO, në gjumë.

MERUSHE, me rëmbim të math.

Ah! Rexhep! ... ti këtu? ... Ah! Perëndi!

*REXHEP, ryn brënda, dhe duke pushtuarë Meru-
shen.*

Ah! Merushe! arçë të të shpëtonj ty!

MERUSHE, duke rëfyer Selfon me gisht.

Hesht... se...

REXHEP, duke hedhur dorën në koburet.

*Ai cili është? ... gjaksori i t'yt eti?! ... Ay që të
rëmbeu ty? ...*

Me kobure në dorë këcen mi te.

MERUSHE, duke zënë Rexhepnë.

Të lutem! ... mos! ... mos Rexhep! ...

REXHEP, i mahnitur.

Ah! Merushe! ... ti për zot i del këti a? ...

MERUSHE, me zëmërim e habitur.

Për zot më thua?... Unë do t'i dal për zot këti a?
Ah! Rexhep!... mua më thua këto!...

REXHEP.

Kur qënka kshu! lermë ta vras! .. t'i mar gjaknë e
atës tënë... dhe ty të të shpëtonj nga dora e tij!

Prapë kërkon t'i hidhet Seljos.

MERUSHE, *me rëmbim e zë Rexhepnë.*

Rexhep!...

REXHEP.

Ç'është... Merushe... në është se e do thua —
më!...

MERUSHE, *me zëmërim.*

Ah! mua më thua?... (*e hidhëruar*) Ç'të duash
bëj! po ta dish që po ryn në gjaktë të dyvet ne! ... që
të dype do të na vrasin!

REXHEP, *i habitur.*

Vërtet!... (*si mejtohet pakë*) Kur është ashtu
eja... eja të të shpëtonj ty një herë pa, pastaj vinj e
mar dhe gjaknë e t'im eti!... (*duke lutur Merushes*)
Ah! fal — më mua!... fal — më! Merushe... nga hi-
dhërimi i tepër... e humba vethenë; po të mos hum-
basim kohë!... (*duke rëjyer dritaren*) Eja të të xbres
këtej ty!

Më ngadalë shtyhet dera.

MERUSHE, *me rëmbim të madh.*

Ah! po vinë! ... Rexhep! ... ikë ti! ... pshihu... çpejt!...

*Ryn Fetahu; Rexhepi nxjer koburen; për një herë
ryn Vahideja.*

Përflim VIII.

Të parët, FETAH, VAHIDE.

MERUSHE, duke u hedhur në gjitë të së ëmës.

Ah! Mëmëza ime!

REXHEP, duke qasur Vahidesë.

Mëmë! dhe ti këtu?! ...

Fetahu i qaset Selfos e vështon.

VAHIDE, ngadalë.

*Ti nga erdhe? ... (Rexhepi rëfen dritaren) Ky nje-
ri! (duke rëfyer Fetahnë) do të më marrë gjaknë e bu-
rit, do të më shpëtonjë t'ime bijë! ... më dha Besë! ...
Ku është gjaksori? cili është? ...*

REXHEP.

Ja; po fle.

FETAH.

Ky është? ...

Unjet e puth nga sytë Selfon.

MERUSHE, duke pushtuar t' ëmmën.

Perëndija s'ka lënë njeri në të keq! ... Mëmëz, unë s'pritnje shpëtim as nga nonjë anë fare! ...

Vahideja për një herë i pushton REXHEPNË e MERUSHEN dhe i puth pastaj pa vënë re FETAHNË zënë e kuvëndojnë me ngadalë.

FETAH, duke puthur djalën, me vethe.

Djali! ... bir' i vetëm! ... kur shkova e — lashë foshnjë! tani qënka bërë burrë! ... Ah! po e shoh dhe një herë me sy djalën! po, ah! ... qysh e shoh? ... me mirë të mos e paskishe parë... me dorë t'ime... A! ... Jo... s'kuxonj dot... (si mejtohet pakë) Po fjala? ... beja që bëra? ... Besa që lidha? ... A! kuxim... kuxim... (nxjer koburen me tmer e ngreh si e puth dhe një herë djalën, ja kthen drejt në krahruar) Ah! djali im! ... biri im! ... Selfua im... (për një herë e mbledh vethenë dhe me rëmbim të madh) Ah! ç'bënj unë? ... dritën e syrit! djalën kërkonj të vras! Jo! ... po... Ah! (e zë një të drithtur në trup, koburja për një herë xbrazet, Selfua goditet në krahror, lot pakë dhe ep shpirtin: koburja i bije nga dora Fetahut. Fetahu i tmeruar dridhet dhe hiqet prapa me zë) Ah! djalën!... t'im bir vrava!...

VAHIDE, REXHEP, MERUSHE, duke nxituar drejt tij, të tre për një gojë.

Yt bir? ..

FETAH, i tmeruar vete areq kujomës të birt.

Ashtu! .. djali! ... djali im qe! ... Unë jam Fetahu! ... pas një-zet vjet, sot me të këthyer në shtëpi bëra, këte të keqe... (duke vështuar dorën e tij me tmer) Ah! u thafsh o dorë! ... qysh kuxove i shtive në krahror të djalit! ...

I bije për sipër të birt dhe qan.

VAHIDE, duke vështuar me tmer në sy Fetahnë.

Ah! ç'farë atë pa mëshirë? ... Pse s'më the kur qënka yt bir? ... Ç'bërë o faqe zi? ... djalën tent!..

FETAH, duke ngritur më këmbë me kuzim të math.

Motra ime! ... s'i ka për të mbetur njeriut kjo jetë! ... vdekja është udhë e përgjithshme! një ditë më parë, një ditë më pastaj s'ka nonjë ndryshim! ... Si mjer' ata që vdesin me turp mi krye! ... pa vdekja më nder, është gëzim i përgjithshme! ... Im bir e kërkoi vetë këtë! ... t'ia kish bërë nonjë tjetër shkonte me turp... pa si t'ja bënj vetë...]

VAHIDE, me zëmërim i pret fjalën.

T'ja bësh ti!... i ati!... Ah! një që xgjat dorë mi dritët të syrit, është m'i keq se një egërsirë!..

FETAH.

Nga një që s'mban fjalën, nga një që prish benë, nga një që s'qëndron në besë, nga një që s'ruan nderë; kjo është një mijë-herë më e lehtë. Kjo në është një egërsirë, ajo t'jatra është më e keqe! ... Unë në e vrava t'im bir, për të mbajtur Besën e vrava! solla në vënt dhe nderin e shtëpisë!... unë punën t'ime bëra! (duke rrëfyer kufomën e Selfos) Ja! ... gjaknë e burit ta mora! ... gjaksorin e vrava!..

VAHIDE, me hidhërim i pret fjalën.

Të mos e kishe bërë me mirë! se dhe sytë s'na shihnin një tmer kaqë të madh.

FETAH, s'e pret fjalën.

Vajzën ta shpëtova! ... (me një dorë zë Merushen, me tjetret ze Rexhepnë pej dore) Ja, bijë; ty të shpëtova! ... po t'ap ne i dashuri! ... ja! djalë! të dashurën ta shpëtova; dhe ty po t'ap ne i dashuri! ... edhe unë po u ap zemrën, dashurinë t'uaj bashkë me vetet t'ime do ta shpije në varr! ... bijtë e mij! pas kësaj më s'ua rëmben njeri dëshirat e zemërës! ... ju të jini fatbardhë! ... njeri jatrin ta doni! ... (duke rëfyer Vahidenë) dhe mëmën ta doni!

VAHIDE, e helmuar u rëfen Fetahnë.

Dhe atën ta doni! ... Ky është ati i juaj! ... në këte jetë dhe në atë është vëllaj im!

FETAH, së pshehtazi nxjer koburen dhe e ngreh.

Jo! unë edhe më s'e sosa punën! gjakn' e burit ta mōra, vajzën ta shpëtova, dhe tani do të mar gjakn' e djalit! (e kthen koburen dreq krahërorit dhe e xbras) Unë gjaksor' i t'im biri!

Bije.

VAHIDE, duke nxjerë koburen.

Edhe unë do të mar gjakn' e një trimi si ty! ... Do ta ngre këte trupn' e shkretë, q'u-bë ngjaj' e dy vrasjeve! ... ç'e dua këte jetë të zezë! ...

E ngreh koburen.

REXHEP, duke zënë doren e Vahidesë.

Mëmë! ...

MERUSHE, duke rënë nër këmbët të së ëmës.

Mëmë e dashur! neve ku na le?

FETAH, i plagosur me mundim të math ngrihet,
ja rëmben nga dora koburen Vahidës.

Jo! ... se ti u duhesh këtyre!

Për një herë Sulçëja, Rapua, Xhakua, Evrenosi, me
armë nër duar — me rëmbim ryjnë brënda.

Përflim IX.

Të parët, XHAKO, RAPO, SULÇE, EVRENOS.

SULÇE, me të ryrë në derët.

Ç'u bë? (sheh Selfon të vrarë) Ah! Selfo! ... (sho-
këvet) Shokë! ...

TË GJITHË, për një goje.

Ah! ... Selfo...

Nxitojnë drejt Fetahut.

FETAH.

Vëllezër... qëndroni... qëndroni pakë e më dëgjo-
ni! Selfon unë e vrava! (të gjith' i këcejnë) Ti? Unë! ...
i ati! ...

TË GJITHË, qëndrojnë dhe për një goje.

I ati?

SULÇE, për një herë e njeh Fetahnë; le koburen
dhe i heth duart më qafë.

Ah! Fetahu! ... (Fetahu qan) qysh qe kshu! ...
Nuk' e njohe? ...

FETAH, duke rëfyer Vahidenë.

A e shihni këtë grua? ...

TË GJITHË, duke vështruar me sy të lik Vahidenë.

Ah! kjo?

FETAH.

Degjo-më-ni: kjo grua është e em' e kësaj vajze: në të pamë si grua, po, është më e fortë se një burë trim! ... (i pakësohet zeri) jetën t'ime kjo ma shpëtoi! ... Pa ditur cili ishe! ... dhe unë atë... cila ish s'e dinje! ... pa i dhashë Besë... se... gjaksorin e burit... do t'ia vras... dhe vajzën do t'ia shpëtonj...

TË GJITHË, me hidhërim.

Ah!

FETAH.

Ja... unë... Besën që lithmë! ... e mbajta... e sosa... t'ime! ... (duke rëfyer plagën) dhe... gjaknë... e djalit... e mora...

TË GJITHË.

Ah!

FETAH.

Tani... dëgjoni... kjo grua... jetën t'ime... ma shpëtoi... dhe tani... të mos... e kishe... zënë unë... desh të vriste... vethen... e saj... për mua... (Të gjith' e vështojnë me sy të ëmël Vahidenë; Vahideja rëfeket e hidhëruar pse s'e lanë të vritej). Kjo... grua është motra ime... këta... djem... janë... bijt' e minj!...

Mëma... është mëmë e këtyre... Ai... që më do...
mua... t'i dojë... dhe këta... nga... çdo... gjë... t'i rua-
ni... t'u deli... për zot... kur-do-herë... gjithë
ç'kam... e këtyre... është... juve... ja u kam... lënë...
më qafë...

SULÇE.

Do Zoti e ron vetë, bëhesh më mirë... pa...

FETAH.

Jo!... mua... mos më... mallëkoni... s'dua... të
ronj... më... në... jetë... me këto... duar... të ngjye-
ra! me gjak!... të djalit!...

*Rexhepi me Merushen qajnë; Vahidja, Sulçeja,
Evrenozi zënë Fetahnë. Të tjerët hiqen më një anë e
qajnë me shami nër duar. Duria duke mbajtur në
shkop e lodhur me ngadalë ryn nga dera.*

Përflim X.

Të parët dhe DURIA.

DURI, me të ryrë më derë vete drejt Seljos.

Ah! Ç'u-be? ... ç'e gjeti? ... djalën! ...

FETAH, duke qarë me ngashërim.

Ah! e zeza; mëmë! ...

DURI, me të parë gjëndjen e Seljos.

Ah! djali!

I meren mëntë dhe bie mi Seljon.

FETAH.

Ah! e mjera! ... mëmë! ... Ah! vdekje! ... ku je? ... vallë ç'pret me! ... tani... me ç'sy... ti dukem s'imë-je? ...

DURI, *mbledh vethenë.*

Djali! ... (*duke qasur Fetahun*) mallkuar! Ti ma vrave djalën? ... (*për një here e njeh Fetahnë*) Ah! Fetah!

E humbur i-hidhet dhe e pushton Fetahnë.

FETAH.

Mëmëza ime! ...

DURI.

Fetah! ... djalë! ç'është kjo që na gjeti? ... të vish... pa ta gjeç... të vdekur... djalën! ...

FETAH, *hidhëruar.*

Ah! s'e gjeta! ... të vdekur ... unë .. unë.. e vrava! ...

DURI.

Ti? ... Ti! ... Fetah! ...

FETAH.

Si urdhëron memëzë! ... unë... unë... për të... qëndruar në besë... do... mos... do! ... e vrava! ... po, mos... ki keq... memëza... ime... se ja... mora

gjaknë! ... (*Duria hap sytë, Fetahu duke rëfyer plagën*)
Ja... mora... gjaknë! ...

DURI, me hidhërim të madh.

Ah! më një ditë... po hump... dy djem! ... Im
bir! ... mua! ku më le? ...

FETAH, me pakë shpirt.

Ja! ty... tre... bij! ... po të... lë! ... këta! t'i
kam... lënë... ty... mi qafë! ... Kjo... është... ime...
motër! ... ata... janë... bijtë... e mij... që... të tre! ...
të shtëpisë... i ke... vajza... i do... dhënë... djalit...
Me... ta... duhet... të... rrish... herë... këtu... , he-
rë... gjithë... tok... në... Progonat... të vini... mos u
ndaj... nga... këta... (*duke zënë pej jake të ëmën*)
Ja! mëmëzë... fjalën... e... fundit... këte... kam! ...
humbe... dy... djem... fitove... tre... po... vdes...
ndjemë... mëmë... edhe... ju... o shokë... Perëndi! ...

Ep shpirtin.

DURI, ngrë kryet dhe hap duartë.

Bijt' e mij!

*VAHIDE, MERUSHE, REXHEP, për një herë i hi-
dhen në gji.*

Mëmëza jonë!

Funt.
- *! xalderu : beses*
- *Revlisi : jeh romanit, i dëti për mësorin*
- *gaxama : unë të ajo romanit*

PASTHËNIE

E shkruar në vitin 1874, në kohën kur autori ishte i internuar në Tripoli të Libisë, drama „Besa” e Sami Frashërit është një freskë e bukur romantiko-lirike që e futi në letërsinë tonë fshatarësinë dhe malësitë tona me një spektër ngjyrash më të thekshme, duke i cilësuar bukur e me shumë pasion jo vetëm bukuritë e cilësitë e tyre, por edhe aspiratat e synimet e tyre, duke lartësuar vlerat e vërteta të moralit e të etikës së tyre, por edhe duke ndarë e veçuar virtytet nga çoroditjet e tyre gjatë kohës kur disa zakone e doke popullore, si është hakmarrja, e në këtë rast edhe besa e dhënë dhe e mbajtur me çdo kusht e verbërisht, janë bërë anakronizma të rrezikshme e me pasoja shumë tragjike për jetën dhe ekzistencën e popullit tonë, si i ka paraqitur këto autori edhe në këtë vepër të tij.

Mendimtar i thellë, gjuhëtar e shkrimtar, demokrat i shquar revolucionar, iluminist popullor e ideolog i lëvizjes kombëtare shqiptare të periodës së luftës çlirimtare dhe të Rilindjes kombëtare në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, „njëri nga intelektualët dhe patriotët shqiptarë me idetë më të përparuara të kohës, burrë i guximit dhe i veprimit, entusiast e i ditur” — si cilësohet ai në „Historinë e letërsisë shqipe”, vëllimi II — Sami Frashëri lindi më 5 qershor të vitit 1850 në fshatin Frashër, në lindje të Përmetit (Shqipëri), si njëri nga gjashtë vëllezërit e familjes së njohur të Frashërve, dhe vdiq më 18 qershor të vitit 1904 në kryeqytetin e Perandorisë së atëhershme Osmane, në Stamboll.

Mësimet e para Samiu i mori në fshatin e vet, te hoxhët që i zuri i ungji, në turqisht, arabisht dhe persisht. Nëntë vjeç ngeli pa të jatin, Halitin, ndërsa kur ishte njëmbëdhjetë vjeç i vdiq edhe e ëma, Eminja. Nën kujdesin e vëllaut më të madh Abdylit (më vonë një nga figurat më të shquara të lëvizjes çlirimtare dhe të Rilindjes kombëtare, themeluesit e udhëheqësit më të spikatur të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit), bashkë me vëllaun Naimin (poet i madh dhe „fytyrë qendrore e letërsisë shqipe të Rilindjes” e „njëri nga përfaqësuesit më të shquar të lëvizjes sonë kombëtare”), shkoi në Janinë, që atëherë ishte qendër e rëndësishme tregtare e kulturore, ku në fillim ndoqi kursin e gjuhës arabe e persiane, e pastaj, për shtatë vjet, kreu gjimnazin tetëvjeçar grek „Zosimea”, që ishte një nga shkollat më të zhvilluara të asaj kohe në Ballkan. Këtu mori kulturë të gjerë klasike, u dha shumë pas shkencave dhe mësoi mirë disa gjuhë të vjetra, si: latinishten, greqishten, turqishten, arabishten dhe persishten.

I pajisur kështu me një kulturë të mirë klasike, Samiu i përqafoi idetë e iluminizmit borgjez të cilat „e bënë për vete shkollarin e ri dhe Samiut iu zgjua ndjenja kombëtare”. Jeta në Janinë, revoltet e fshatarëve kundër pushtuesve turq e çifligarëve dhe fuedalëve shqiptarë që prej kohësh kishin hyrë në shërbim të pushtuesve osmanllinj dhe shtypnin e shfrytëzonin së bashku me ta masat e gjera popullore, pastaj idetë e revolucioneve borgjeze në botën perëndimore dhe të iluminizmit që kishte përfshirë atëherë shtresat e inteligjencës përparimtare, e ushqyen që heret shpirtin e ri dhe përparimtar të Samiut dhe ndikuan shumë në formimin e botëkuptimit të tij demokratik dhe të ndjenjës së tij për çlirimin dhe arsimimin dhe emancipimin e popullit të tij.

Vërtet — si shkruan në Historinë e letërsisë sonë — vendi i Sami Frashërit në letërsinë shqipe nuk është ai i një artisti krijues sa i një mjeshtri të prozës politike dhe publicistike e polemiste, një punëtori të vyeshëm e inventiv të gjuhës e të shkencës, por edhe i një ideologu të lëvizjes kombëtare çlirimtare dhe i emancipimit kulturor të

popullit tonë. Me shkrimet e veta shqipe Sami Frashëri i dha një kontribut të dukshëm krijimit të arsimit shqiptar dhe zgjimit të ndërgjegjes kombëtare.

Me të kryer shkollën e mesme (1871) në Janinë Samiu shkoi (1872) në Stamboll, ku zhvilloi një aktivitet të gjerë kulturor, shkencor, letrar e publicistik. Aty menjëherë bie në kontakt me intelektualët e shquar shqiptarë të Rilindjes sonë kombëtare Vaso Pashën, Jani Vreton, Hoxha Tahsinin, Konstantin Kristoforidhin, Ismail Qemalin e të tjerë. Por njëkohësisht bënte pjesë edhe në lëvizjen përparimtare të të ashtuquajturve „turq të rinj“ që kërkonin vendosjen e një regjimi kushtetues në Perandorinë Osmane. Atëherë Samiu u bë mik i ngushtë me njërin nga udhëheqësit e kësaj lëvizjeje, poetin Namik Kemali, me të cilin nisi të botonte revistën „Hadika“ (Kopshti, 1874), të cilën qeveria e ndaloi, kurse Samiun dhe Kemalin i internoi në Tripoli të Libisë. Atje Samiu e shkroi dramën „Besa“ në gjuhën turke dhe kur u kthyer (1875) kjo dramë edhe u luajti në Stamboll. Me t'u kthyer në Stamboll, Samiu nis botimin e gazetës së përditshme turke „Sabah“ (Mëngjesi, 1875) dhe prej asaj kohe, Historia e letërsisë sonë shënon se gazetaria për Samiun u bë „një mjeshtri e dytë“. Gjatë jetës së tij ai drejtoi gjashtë gazeta e revista të cilat luajtën një rol përparimtar në jetën politike, shoqërore dhe kulturore dhe u bënë edhe „tribunë për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar, përmes mënyrave legale të kohës“. Në vitet në prag dhe gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878—1881) Sami Frashëri është në ballë të patriotëve shqiptarë në Stamboll dhe kryetar i „Shoqërisë së të shtypurit të shkronjave (librave) shqip“. Atëherë (1879) botohet edhe „Alfabetarja“ shqipe dhe zë fill i ashtuquajturit alfabeti shqip i Stambollit.

Edhe pse nuk jetoi gjatë, Sami Frashëri, arriti të shkruajë shumë vepra gjinësh më të ndryshme, duke filluar nga traktatet politike e filozofike e deri te veprat letrare e shkencore, tekstet shkollore, fjalorët e të tjera. Në gjuhën shqipe shkroi gjashtë vepra, nga të cilat më e rëndësishme është „Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet“.

Shkroi edhe tekstet „Gjuha shqipe”, *Dhe shkronja* (gjeografi), „Alfabetare e gjuhës shqipe” dhe „Gramatika e gjuhës shqipe”. Midis librave shkollore të Samiut, Historia e letërsisë shqipe e shquan „Shkronjtoren” e tij për të cilën thotë se është e para gramatikë shqipe për shkollat, e punuar në baza shkencore të shëndosha, që „lojti një rol të mirë për fillimet e normalizimit të gjuhës së re letrare shqipe, veçanërisht të ortografisë. Te „Abejarja” e Samiut gjejmë copa të vogla këndimi, skica e tregime të shkurtëra, që janë ndër gjërat e para të letërsisë shqipe për fëmijë”.

Në pjesën e parë të librit „Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet”, që çmohet si kryevepra e Sami Frashërit në gjuhën shqipe, autori bën një histori të shkurtër të popullit shqiptar që nga torigjinat pelazgjidke dhe ilire. Në pjesën e dytë përshkruan tokat shqiptare dhe pasuritë e tyre, veçoritë e cilësitë e popullit tonë, kurse në pjesën e tretë tregon gjendjen e Shqipërisë në Perandorinë Turke dhe rrugën e çlirimit të saj.

Duke shquar cilësitë stilistike të prozës së Sami Frashërit, Historia e letërsisë sonë thekson se „frazja e tij e lidhur dhe e punuar, e shkurtër dhe e mprehtë, është model i frazës polemiste. Ajo këtu çjerr çdo maskë, aty fut skalpelelin në plagë dhe e nxjerr flliqësirën e brendshme në dritë; herë dërmon me logjikën e pamëshirshme, me shkallëzimin e argumenteve, që vinë si valë të forta e më të forta, herë buçet si bori kushtrimi. Paraqitja e realitetit shqiptar të kohës kontraston dhimbshëm me zbukurimin e së kaluarës; krenaria e malësorit shqiptar tregohet se katandisi nën kërbacin e sundesit barbar; perandoria turke e falimentuar krahasohet me të mbyturit, kurse shqiptarët që kërkojnë t'i japin dorën, me njeriun që e tërheq i mbyturi pas vetes në fund të detit...” Ai „nuk predikon me ëmbëlsi, por grish për luftë, për jetë a për vdekje”.

Dihet se një pjesë të madhe të veprimtarisë së tij shkencore, letrare dhe publicistike Sami Frashëri e zhvilloi edhe në gjuhën turke, arabe dhe frenge. Për më tepër, llogaritet se në këto gjuhë shkroi rreth 45 vepra, duke mos numëruar shumë artikuj e punime të ndara. Përpos dra-

mës „Besa”, në këtë gjuhë shkroi dhe përktheu disa vepra që kanë edhe sot e kësaj dite vlerë të madhe për shkencën dhe kulturën bashkëkohëse turke. Ndër këto janë sidomos të dëgjura veprat leksikografike dhe enciklopedike të Sami Frashërit si *Fjalori etimologjik i turqishtes*, i cili shërbeu si bazë për formimin e gjuhës letrare turke në Kongresin e vitit 1932, pas ardhjes në pushtet të krijesit të shtetit modern turk Kemal Ataturkut. Samiu është ndër të parët që u angazhua për gjuhën e re letrare turke, për një alfabet turk të tipit latin. Përpos dramës „Besa” në turqisht shkroi edhe një dramë tjetër origjinale dhe novelën „Dashuria e Telatit dhe Fitnetës”, në të cilën proteston kundër zakoneve turke të martesës dhe ka përkthyer në turqisht gjashtë vepra letrare nga letërsitë e huaja, si „Të mjerët” e Viktor Ygosë, „Robinson Kruso” të Daniel Defosë etj. Në Historinë e letërsisë sonë është shënuar se Samiu në turqishte themeloi edhe një „bibliotekë xhepi”, ku botoi rreth 15 broshura shkencore popullore mbi tema të ndryshme si: qielli, toka, njeriu, gjuha, qytetërimi islam, mitologjia, femrat etj. Këtu luftonte bestytnitë e pikëpamjet antishkencore, luftonte ideologjinë feudale dhe përhapte diturinë dhe përparimin në shtresat e gjera popullore. Për gjithë këtë veprimtari Sami Frashëri zë një vend të rëndësishëm në letërsinë, shkencën dhe kulturën turke, ku ruhet dhe nderohet shumë kujtimi dhe kontributi i tij i madh.

E përkthyer nga turqishtja në shqip nga Ab. A. Ypi Kolonja, drama „Besa” e Sami Frashërit te ne në Kosovë u botua për herë të parë në vitin 1970 nga Enti Krahinor i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore në Prishtinë, dhe tash po botohet për herë të dytë. Sami Frashëri është ndër të parët që në letërsinë tonë (dhe, si shënohet në Monografinë e Esad Resos për Sami Frashërin, edhe në letërsinë turke), futi fshatarët si personazhe letrare, kurse përfytyrimin e virtyteve dhe të zakoneve shqiptare në këtë veper nuk e bëri në mënyrë të njëanshme dhe duke i glorifikuar, pa marrë parasysh natyrën liriko-romantike të dramës së tij, por edhe me qëllim të caktuar të luftimit të zakoneve të këtilla si plagë shoqërore që e kanë dërmuar

popullin tonë gjatë shekujve. Ai ka dashur më tepër të paraqesë këtu malësinë shqiptare në një kohë të transformimeve që kanë pas zënë fill në këtë rreth të paprekur në bukuritë e veta natyrore dhe në traditat shekullore, kurse madhërimi i virtyteve dhe i traditave të shëndosha morale dhe etike të popullit tonë do të ketë pasur edhe „qëllim politik që t'u tregonte turqve cilësitë e larta të popullit shqiptar”, pa marrë parasysh pasojat e rënda që mund të kenë pasur për protagonistët e tyre, si paraqiten edhe në dramën „Besa”.

Ndërkaq, autori në dramën „Besa” përshkruan me një dashuri romantike bukuritë e Progonatit të tij dhe të njerëzve të tij, malësorët dhe jetën baritore, të tërë atë pas-tërtinë dhe dliresinë e saj, paprekshmërinë e saj nga zgjedha e huaj dhe nga jeta e prishur e qytetit dhe e konaqeve të bejlerëve si dhe nga ndysitë e tyre. Thuase në jetën e përvujtur të familjes së varfër malësore të këtij fshati shqiptar, Vahides dhe Zyberit të tij, këtyre dy fytyrave shumë të dashura karakteristike të letërsisë sonë për fshatin e malësinë, në idilin e ngrohtë baritor të sivëllezërve, Merushës dhe Rexhepit të tyre, afëria e të cilëve vjen e bëhet dashuri e sigurtë dhe e përkushtuar rinore, pastaj ajo dashuria vashërore e dy vajzave të mitura në pafajësinë dhe paprekshmërinë e tyre që ëndërrojnë jetën e tyre të lirë me barinj të tyre në malet e fushat e Progonatit të tyre, gjithë ajo harmoni e mrekullueshme e jetës dhe e natyrës së pasur, formojnë një simfoni harmonike romantiko-lirike që flet me të tërë fuqinë e vet dhe që është një pasqyrë dramatike e bukurive të natyrës dhe të jetës që ka pasqyruar në mënyrë aq impulsive vëllau më i madh i Samiut Naim Frashëri, në poemën e tij të pavdekshme „Bagëti e bujqësi”.

Në këtë ambient dhe në këtë atmosferë e ndjejmë të tërë bukurinë romantike të asaj dashurie të ngrohtë, të ndjeshme, të pastër baritore, ndonjëherë edhe naive në dliresinë e vet, siç mund të jetë dashuria e dy krijesave të njoma të padjallëzuara; atë mburrjen e krenarinë e përkulshme të malësorëve tanë, për të urrejtur me të tërë fuqinë e kontrastit atë kryelartësinë e paturpësinë e bejlerëve dhe të sejmeneve të tyre të papunë, që u bien në

qafë barinjve dhe fshatarëve të urtë e të qetë në punën dhe në hallet e tyre. Në këtë kuadër takojmë edhe atë mallin për memëdhenë, për truallin dhe për shtëpinë e lindjes së të mërguarve tanë që lanë vendin e shtëpinë për t'u hedhur nëpër fushëbetejat e të huajve dhe për llogarinë e tyre, ose për të siguruar kafshatën e thatë për vete dhe për më të afërmit e tyre. Aty takojmë gruan tonë punëtore fshatare, njomësinë e dashurinë e saj për burrë e për shtëpi, për fëmijët dhe ardhmërinë e tyre, gruan e njomë e të butë, por edhe që di të luftojë si tigresha kur e lyp nderi i shtëpisë dhe i familjes, kur duhet zënë vendin e burrit për të shpëtuar fëmijët.

Të gjitha këto janë elemente që i bashkoi me shumë mjeshtri Sami Frashëri në dramën e vet „Besa”, duke u dhënë një tërësi organike dhe një dinamizëm të atillë që e mbajnë vëmendjen dhe e orientojnë kah synimet që sugjeron autori me porosinë e veta artistike dhe të vërtetat jetësore që i thur në dramën e tij.

Në këso suazash Sami Frashëri formon galerinë e personazheve të dramës së vet, nga të cilat është veçanërisht impresive figura sa madhështore aq e thjeshtë e bariut trim e bujar — Zyberit, i cili, me njomësinë e prindit e kupton dashurinë e së bijës, Merushës, me Rexhepin, të kushëririn e saj të largët, i cili, pas vdekjes së prindërve të vet, është rritur në shtëpinë e Zyberit si vëlla i Merushës. Zyberi është personifikim trimërie e bujarie, mospërkuljeje e krenarie, guximi e shpirtmadhësie të njeriut të thjeshtë shumë të dashur, shumë të ndieshëm përkundër gjithë vrazhdësisë së natyrës dhe zakoneve që mbretërojnë në malet tona. Sa i vogël e i pafuqishëm do të duket para tij një Demir Bej përkundër të gjithë fuqisë së tij dhe të „trimave” (sejmenëve) të tij!

Është fytyrë shumë e gjallë dhe e dashur edhe Vahidja, kjo bareshë e thjeshtë malësore plot me bestytini e paragjykime të vjetra që parasheh fatkeqësinë pse i këputet peri dhe nuk mund ta kuptojë kurrësi Zyberin e saj që pranon ta martojë Merushën me Rexhepin, që deri dje i quante vëlla e motër. Deri në këtë moment, Vahidja është me të vërtetë një grua fshatare, e urtë, e butë, e hutuar

pas brengash të veta për t'i rritur e bërë të lumtur fëmijët e vet dhe kujdeset për burrin, shtëpinë e pasurinë e saj, për delet e shqerrat e saj. Ajo është deri atëherë një grua e thjeshtë malësore, një nënë që dridhet për folenë e saj. Ajo është e këtyllë vetëm deri në atë çast kur do të shndërrohet në tigreshë që don ta shpëtojë vajzën e vet nga kthetrat e gjakësorit dhe ta marrë gjakun e burrit të vrasë në truall të vet, duke mbrojtur vajzën e vet e nderin e shtëpisë dhe të familjes së vet. Është kjo një grua-nënë që i dridhet shpirti për fëmijën e burrin, por që nuk bie në gjunjë as kur i vritet burri dhe ia rrëmbejnë vajzën, e që nuk do t'i dridhet gishti as kur shtie pushkë në Selmanin tinëzak, që ia lag armët Fetahut para se ta thërrasë në dyluftim.

Në dramën „Besa” është karakteristike edhe fytyra tragjike e Fetahut, që pati fatin e lig të kalojë njëzet vjet në luftërat e turkut dhe, kur kthehet në atdhe, pasi shpëton nga dora tinëzake e Selmanit, i takon të vrasë djalin e dëshirit për ta mbajtur besën e të vrasë veten për të marrë gjakun e djalit. Pikërisht një zgjidhje e këtyllë e dramës „Besa” shpeshherë e ka shtruar çështjen se a mos kjo dramë në njëfarë mënyre e glorifikon besën si zakon popullor e traditë bujare dhe a e ndihmon zhvillimin e idesë së hakmarrjes. Athua Sami Frashëri i frymëzuar me ide të iluminizmit borgjez e patriot i madh i mërguar për shumë kohë nga vendlindja e tash edhe i deportuar në Libi për ide përparimtare dhe veprimtari antiosmane, i kapluar nga ndjenjat e flakta atdhetare është hedhur në idealizimin e virtyteve të popullit tonë duke glorifikuar kështu edhe zakone e tradita që ngrehin prapa dhe janë plagë e shoqërisë sonë atëherë dhe përherë. Kështu persiatjesh mund të bëhen edhe sot. Por jo. Vërtet, Sami Frashëri, në dramën e tij „Besa” e idealizon fshatin shqiptar dhe, si thotë Esad Reso, e paraqet „nga pikëpamja romantike, që ishte karakteristikë e romantizmit borgjez të shekullit XIX”, kur është shkruar edhe „Besa”. Por, motivet e besës e të hakmarrjes në dramën „Besa”, vetvetiu e me rrjedhimet tragjike të besës me çdo kusht dhe të hakmarrjes, në të vërtetë, indirekt, i luftojnë këto

dhe zakonet e tjera prapanike, duke sugjeruar njëherës edhe gjendjen dhe rrjedhimet e tyre.

Fjala e dhënë, besa, që është subjekt kryesor i kësaj drame, mbajtja e fjalës dhe e besës, vërtet është cilësi që shquhet te shqiptarët, që janë të njohur, ose janë bërë të njohur për këtë. Por ajo është kategori morale dhe etike në përgjithësi dhe nuk mund të thuhet se është kategori vetëm e moralit shqiptar dhe se me dramën „Besa” S. Frashëri ka dashur vetëm ta madhërojë atë si kategori të popullit të vet, përkundër ngjyrave romantiko-lirike që e përshkojnë veprën e tij. Mbajtja e fjalës me çdo kusht, si në dramën „Besa”, ku ka si rrjedhim vrasjen e djalit nga ana e të jatit, që kthehet pas mërgimit shumëvjeçar, madje edhe kur mund të gjendeshin zgjidhje të tjera, pa e lënduar etikën dhe vetë besën si kategori të këtij morali, e që njëkohësisht do të mund të ishin artistikisht dhe psikologjikisht të arsyeshme — sa është këtu për të madhëruar vlerën e besës si kategori etike të shqiptarëve, aq është edhe për të theksuar mu atë tragjikën e mbajtjes dhe të ruajtjes së traditës me çdo kusht, traditës që, duke zënë rrënjë në etikën e moralin e njeriut tonë, mund të sjellë shkeljen e normave të tjera të moralit dhe të etikës sonë që vetvetiu vijnë e bëhen deformacion i vetë kësaj tradite dhe etike. Këtu autori nuk bën shumë dallim në mes të malësorëve që e kanë për traditë të mbrojnë vetveten dhe të shpaguhen për gjakun e padrejtësitë e bëra dhe atyre që kanë „shëtitur botën”, si Fetah Borshi i tij, dhe prej andej do të kenë mundur të sjellin „doke e zakone” të tjera. Malësorët, S. Frashëri i paraqet në këtë vepër edhe më tolerantë dhe më të arsyeshëm, madje. Vahidja e tij nuk e aprovon vrasjen që bën Fetahu, edhe pse, duke mos ditur se është i ati i vrasësit të burrit të saj, Zyberit, dhe rrëmbyesit të bijës së saj, Merushës, ka marrë fjalën dhe besën e tij se do t'i marrë hakun për vrasjen e burrit dhe do t'i kthejë vajzën për ta martuar me Rexhepin e saj. Ajo thotë për Fetahun: „Çfarë atë pa mëshirë?... Pse s'më the kur qenka yt bir?... Një që zgjat dorë mbi dritë të syrit është më i keq se një egër-sirë!...”

Me fjalën e Fetahut para tmerrit të krimit të bërë, Samiu, në të vërtetë, e paraqet çështjen asisoji sikur në kushte e rrethana të caktuara krimi që bëri Fetahu me vrasjen e të birit për botëkuptimet dhe pozitën e tij ka qenë rrugë për atë çast e vetme. „Im bir e kërkoj vetë këtë!...” — thotë Fetahu. — „T’ia kish bërë ndonjë tjetër, shkonte me turp... Pasi t’ia bëj vetë...”

Ndërkaq, Sami Frashëri, edhe si publicist edhe si shkrimtar „mendon se për të zhdukur zakonet e këqija të një populi, nuk duhet të përdoret forca, por të veprohet në atë mënyrë që ai të ngrihet në atë shkallë sa të largohet vetë me ndërgjegje nga ato zakone të këqija.” Sepse, ai i çmon vetitë e mira të popullit dhe beson në forcat e tij. „Po të vështrohen me vërejtje kombet e botës — shkruan Samiu — s’ka asnjë kombë, qoftë edhe i prapambetur, që të mos ketë veti të bukura e pak a shumë zakone të mira”.

Paraqitja e rrjedhimeve të këtilla tragjike të fjalës së mbajtur me çdo kusht dhe të hakmarrjes që përfundon me fikjen e dy shtëpive dhe me vrasjen e tre burrave, është vërtet njëkohësisht luftë e zakoneve të vjetra prapnike pa marrë parasysh mjetet me të cilat është paraqitur, pa marrë parasysh se në këtë luftë dhe shenjim të prapambeturisë, nuk janë ulur, por përkundrazi janë lartësuar, morali dhe burrëria edhe e Zyberit edhe e Vahides, që luftojnë dhe ruajnë nderin e krenarinë e tyre të malësorëve, edhe e Fetahut që është përfaqësues i asaj anës tjetër, në të cilën, qartazi, nuk janë simpatitë e autorit, pa marrë parasysh se ai nuk e vë në plan të parë luftën e fshatarëve të varfër kundër bejlerëve e agallarëve, por ndalet më tepër në relacionet shoqërore dhe në marrëdhëniet e tyre të kushtëzuara nga ato dhe nga pozita e tyre, që janë edhe rrjedhim i kushteve të jetës nën pushtuesin e huaj që i ka mundësuar ato marrëdhënie, në të cilat është e mundshme dhuna e përdhunimi si në këtë rast.

Megjithatë, në dramën „Besa” Sami Frashëri nuk është indiferent ndaj relacioneve shoqërore në mënyrën e vet thjesht klasore. Zyberi i tij e këshillon të bijën, Merushën, „që të mos martohet me njerëz të atillë, si Selfua, që është

djalë beu, i cili sillet sa andej sa kënde, pa punë dhe rron në kurriz të të tjerëve." Ai e porosit bijën e tij që të mos gënjëhet nga „fustanet e pallaskat" e argjendta të këtyre njerëzve, dhe i thotë shtruar „cilin të pëlqesh, do të ap!" Vetëm „në është se do të pëlqesh ndonjë njeri të tillë, ta dish mirë që s'të ap tek ai! S'dua të zë miqësi me të tillë njerëz të mefshtë, e pa punë! Një punëtor do pëlqyer, bijë, një punëtor. Një bari a një bujk!.." Vetë njeri që gjithmonë e ka çmuar shumë punën dhe punëtor i palodhshëm, Samiu, me gojën e Zyberit, thotë: „Sikur të punonin që të gjithë — sa do të ish mirë, nuk do t'i dihej as emri varfërisë". Sepse vetëm „veprat e bëjnë të pavdekshëm njerinë".

Ndonëse i paangazhuar drejtpërdrejt në luftën klasore, ndonëse imagjinues fantast i një bote demokratike në frymën e demokracisë borgjeze të kohës, Samiu flet në këtë vepër me shumë urrejtje kundër bejlerëve e sejmënëve të tyre dhe me ndjenja simpatie të ngrohtë dhe admirimi të madh për popullin e thjeshtë të fshatrave dhe të malësive tona, për barinj të më të thjeshtë. Me anë të personazhit shumë karakteristik të Zyberit, ai lufton drejtpërdrejt kundër bejlerëve, të cilët në atë kohë e deri pas Luftës së Dytë Botërore, shkëlqenin dhe shfrytëzonin fshatarët e varfër shqiptarë. Zyberi i tij nuk është vetëm malësor i ndershëm, krenar dhe guximtar, që i thotë në sy beut dhe sejmënëve të tij: „Ju pallate kini, vend shumë kini, langonj kini, njerëz kini, armë të argjenta, të florinjta kini. Madhëri kini, çdo gjë kini!... Po neve: një kasollë, ca dhënë dhe një nder kemi. Juve, në mos u vjen keq, ejani: kasollet t'i gremisni, dhëntë t'i merrni! Njeri nuk nxjerr zë; po mos pandehni se na merrni dhe nderin! Jo, Jo! Ne vdesim dhe nderin s'e prishim! Ne vetëm për nder, për nder e ruajmë shpirtin!"

Autori e lartëson kështu moralin e malësorëve të ndershëm, ani pse të varfër dhe thuase i vjen keq për varfërinë e tyre: „Kështu është nisur kjo e shkreta jetë! Njëri ze punën pa gdhirë dhe mezi fiton një copë bukë me djersë të ballit, një tjetër që është i lik për tërë njerëzinë, pa punuar, pa u munduar fare, pi e prehet dhe ha gjënë e dhjetë njerëzve." Por, pak më tutje, Samiu e nxjerr sub-

jektin në shesh të luftës së vërtetë, klasore, pothuaj: „Shkoi ajo kohë që di ti — i thotë Zyberi Demir beut. — Sot gjithkush është i lirë, s'kemi ndryshim fare në mes tonë, e di ti apo jo?” Është e qartë, me apo pa vetëdije, ky është paralajmërim i një koshience të formuar klasore te fshatari ynë për pozitën e tij, një pjekuri që ka zënë fill më heret dhe ka ardhur duke u formuar për të pëlcitur dikur në luftë dhe në përleshje të hapur, në qerim hesapesh në luftën e klasave.

Edhe këtu shohim atë vlerën e „Besës” së Sami Frashërit edhe si dramë edhe si porosi artistike e kohës. Fakti se autori ka mundur të gjejë për dramën e vet edhe ndo një zgjidhje tjetër, më pak tragjike, ose më fatlume madje e jo me vrasjen e djalit, tregon se Samiu me këtë zgjidhje ka dashur ta theksojë pikërisht atë anën tragjike të besës me çdo kusht dhe të hakmarrjes si zakon që ka bërë dhe që bën kërdi në shtresat tona, pa marrë parasysh se ajo ka zënë fill në kohët më të lashta, kur normat zakonore patriarkale kanë qenë pothuaj të vetmet që i kanë rregulluar marrëdhëniet midis njerëzve në bashkësitë tona shoqërore, në kushtet e pushtetit të huaj në trojet tona ose të mungesës së pushtetit shtetëror fare, në kushtet që kanë lënë pasoja aq të rënda dhe kanë shpjerë në shkallën e shfarosjes familje të tëra në luftë me njëra tjetrën. Autori ka mundur të gjejë edhe një rrugë tjetër në dramë, bie fjala, me faljen e gjakut nga ana e Vahides dhe me „trashjen” e vëllazërisë së saj me Fetahun (siç ndodh, më në fund, shpeshherë edhe në jetën e vërtetë), aq më parë kur Vahidja edhe e thotë këtë, pas aktit të kryer: „Pse s'më the kur ky qenka yt bir?” Ne e dimë se te ne gjaku edhe falet. Ai falet sidomos në raste të këtilla, kur ballafaqohen dy burrëri: burrëria e Vahides që e shpëton Fetahun nga vdekja tinëzake që i kurdis Selmani gjakatar, dhe burrëria e Fetahut që është gati të vrasë edhe të birin e dëshirit për të mbajtur fjalën e dhënë, madje kur kthehet në mëmëdhe pas njëzet vjet mërgimi dhe pa e takuar akoma djalin vrasës të burrit dhe rrëmbyes të vajzës së gruas që i shpëtoi jetën dhe e zuri motër.

Zgjidhja më „fatlume” në këtë rast do të mund të ishte edhe e natyrshme dhe në frymën e dokeve dhe të zakoneve tona, madje edhe artistikisht e pranueshme, pa marrë parasysh se do të ndërrohej karakteri tragjik i veprës dhe do të sillej ajo në kufi të melodramës. Por na duket se duke dashur ta luftojë indirekt edhe hakmarrjen edhe fjalën e mbajtur me çdo kusht, ta luftojë këtë me fuqinë e fjalës artistike, autori i ka dhënë veprës së tij një ecuri dhe një zbrëthim të këtyllë tragjik që e forcon edhe më tepër idenë e tij. Ndoshta këtu do të jetë udhëhequr edhe nga antika greke, kulturën e së cilës e njohu dhe e nderoi aq shumë, ose nga tragjeditë e Shekspirit, Korneit, Rasinit e kolosëve të tjerë të letërsisë botërore që e kanë kultivuar këtë lloj të të shprehurit artistik. Por gjithsesi, Samiu nuk e shkroi „Besën” e tij vetëm për të madhëruar virtytet e traditat e ndritshme e zakonet e lashta të popullit tonë as para neve vetë as para botës së huaj, por edhe për të treguar pikërisht ato pasojat e rënda që kanë pasur ato në traditën dhe në jetën e popullit tonë.

Vërtet, në dramën „Besa” nuk hasim në aso konfliktesh e zbrëthimesh që janë të përshkuara me intriga, tradhti e ultësi të tjera që paraqesin edhe deformacionin e kategorive të ndryshme të njerëzve dhe të shtresave të shoqërisë, nuk kemi aso ultësish shpirtërore, morale e etike, madje as te fytyrat negative të veprës, por vetë tragjedia e rëndë familjare e familjes së Borshajve (jo vetëm pse Fetahu për të mbajtur fjalën vret të birin, por edhe pse duke qenë vetë në ushtrinë e të huajit, larg atdheut, i biri i është bërë mercenar në shërbim të beut dhe dhunues i malësorëve të tij) dhe lartësia shpirtërore e virtytet e tjera që i pajisin barinjtë e fshatarët e thjeshtë të malësive tona, të personifikuar te Zyberi e Vahidja, Merushja e Rexhepi, pastaj edhe te Saidja që është vetëm një episodë në këtë dramë baritore, vetvetiu flet dhe lufton kundër prapambeturisë që personifikohet këtu në zakonet e prapështa të hakmarrjes e madje edhe të besës me çdo kusht. Thuase autori na pëshpërit: nuk do të thotë se besa duhet të mbahet kështu, nuk do të thotë se gjaku duhet të lahet vetëm me gjak, ka dhe ekzistojnë edhe rrugë e

mënyra të tjera për të ruajtur nderin e krenarinë, moralin dhe etikën, zakonet dhe traditën e një populli, vlerat morale dhe virtytet e tij.

Vlera e virtyte të këtilla kultivon dhe madhëron, në të vërtetë, Samiu në „Besën” e tij, kurse rrjedhimet e aktit tragjik të vrasjeve dhe të hakmarrjeve të këtilla vetvetiu e dënojnë edhe vetë aktin tragjik që është pasojë e traditave dhe e zakoneve të këtilla të mbrapshta. Samiu, si thotë në monografinë e përmendur Esad Reso, vetëm e „lavdëron moralin e lartë të njerëzve të varfër” dhe „flet me urrejtje kundër bejlerëve e çfiligarëve dhe me ndjenja simpatie e admirimi flet për popullin e thjeshtë, për barinjët”, duke protestuar me këtë veper kundër padrejtësive shoqërore e dhunimeve që u bëheshin duke i shqetësuar në hallet e në bregat e veta, në trojet dhe në malësitë e tyre.

Fjala e dhënë — besa, me hakmarrjen e disa doke të tjera të vjetra e përcollën shekuj me radhë popullin shqiptar dhe një kohë, gjatë pushtimeve të huaja dhe në mungesë të pushtetit të vërtetë shtetëror në malet tona, në kushtet e qeverisjes së fiseve e pleqërive, rendi dhe e drejta e siguria e njeriut dhe e personalitetit të tij ruheshin vetëm sipas së drejtës kanunore. Këto kanë mbetur shenja karakteristike të rregullimit të brendshëm të marrëdhënieve tona në familje dhe në shoqëri. Me kohë, e sidomos në kushtet e pushtimeve të huaja dhe të gjitha të këqijave që kanë sjellë ato, janë shkaktuar edhe bastardhime e çoroditje të ndryshme dhe keqpërdorime e keqtrajttime të këtyre traditave e kanuneve që janë bërë pengesë në zhvillimin dhe emancipimin e popullit tonë, kurse hakmarrja shfarosi familje të tëra dhe është një nga plagët më të rënda që ende nuk është shëruar plotësisht. Atë, si plagë të gjallë, të kushtëzuar nga i huaji dhe të shkaktuar nga dhuna e shfrenimi i njerëzve tanë në shërbim të të huajit, e ka ravizuar edhe Sami Frashëri në dramën „Besa”. Selfua, i biri i Fetah Borshit, që i vë syrin bareshës së bukur, është deformuar i tëri në shërbim të Demir Beut, dhe me aktin e vet të rrëmbimit të vajzës së huaj e të përdhunimit që i bën familjes së qetë të Zyberit, bëhet shkaktar i tragjedisë së dy familjeve dhe humb kokën nga dora e të jatit.

Drama „Besa” ka një galeri të tërë personazhesh të tjera, që, edhe pse episodike, kanë rëndësinë e vet për karakterizimin specifik të kohës dhe të ambientit të saj, si janë: Demir Beu e „trimat” (sejmenët) e tij, plaka Duri që e pret të birin nga mërgimi njëzetvjeçar e i fikut konaku me vrasjen e tij dhe të nipit të saj të vetëm, etj. Por heronjtë dhe njerëzit e vërtetë të „Besës” janë barinj të e varfër nga shtresat më të ulta të fshatit: Zyberi e Vahideja në brezin e parë, Rexhepi e Merushja dhe shoqja e saj Saidja në brezin e dytë e që do ta vazhdojnë jetën të lirë dhe në kushte të reja që do t'i krijojnë vetë. Sepse „kaluan ato kohë, or Bej, kur ti bënje çdo gjë, sot jemi njësoj si ti si unë...” do t'i thotë në një moment Zyberi Demir Beut, e ky është paralajmërim i një lufte çlirimtare, që shpërtheu shpejt, paralajmërim i një lufte klasash, madje, që ishte e pashmangshme.

Për më tepër, simpatitë e autorit do të jenë edhe në anën e Fetah Borshit, fytyrës më tragjike të dramës, që i takon të vrasë të birin që s'e kishte parë plot njëzet vjet dhe t'i marrë gjakun të birit duke vrrarë vetveten dhe duke e lënë nënën plakë tetëdhjetë vjeçare e duke e mbyllur përgjithmonë shtëpinë e fikur oxhakun. Është e rëndë tragjika e mbajtjes së këtillë të besës dhe hakmarrjes dhe ajo flet vetvetiu për këtë anë tragjike të „Besës” së Sami Frashërit. Por Fetahu, në mënyrë indirekte, ndonëse shumë impulsive, personifikon edhe fatin e rëndë të qinda e mija shqiptarëve që me dhjeta vjet dergjeshin dhe vriteshin në radhët e ushtrisë turke, duke luftuar nëpër shkretëtirat e Anadollit, të Azisë e të Afrikës gjatë pushtimeve dhe ekspeditave turke, që nuk përmalloheshin vetëm për nënën plakë, për grua e fëmijë, por edhe për malet e blerta, për blegërimën e butë të qengjave, për gurgullimën e përrenjve e të gurrave, për arat e livadhet, për pyjet e gjelbëruara që i kishin „ndër mend ditë e natë”.

Kësisoj, „Besa” e Sami Frashërit është me të vërtetë një tabllo e bukur piktoreske e fshatit dhe e malësive tona të atyre ditëve kur tashmë kishin filluar lëvizjet çlirimtare dhe përpjekjet për emancipimin e tyre. Njëkohësisht ajo ishte protestë kundër padrejtësive dhe dhunimeve që i bë-

44

heshin popullit të tij, por edhe thirrje bashkatdhetarëve të vet që „të marrin një udhë të re, udhën e përparimit, të qytetërimit”. E kështu, tash e një qind vjet më parë, drama „Besa” është gjithnjë prezente në skenën shqiptare dhe vepër që shikohet dhe lexohet më ëndje.

Vehap Shita

Prishtinë, 20 korrik 1978.

Sami Frashëri: VEPRA (1) / Redaktor teknik: *Shyqri Kushevica* /
Korrektor: *Ramadan Stublla* / Tirazhi: 10.000 copë / U shtyp në
tetor të vitit 1978 në Shtypshkronjën e Ndërmarrjes gazetare,
botuese e grafike „Rilindja” — Prishtinë

